

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

**GJENDJET E MAHNITSHME
TË ZEMRËS**

Prishtinë 2015

Ihjaw Ulumid-din
Ringjallja e diturive fetare
Imam Gazali

Titulli i origjinalit
Kitâbu Sherh-i ' Axhaibî'l- Kalb
Libri 21

Përgatiti dhe përktheu
Is-hak Shala dhe Abdullah B. Ferizi

Lektor:
Artan Sadiku

U shtyp në shtypshkronjën SHKROLA PRINT

ISBN

978-9951-18-181-5

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

PARATHËNIE

Hamd (Falënderimi) i takon vetëm Allahut, që madhëstinë e Tij nuk janë në gjendje ta konceptojnë në tërësi zemrat dhe mendjet. E që nga manifestimi i Nurit (Dritës) të Tij mbesin të habitura bebëzat dhe shikimet, i Cili vështron edhe detajet më të vogla të fshehtësive në zemra dhe njeh të fshehtat e ruajtura në vetëdije, i Cili nuk ka nevojë për këshillën e askujt e as për ndihmë në drejtimin e Mbretërisë së Tij, i Cili udhëheq me zemra, falë gjynahet, fshehë turpin dhe mangësitë. Ata që janë në vështirësi i nxjerrë nga vështirësitë. Ati i bëj hamd pafund.

Salat dhe selam zotërisë të peygamberëve, Muhammedit (s.a.v.s.) i cili bashkoi ata të cilët u ndanë nga feja dhe e preu rrënjën e atyre të cilët ishin kundër fesë, e selam edhe ehli-bejtit dhe as'habëve të tij të ndershëm dhe të pastër.

Pas kësaj dije se: Njeriu është i nderuar me veti të veçantë me të cilën i tejkalon të gjitha krijesat tjera, e kjo është aftësia e tij të njoh Allahun Teala. Kjo veçori në këtë botë paraqet bukurinë e tij, krenarinë dhe përsosmërinë, kurse në ahiret përfiton gradën e merituar. Kjo njohuri (*marifet*), që është grada më e lartë, nuk ka të bëjë me pjesët tjera të trupit, por është njohje që mund të arrihet me zemër. Zemra është ajo e cila e njeh Allahun Teala, është ajo e cila i afrohet Atij, për Allahun bën amel (vepron), rrugëton drejt Tij, dhe në përfundim - zemrës i zbulohen fshehtësitë prej Allahut.

Zemrës i janë nënshtruar gjymtyrët tjera, dhe ato janë shërbëtorë të saj. Ato janë vegla dhe mjete të cilat zemra i fut në punë. Ashtu siç punëson zotëria shërbëtorin, ashtu siç mjeshtri e fut veglën në punë dhe e përdorë, ashtu edhe zemra i fut në punë dhe i përdorë gjymtyrët tjera. Ashtu siç është zemra e zhveshur nga çdo gjë organi më i vlefshëm tek Allahu, ashtu edhe zemra e mbushur me gjëra tjera është po në atë proporcion larg Allahut. Nga kjo zemër kërkohet, asaj i drejtohet dhe ajo mbahet përgjegjëse. Kjo është zemra e cila kur pastrohet prej *masivës* (çdo gjë tjetër, përveç Allahut), duke iu afruar Allahut arrin lumturinë dhe gjen shpëtimin, dhe është po kjo zemër e cila duke marrë masivën në vete, mund të gabojë dhe të jetë e dëshpëruar. Zemra është ajo e cila në të vërtetë i nënshtrohet Allahut. Kurse ibadetet të cilat i kryejnë pjesët tjera të trupit janë drita (nur) e saj dhe është pikërisht zemra ajo që kryengritet kundër Allahut. Edhe të këqijat që përhapen në gjymtyrë janë vepër e zemrës. Mbetja e zemrës në dritë ose në errësi manifestohet jashtë me mirësi ose me të keqe. Çfarë ka brenda në gotë, ajo duket jashtë.

Zemra është një ekzistencë e tillë që, kur njeriu e njih atë, e njih nefsin (veten); dhe kur e njih nefsin (veten) - e njih Rabbin e vet. Kur njeriu e harron dhe nuk e njih atë, nuk e njih as veten; e kur nuk e njih veten, nuk e njih as Rabbin e vet. E si mund të njoh tjetrin nëse nuk e njih veten?

Në fakt, shumica e njerëzve nuk e njohin nefsin dhe zemrën e vet. Mes tyre dhe nefsit së tyre ka pengesë për arsye se Allahu Teala ndërhyr në mes të njeriut dhe zemrës së tij, pra kjo ndërhyrje pengon njeriun të shohë cilësitë dhe fuqinë e dorës së Tij, se si e rrotullon zemrën. Njeriu nuk

mund të kuptojë se si i përkulet shejtanit, si lartësohet në gradat më të larta, dhe si i tejkalon edhe melekët më të afërt Allahut (*mukarrebun*).

Për ata që nuk kontrollojnë zemrën, nuk e përmirësojnë atë dhe nuk e vërejnë në të dritën (nur) që derdhet nga thesaret e melekut, Allahu Teala thotë:

“E mos u bëni si ata që e harruan Allahun, e Allahu bëri që ata ta harrojnë vetveten. Të tillët janë ata të prishurit.”

59-Hashr: 19

Prandaj, njohja e zemrës dhe cilësive të saj është esencë e fesë dhe themeli i rrugës së *salikëve*¹.

Pasi kemi përfunduar pjesën e parë të librit “Ihja” e cila flet për manifestimet e jashtme të pjesëve të trupit të njeriut - ibadetet dhe rregullat e jetës - kemi premtuar që në pjesën e dytë do të flasim për pjesët e zemrës të cilat njeriun e dërgojnë në shkatërrim dhe që e shpëtojnë, që paraqet dituri të brendshme (ilmi batin). Tani do të të shpjegojmë pjesët kryesore të zemrës duke sjell shembuj, për ta bërë këtë të kuptueshme, sepse të folurit për gjendjet e mahnitshme të zemrës dhe fshehtësive të saj hynë në fushën e botës së melekutit, e cila nuk është lehtë të kuptohet.

Së pari do të shpjegojmë kuptimet e fjalëve: zemër (kalb), shpirt (ruh), nefis dhe mendje (akl), si dhe do të tregojmë se çka nënkuptohet me këto terme.

¹**Salik** do të thotë dikush që ka hyrë në rrugë të Hakut dhe që edukohet nga një shejh (murshid). Dikujt që hyn në rrugën e edukimit shpirtëror, në tasavvuf i jepen emra si salik, sufi, dervish, murid.

KUPTIMI I FJALËS KALB (ZEMËR)

Kuptimi i parë: Fjala *kalb* (zemër) përdoret në dy kuptime. Kuptimi i parë ka të bëjë me organin e zemrës në trupin e njeriut – zemrën materie. Zemra materie është një copë mishi në formë të boçës së pishës, e vendosur në anën e majtë, në pjesën e poshtme të gjoksit. Brenda saj ka boshllëk, që quhet barkushe, e mbushur me gjak të zi. Aty është miniera dhe burimi i shpirtit (ruh). Kjo zemër materie është interesim i mjekëve, dhe meqenëse nuk është në interesin e temës tonë, nuk ka nevojë të merremi me të. Kjo zemër, ashtu siç gjendet tek njeriu gjendet edhe te kafshët, bile edhe te të vdekurit. Ne në këtë libër, kur bisedojmë për zemrën dhe kur themi *zemër* (*kalb*), nuk kemi qëllim këtë zemër që është veç një copë mishi sepse ne nuk e llogaritim atë si të rëndësishme. Këtë zemër materie mund ta shohin bile edhe kafshët, e lëre më njeriu.

Kuptimi i dytë: Zemra është *latife-i Rabbanije-i ruhanije*, d.m.th nuk mund të shihet me sy, është një ekzistencë shpirtërore, dhe kjo zemër shpirtërore ka lidhje me zemrën materie. Kjo zemër shpirtërore (*kalbi ruhani*) është esenca (hakikat) e njeriut. Kjo është ajo zemër e cila kupton, di dhe njeh. Kësaj zemre i drejtohet, i jepen urdhra, qortohet, detyrohet, që do të thotë se prej kësaj zemre kërkohet. Në kuptimin e marrëdhënies së zemrës shpirtërore me zemrën materie, mendjet e shumicës mbesin të habitura. A është kjo marrëdhënie si marrëdhënia e sipërfaqes së tokës me materien, ose si cilësia me të cilësuarin, apo si marrëdhënia e veglës me përdoruesin e saj, a sikur marrëdhënia e atij që qëndron në një vend me vet vendin? Apo e një udhëtari me

anijen, ose kapitenit të anijes me anijen? Në këtë çështje njerëzit janë habitur. Ne këtu nuk do të hymë në shpjegimin e kësaj për dy arsye:

E para, shpjegimi i kësaj është në lidhje me diturinë *mukashefe*², kurse ne në këtë libër po flasim për diturinë *muamele*³.

E dyta, për të zbuluar hakikatin e kësaj duhet të shpjegohet fshehtësia e shpirtit. E pasi Resulallahu s.a.v.s nuk ka folur rreth shpirtit, as tjetërkush nuk ka të drejtë të flasë.

Kur ne në këtë libër themi ‘*zemër*’, nënkuptojmë zemrën shpirtërore. Synimi ynë nuk është të njoftojmë për të vërtetën (hakikatin) në krijimin e saj, por ndoshta për të treguar cilësitë dhe gjendjet. Zaten, dituria praktike (*muamele*) nuk është për të kuptuar të vërtetën e diçkaje, por është e nevojshme të kuptohen cilësitë dhe gjendjet.

²**Mukashefe**: zbulim; hap; qelë; fshehtësitë shpirtërore; të dihet një gjë para se të ndodh; nxjerrja në shesh e një sekreti ose të fshehte; pamje/shikim me syrin e zemrës.

³**Muamele**: praktikë; trajtim.

KUPTIMI I FJALËS RUH (SHPIRT)

Fjala e dytë është *ruh*. Edhe fjala ‘ruh’ (shpirt) në lidhje me qëllimin tonë përdoret në dy kuptime:

Kuptimi i parë, është se shpirti buron nga një *latif* (jo-materie, i padukshëm) që gjendet në zbrazëtirën (barkushen) e zembrës materie. Nëpërmes venave të gjakut, ai përhapet në tërë trupin. Shikimit, dëgjimit, nuhatjes dhe shqisave tjera, drita e jetës u rrjedh prej këtu në gjithë trupin, ngjashëm me dritën e llambës që, duke shëtitur ndriçon qoshet e dhomës, sepse llamba ndriçon atë qoshe ku ajo dërgohet. Jeta është e ngjashme me ndriçimin që paraqitet në qoshe, kurse shpirti është si llamba. Ashtu si shëtitet llamba nëpër qoshe me dorë, edhe shpirti shëtit nëpër trup përmes venave të gjakut. Këtë e kanë në mendje mjekët kur thonë ‘shpirt’; e që është një avull *latif* i nxehtësisë së zembrës. Shpjegimi i kësaj është jashtë qëllimit tonë. Kjo është punë e mjekëve të cilët merren me shërimin e trupit. Mjekët e fesë të cilët merren me shërimin e zembrës për ta afruar atë Allahut, nuk merren me këtë shpirt.

Kuptimi i dytë: Ai është një pjesë e njeriut e cila nuk shihet, por që kupton dhe di. Një pjesë të këtij kuptimi e treguam kur përshkruam zembrën. Edhe ajeti në vazhdim synon mu këtë shpirt:

“Do të të pyesin ty për shpirtin. Thuaj: ‘Shpirti është nën urdhrin e Rabbit tim’.” 17-Isra: 85

Kjo është një *emr-i Rabbani* (urdhër hyjnor) i mahnitshëm që shumë mendje nuk janë në gjendje të kuptojnë hakikatin e saj.

KUPTIMI I FJALËS NEFS

Fjala e tretë është *nefs*. Edhe kjo fjalë përdoret në dy kuptime, dhe të dy kuptimet kanë të bëjnë me qëllimin tonë.

Kuptimi i parë: Forca e zemërimit dhe epshit të njeriu, e bashkuar në një kuptim. Këtë do ta shpjegojmë më vonë. Të mëdhenjtë e tasavvufit, fjalën *nefs* e përdorin më së shumti në këtë kuptim. Ngase kur ata thonë *nefs*, synojnë një esencë e cila të njeriu përmbledh cilësitë e këqija, dhe prandaj thonë që me *nefsin* duhet luftuar dhe atë duhet kundërshtuar. Edhe Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Armiku yt më i madh është nefsi, i cili të ka rrethuar mes dy sqetullave.”⁴

Kuptimi i dytë: është në kuptimin e dytëtë fjalëve *zemër* dhe *shpirt*, të cilat i treguam më herët, pra është hakikati i njeriut, - vetë njeriu (*nefs-i latife*). Por, kjo përshkruhet me cilësi të ndryshme për shkak të ndryshimit të gjendjeve të *nefsit*. Për shembull: Kur i nënshtrohet shariatit dhe arrin në qetësi, quhet ‘*nefsi mutmain*’ (i qetësuar). Rreth *nefsit* si ky, Allahu Teala thotë:

“O ti nefsi i qetësuar!

Kthehu te Rabbi yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai i kënaqur me ty!” 89-Fexhr: 27, 28

Padyshim se afrimi të Allahu i *nefsit* në kuptimin e parë as që mund të mendohet, sepse ai është *nefsi* i cili vazhdimisht largon prej Allahut dhe në të njëjtën kohë është ndihmës i shejtanit. Kur nuk arrihet qetësia në kuptimin e

⁴ Bejhaki në librin ‘*Zuhd*’, transmetuar nga Ibn Abbasi r.a.

plotë dhe njeriu mbron nefsin karshi epshit dhe mundohet t'i rezistojë, kësaj i thuhet '*nefsi levame*' (qortues), sepse e qorton njeriun për mangësitë në ibadete ndaj Allahut Teala. Pikërisht ky nefsi shpjegohet kur Allahu Teala thotë:

“Betohem në nefsin qortues!” 75-Kijame:2

Nëse nefsi nuk kundërshton dëshirat e kënaqësisë epshore, ai i përshtatet dëshirave të epshit dhe shejtanit, e kësaj i thuhet '*nefsi emare*'. Ndërsa Allahu Teala, në tregimin e Jusufit a.s., thotë:

“Unë nuk e shfajësoj veten (nefsin) time, sepse nefsi është shumë nxitës për të keqen.” 12-Jusuf: 53

Megjithkëtë, nefsi që përmendet në këtë ajet, pra nefsi që nxitë të keqen është e pranueshme të përfshihet (kategorizohet) edhe në kuptimin e parë që e shpjeguam më lartë.

Andaj, nefsi në kuptimin e parë është tepër i qortuar ndërsa nefsi në kuptimin e dytë është i lëvdueshëm, pra esenca, hakikatii njeriut, është që njih Allahun Teala dhe njohuritë tjera.

KUPTIMI I FJALËS AKL (MENDJE)

Fjala e katërt është '*akl*' (mendje). Edhe fjala *mendje* përdoret në kuptime të ndryshme. Këto i kemi treguar në temën e diturisë. Dy prej tyre janë në lidhje me qëllimin tonë këtu:

Kuptimi i parë: fjala ‘*mendje*’ përdoret nganjëherë për mendjen e cila njih hakikatin e sendeve, që gjendet në zemër, e përbërë nga cilësitë e diturisë.

Kuptimi i dytë: kur thuhet ‘*mendje*’ synohet ajo mendje që kupton dituritë, e që në atë rast bëhet vet zemra. Ndërkaq, ne e dimë se çdo dijetar ka në vete një ekzistencë të vetë-qëndrueshme. Dituria që hyn në këtë ekzistencë është cilësi. Ndërsa cilësia nuk është e njëjtë me të cilësuarin.

Nganjëherë thuhet *mendje* e me këtë synohet cilësia e atij që di, e nganjëherë thuhet *mendje* dhe synohet vendi i kuptimit, pra vet ai që kupton. Kjo është mendja nga hadithi i Resulallahut s.a.v.s:

“Mendja është e para që Allahu Teala krijoi”, sepse *mendja* në kuptim të diturisë është cilësi. Pasi për cilësinë është i nevojshëm një vend, nuk lihet mundësia që ajo të jetë krijuar e para. Është e domosdoshme që së pari të krijohet vendi, ose të paktën të krijohen bashkë. Në të njëjtën kohë, as cilësisë pa vend (esencë) nuk është e mundur t’i drejtohem. Vazhdimi i këtij hadithi është:

“Allahu i urdhëroi mendjes: ‘Ktheu në këtë anë’ dhe mendja u kthye. Urdhëroi ‘Ktheu në atë anë’, përsëri u kthye. U përul në çdo urdhër të Allahut Teala. Pastaj Allahu Teala tha: ‘Për hakun e lartësisë dhe madhërisë Time, nuk kam krijuar asgjë më të vlefshme se ti. Me ty jap, me ty marr. Me ty shpërblej, me ty dënoj’.”

Treguam se këta emra kanë kuptime, e që janë: zemra materie, shpirti trupor, nefsi epshor dhe dituria. Këto janë katër kuptimet që përdoren për katër fjalët (emrat). Ekziston edhe kuptimi i pestë, e që është njeriu që kupton dhe që është i ditur. Këto katër fjalë, rrotullohen rreth esencës së pestë me tërë ekzistencën e tyre.

Pra, fjalët janë katër, kuptime bëhen pesë. Njëkohësisht, çdo fjalë përdoret në dy kuptime. Shumicën e dijetarëve e ka habitur divergjenca e këtyre fjalëve dhe përdorimi në këtë kuptim. E shihni si ata kur flasin për kujtimet, thonë: ky është kujtim i mendjes, ky, kujtim i shpirtit, ky, kujtim i zemrës, dhe ky - kujtim i nefsit. Por, ai që e sheh këtë nuk mund të dijë kuptimet e ndryshme të këtyre emrave. Prandaj, shpjegimin e këtyre emrave e dhamë në fillim pikërisht me qëllim që të heqim paqartësinë nga to. Kur përmendet emri 'kalb' (emërtimi për zemër) në Kur'an dhe hadithe, me atë dëshirohet të shprehet ajo që kupton në njeriun dhe që njih hakikatin e sendeve. Ndonjëherë me këtë fjalë (kalb) shprehet edhe zemra që gjendet në gjoks. Sepse ndërmjet zemrës shpirtërore dhe zemrës materie ekziston një lidhje e veçantë. Sado që zemra shpirtërore ka lidhje me gjithë trupin, kjo lidhje bëhet përmes zemrës materie. Lidhja e parë e saj është lidhja me zemrën materie. Zemra materie është sikur vendi dhe atdheu i saj, bota dhe transportuesi i saj.

Për këtë arsye Sehli Tusteriu ka thënë: *"Zemra është Arsh, ndërsa gjoksi është Kursi."* Të mos pandehet se me këtë thënie Tusteriu ka pretenduar Arshin dhe Kursin e Allahut. Kjo është absurde. Ndoshta pretendimi i tij është se zemra dhe gjoksi ndikohen ashtu si dëshiron Allahu Teala, prandaj janë

bërë vend i parë i frekuentueshëm për ndikim. Çka është Arsh-i dhe Kursi-a në lidhje me Allahun Teala, ashtu është zemra dhe gjoksi në lidhje me përcjelljen e ndikimit.

Ky ngjasim mund të jetë i drejtë në disa çështje, por unë nuk do të mundohem me të, meqenëse nuk është e përshtatshme për temën tonë. Prandaj largohem prej kësaj.

USHTARËT E ZEMRËS

Allahu Teala thotë:

“Ushtrinë e Rabbit tënd nuk e di kush pos Tij.”

74-Muddeththir: 31

Allahu Teala ka shumë ushtarë në zemra, në shpirta dhe në botë tjera, që askush tjetër, përveç Tij, nuk ua di hakikatin dhe numrin. Ne këtu do t’i përmendim disa prej ushtarëve të zemrës, sepse ndërlidhen edhe me temën tonë.

Zemra ka dy ushtarë. Prej tyre njëri shihet me sy, e tjetri jo. Zemra është sundimtar, kurse ushtarët janë shërbëtorë dhe ndihmës të rëndësishëm. Dhe këtë e mendojmë kur themi *ushtar*.

Ushtarët që shihen me sy janë gjymtyrët si dora, këmba, syri, veshi, gjuha etj. Të gjitha këto gjymtyrë janë nën urdhrin dhe në shërbim të zemrës. Zemra i ndikon këto gjymtyrë si të dëshirojë, dhe i kthen kah të dojë. Këto gjymtyrë janë ashtu të krijuara që janë të detyruara t’i nënshtrohen zemrës. Ato nuk mundën assesi të kundërshtojnë zemrën dhe të jenë kryengritëse karshi saj. Për shembull, kur zemra urdhëron

syrit të çelet – ai çelet, kur urdhëron këmbën të bëjë hapin – e bën, gjuhën për të folur – fol... gjymtyrët assesi nuk kundërshtojnë, por zbatojnë menjëherë urdhrin e zemrës. Njëjtë është edhe me gjymtyrët tjera. Nënshtrimi i gjymtyrëve ndaj zemrës përkujton në nënshtrimin e melekëve Allahut Teala. Edhe melekët janë krijuar ashtu që t'i nënshtrohen Allahut, dhe nuk mund të kundërshtojnë. Allahu Teala thotë:

“...të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ato.” 66-Tahrim: 6

Ka vetëm një pikë ndarëse këtu: melekët nënshtrohen me vetëdije, ndërsa nënshtrimi i gjymtyrëve është pa vetëdije.

Këta ushtarë janë mjetet e nevojshme për udhëtimin e zemrës. Ky është udhëtim drejt njohjes së Allahut Teala, është arritje Allahut duke kapërcyer gradat. Zemra është krijuar për të adhuruar dhe njohur Allahun:

“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.” 51-Dharijat: 56

Trupi është bartësi i zemrës, ndërsa dituria është ushqimi i saj. Veprat e mira janë shkaqe që i mundësojnë zemrës të arrijë ushqimin dhe të përfitojë. Personi që mbetet në kallëpin e trupit dhe nuk e tejkalon këtë botë, nuk mund të arrijë Allahut Teala. Sepse ai duhet të ngritet nga shkalla më e ulët në shkallën më të lartë. Kjo botë (dynja) është arë ku mbillet për ahiret, dhe është një vendqëndrim për udhëzim në rrugë të drejtë. E është quajtur dynja për shkak që është stacioni më i ultë, dhe vendi ku njeriu duhet të përgatitet mirë. Njeriu është i detyruar ta marrë ushqimin (diturinë) në këtë botë (dynja). Ndërsa trupi është një mjet transporti që

bartë zemrën në dynja. Kjo është arsyeja pse duhet kujdesur për trupin dhe pse duhet mbrojtur ai. Mbrojtja e trupit dhe kujdesi për të është i mundshëm me furnizim të trupit me ushqim dhe gjëra të duhura, si dhe me largimin e gjërave që dëmtojnë dhe shkatërrojnë. Për të furnizuar trupin me ushqim të nevojshëm, zemra ka nevojë për dy ushtarë (dy forca). Njëri ushtar është i brendshëm (batin), që është 'shehvet-i' (epshi; kërkesa për ngrënie, pirje, veshje etj.), dhe tjetri është i jashtëm (zahir), e që janë gjymtyrët si dora dhe këmba, të cilat furnizojnë. Për këtë, siç janë krijuar në zemër epshet e nevojshme për të, ashtu janë krijuar edhe në trup gjymtyrët, që janë mjetet e epshit. Njeriu është bërë nevojtar edhe për dy forca, me qëllim që të largojë gjërat e rrezikshme. Njëra prej këtyre forcave është e brendshme, dhe quhet zemërim. Nëpërmjet kësaj force njeriu mbrohet nga gjërat e rrezikshme, mbrohet nga armiku dhe i hakmerret atij. Forcat e jashtme përsëri janë mjetet si dora dhe këmba – me këto mjete ai e shpreh zemërimin. Ato janë si forca të armatosura të trupit. Pastaj ka nevojë për ushqim, nëse nuk e njeh ushqimin - nga ushqimi epshor dhe shoqërimi me te, nuk ka dobi. Për të përfituar këtë dituri, zemra është bërë nevojtar edhe për dy forca. Prapë, njëra forcë është e brendshme – aftësia për të kuptuar sinjalet nga pesë shqisat: shikimi, dëgjimi, prekja, nuhatja dhe shijimi; dhe forca e jashtme: që janë organet e trupit: syri, veshi, hunda dhe organe tjera. Për të shpjeguar nevojën për këto forca dhe urtësinë, duhet shkruar vëllime e vëllime. Në librin '**Shukur**' është biseduar pak për këtë, le të mjaftohemi me kaq.

Sipas kësaj, ushtarët dhe forcat e zemrës mund ta radhiten në tri klasë:

E para është forca e stimulimit dhe nxitjes, si epshi (shehvet) që stimulon dhe nxitë për të përfituar gjërat e dobishme, ose zemërimi që nxitë largimin nga gjërat e dëmshme. Këtyre forcave u thuhet edhe *'irade'* (dëshirë/vullnet).

E dyta është forca e cila i fut gjymtyrët në lëvizje për realizimin e këtyre kërkesave. Kësaj i thuhet *'kudret'* (fuqi). Kjo forcë është e shpërndarë në të gjitha gjymtyrët e trupit, veçanërisht në muskuj.

E treta është forca e cila, duke i përshkruar gjërat - i kupton dhe i njeh ato – si agjentët. E këto janë forcat që i njohim si pesë shqisat (shikimi, dëgjimi, prekje, nuhatja dhe shijimi). Edhe këto forca janë të shpërndara në gjymtyrët e njohura. Këtyre u thuhet edhe dituri dhe njohje. Këta ushtarë të brendshëm dhe të jashtëm gjinden në çdonjërin. Organet si mishi, nervi, gjaku, kocka dhe limfa, janë vegla të forcave të brendshme, p.sh. forca e mbajtjes me gishta, forca e të shikuarit me sy, dhe forcat tjera që përdoren nga organet tjera. Ne nuk do të bisedojmë për forcat e jashtme. Këto janë të dukshme. Ne po bisedojmë për forcat e padukshme të zemrës. Pjesa e tretë, e cila kupton dhe njeh, ndahet në dy: një pjesë është e vendosur në të jashtmen e trupit, siç u tregua më lartë – të pesë shqisat, dhe një pjesë tjetër është vendosur në të brendshmen, dhe kjo është pjesa e brendshme e kafkës së kokës, e ato janë pesë;

Kur njeriu sheh diçka, pastaj i mbyll sytë dhe rikujton atë çfarë ka parë, ai në vete sheh të njëjtën pamje. Kësaj i thuhet **'hajal'** (imagjinatë). Kjo pamje më pas qëndron në kokë. Forca që e ruan këtë pamje në kokë quhet **'kuvve-i hafëza'** (forca e kujtesës). Kur njeriu mendon për atë që ka ruajtur në kokë dhe i shton ato njëra-tjetrës – pjesëton, ndanë dhe bashkon, mendon mbi të, – kësaj i thuhet **'kuvve-i mufekkir'** (forca e të menduarit). Pastaj, atë që e ka harruar, e përkujton përsëri, dhe kësaj i thuhet **'kuvve-i muzekkir'** (forca e përkujtimit). Gjithashtu, ai i mbledh në një vend të gjitha që ka dëgjuar, dhe kësaj i thuhet **'hiss-i mushterek'** (ndjenjë e përbashkët). Sikur Allahu Teala të mos kishte krijuar këto forca të brendshme (imagjinatën, kujtesën, të menduarit, përkujtimin dhe ndjenjën e përbashkësisë), truri, por edhe dora dhe këmba do të kishin mbetur bosh.

Këto që i treguam janë pjesët e ushtrisë së zemrës. Të përshkruhet kjo temë me shembuj ashtu që çdokush të kuptojë, fjala zgjatet shumë. Qëllimi nga kjo pjesë, dhe pjesë tjera të ngjashme është të përfitojë dhe ato t'i shfrytëzojë shtresa inteligjente dhe dijetarët e shquar. Por përsëri, me disa shembuj më poshtë kemi bërë të mundur për secilin të kuptojë.

SHEMBULL I USHTARËVE TË BRENDSHËM TË ZEMRËS

Dije se zemërimi (*gadhab*) dhe epshi (*shehvet*), nganjëherë i nënshtrohen zemrës në kuptim të plotë, e ndihmojnë zemrën gjatë udhëtimit të saj dhe bëhen miq të mirë të saj. Dhe nganjëherë është e kundërta – ato bëhen kryengritës kundër zemrës në mënyrë ekstreme. Bile, duke e futur nën dominimin e tyre, e detyrojnë zemrën t'ju shërbejë.

Këtu zemra shkatërrohet dhe mbetet mbrapa në udhëtimin që qon në lumturi të përhershme. Pos forcave që shpjegojmë, zemra ka edhe forca tjera, si dituria, urtësia dhe mendimi, të cilat do t'i shpjegojmë më vonë. Një prej detyrave kryesore të besimtarit është t'i shfrytëzojë këto forca, sepse forcat si dituria, urtësia dhe mendimi janë forca hyjnore karshi zemërimit (gadhab) dhe epshit (shehvet). Zemërimi dhe epshi nganjëherë kalojnë në anën e shejtanit. Nëse besimtari nuk merr ndihmë nga dituria, urtësia dhe mendimi, ai rrëmbehet nga zemërimi dhe epshi; shkatërrimi dhe humbja tij është e sigurt. Kështu është gjendja e shumicës, sepse mendja e tyre është bërë lodër që shërben për shuarje të epshit. Mendja është në gjendje të lavdëruar kur ajo e merr epshin nën urdhrin e vet, sa herë që kjo është e nevojshme, dhe përfiton nga ai. Le ta tregojmë këtë me tre shembuj:

Shembulli i parë: Le të themi që, në trupin e njeriut, ashtu si shpjegojmë më herët, **'nefs-i latife'** është sikur sundimtar i një vendi. Pra, bota e trupit është si vatani, shteti dhe qyteti i nefsit. Gjymtyrët dhe forcat e tjera, janë si mjeshtrit dhe punëtorët. Forcat e mendjes dhe mendimit janë si këshilltarët, të cilët tregojnë rrugën. Epshi është si shërbëtori i sundimtarit që i rekomandon sundimtarit ushqim, pije dhe të ngjashme. Zemërimi dhe përpjekja janë si rojë e sundimtarit. Epshi që e bart ushqimin është si shërbëtori hileqar, gënjeshtar dhe mashtrues. Ai është si dikush që në dukje flet drejt dhe sinqertë, e në realitet është një hileqar i frikshëm dhe një helm vdekjeprurës. Adeti i tij është që vazhdimisht të jetë në kundërshtim dhe të grindet me këshilltarët të cilët tregojnë rrugën e drejtë. Ai në grindje nuk ndalet as për një çast. Duke u shërbyer me këshillat e

këshilltarëve të mençur, sundimtari kupton mendimin e prishtë që rekomandon ky shërbëtor hileqar, nuk i përulet, dhe e ngarkon rojën me detyrë të edukojë këtë shërbëtor. Kur shërbëtori dhe ndihmësit e tij të jenë plotësisht të përlurur nën urdhrin e sundimtarit, pasuria dhe populli i sundimtarit gjen rehati. Nefsi nganjëherë nxjerr zemërimin karshi epshit duke i thyer dëshirat e epshit, e nganjëherë nxjerr epshin karshi zemërimit duke ia thyer atij egërsinë. Atëherë, morali i nefsit zbukurohet dhe forcat e personit arrijnë në maturi. Ata që nuk e ndjekin këtë rrugë bëhen prej atyre për të cilët Allahu Teala thotë:

“A e ke parë ti (Muhammed) atë që duke e ditur, dëshirën e vet e respekton si zot të vetin.” 45-Xhathije: 23

“U dha pas dëshirave të veta. Shembulli i tij është si shembulli i qenit: nëse e ndjek, ai të nxjerr gjuhën, nëse largohesh, përsëri të nxjerr gjuhën.” 7-A’raf: 176

Edhe rreth atyre që largohen prej dëshirave të veta, është urdhëruar:

“Kurse ai që i është frikësuar madhërisë së Rabbit të tij dhe e ka frenuar veten nga dëshirat, pa dyshim që do të ketë për strehë Xhenetin.” 79-Nazi’at: 40, 41

Në çfarë mënyre do të luftohet me këto forca dhe si duhet të përdoren ato, inshallah do të tregojmë në librin **“Rijazet-i Nefs”**.

Shembulli i dytë: Trupi i njeriut është si një qytet, dhe një mendje e zgjuar që e qeveris atë është si një udhëheqës. Forcat e tij të brendshme dhe të jashtme, pra shqisat - janë si ushtarë dhe ndihmës. Ndërsa gjymtyrët janë si qytetarët që i qeverisë udhëheqësi. Nga ana tjetër, **‘nefs-i emmare’** (nefsi që urdhëron të keqen), i cili përbëhet prej zemërimit dhe epshit, është si armiku që sulmon qytetin e udhëheqësit dhe që mundohet të shkatërrojë qytetin. Pra trupi i personit është sikur një qytet kufitar i fushëbetejës, ndërsa nefsi është si roja e këtij qyteti. Në qoftë se kjo rojë (nefsi) e mbron qytetin karshi armikut, përleshet me armikun dhe e mund, kur kthehet në prani të udhëheqësit– respektohet.

Ndërsa Allahu Teala thotë:

“Ata që luftuan me pasurinë dhe me jetën e tyre, Allahu i gradoi në një shkallë më lartë mbi ata që qëndruan.” 4-Nisaë: 95

Në qoftë se nefsi e humb këtë qytet kufitar, detyrën e lë pas dore, ai qortohet dhe dënohet. Allahu Teala hakmerret. Në ditën e kiametit i thotë:

“O roje e keqe, e ngrëne mishin, ke pirë qumështin, por nuk u shqetësove kur i humbe, e as nuk ndihmove. Sot do të hakmerrem në ty.”

Këtë luftë e vë në dukje Resulallahu s.a.v.s., me një transmetim të dobët të hadithit:

“U kthjem prej xhihadit (luftës) të vogël në xhihad të madh.”

Shembulli i tretë: Mendja është si një gjuetar në kali. Epshi është si kali, ndërsa zemërimi është si qen gjahu. Nëse gjuetari është i aftë, e ka kalin të nënshtruar dhe qenin e edukuar, atëherë e kap gjahun; por nëse gjuetari është pa përvojë, kali rebel dhe i paedukuar e qeni nuk ka njohuri për gjuetinë, ai e meriton shkatërrimin. Pra pa-përvoja e gjuetarit është si padituria dhe paaftësia e personit. Edhe rebelimi i kalit është si epshi i ndezur. Sulmi i qenit majtas a djathtas pa nevojë është si zemërimi i gufatur dhe është poshtërim i njeriut.

Kërkojmë ndihmë prej Allahut Teala.

VEÇORITË E ZEMRËS SË NJERIUT

Të gjitha këto që i treguam në lidhje me zemrën, siç janë te njeriu, ekzistojnë edhe te kafshët. Pra, kjo është cilësi e përbashkët për të gjitha gjallesat, sepse si te njeriu edhe te kafshët ekziston zemërimi (gadhab), epshi (shehvet) dhe tipare të ngjashme të jashtme (zahir) dhe të brendshme (batin). Delja, sapo të sheh ujkun, e di me zemër se e ka armik, dhe ikë prej tij. Ky është një perceptim i brendshëm i deles. Të flasim tani rreth veçorive të zemrës së njeriut, sepse falë saj nderi i njeriut ngritët dhe fiton aftësi për t'iu afruar Allahut Teala. Edhe kjo mbështetet në dy shtylla: dituri dhe irade (dëshirë).

1. Dituria është të njihen me mendje sendet, të vërtetat, në lidhje me këtë botë dhe me ahiret. Kjo dituri është përtej ndjenjave, e në këtë çështje kafshët nuk kanë asgjë të përbashkët me njerëzit. Ndoshta, dituritë që janë gjithëpërfshirëse dhe të domosdoshme janë veçori të mendjes. Për shembull, njeriu jep gjykim se një person nuk

mund të gjendet në të njëjtën kohë në dy vende. Ky gjykim përfshin të gjithë. Ndërkaq me ndjenjë, njeriu mund të njeh vetëm ndonjë person. Ky gjykim për të gjithë personat është një njohje përtej kuptimit të ndjenjës së tij. Në qoftë se e kuptove këtë dituri të domosdoshme në të jashtme (zahir), është e qartë se edhe dituritë e tjera teorike janë kështu.

2. Irade (dëshira): Njeriu, duke kuptuar me mendje përfundimin e një pune, kur e di se në cilën anë është mirësia, nga brenda orientohet në atë anë, mundohet të sigurojë sebetpet (shkaqet) dhe atë e dëshiron. Kjo është një dëshirë tjetër nga dëshirat e epshit dhe dëshirat shtazarake. Bile, kjo nganjëherë bëhet kundër dëshirave të epshit. Për shembull, epshi nuk dëshiron të japë gjak (për shërim), por mendja dëshiron, bile për këtë çështje edhe harxhohet. Gjatë sëmundjes, epshi dëshiron të hajë ushqim të shijshëm dhe ëmbëlsira, por mendja, pasi që e di se këto janë të dëmshme për sëmundjen, refuzon këto ushqime, e ky refuzim nuk është dëshirë e epshit. Në qoftë se Allahu Teala do të kishte krijuar mendjen e cila kupton vetëm përfundimin, dhe nuk do të kishte krijuar fuqinë nxitëse e cila i futë në veprim gjymtyrët sipas nevojës së mendjes dhe urtësisë, ky gjykim i mendjes sigurisht se do të ishte kot.

Me këtë shpjegim u kuptua që zemra e njeriut dallohet prej asaj të kafshëve, të cilat nuk kanë dituri dhe dëshirë (irade). Bile, edhe fëmijët në vitet e para janë të privuar nga kjo dituri dhe dëshirë. Vetëm se, me arritjen e moshës së pjekurisë, ata i fitojnë këto forca. Por, edhe te fëmija ekzistojnë ndjenja të jashtme dhe të brendshme. Për të fituar fëmija këto dituri, ka dy grada:

E para, fëmija i di dituritë e domosdoshme, të cilat i posedon që nga fillimi. Për shembull, ai e di që e pamundura është e p realizueshme dhe e mundshmeja e mundur. Ai, edhe pse i posedon këto dituri të domosdoshme, është i privuar prej diturive teorike – megjithatë, nëpërmjet diturisë së domosdoshme ai për një kohë të shkurtë dhe me lehtësi mund t’i përfitojë edhe dituritë teorike. Gjendja e personit të tillë në lidhje me dituritë e tjera është si gjendja e shkruesit, i cili vetëm e di që me laps mund të shkruhen shkronjat. Duke ditur vetëm kaq, ai ende nuk ka arritur në nivel për të shkruar.

Dhe e dyta është përvoja – posedimi i diturive të përfituara me anë të mendimit dhe veprimit. Kjo është si një thesar i tij. Kësaj mund t’i drejtohet kur të dëshirojë. Kjo është si shkruesi që mund të shkruaj bukur. Edhe nëse ky person nuk është i zënë me shkrim, pasi ka aftësi për të shkruar, ai quhet shkrues. Ky është qëllimi i gradës së njerëzimit. Por, në këtë gradë ekzistojnë nivele të panumërta. Njerëzit dallojnë nga njëri-tjetri sipas diturisë që posedojnë; më shumë ose më pak. Dhe gjithashtu dallojnë sipas rëndësisë së njohurive që posedojnë. Në të njëjtën kohë, këto dituri dallojnë nga njëra-tjera edhe për nga rrugët e përfitimit të tyre. Disa zemra, këto dituri i përfitojnë me anë të frymëzimit (*ilham*) dhe zbulimit (*keshf*)⁵. Disa i përfitojnë ato me mësim dhe veprim. Disa e përfitojnë këtë dituri lehtë dhe shpejt. Një pjesë e përfiton ngadalë dhe vështirë. Andaj, këtu ndahen gradat e pejgamberëve, dijetarëve, evliave dhe besimtarëve të

⁵ **Keshf**: zbulim; hap; qelë; të dihet një gjë para se të ndodh; nxjerrja në shesh e një sekreti ose të fshehte; njoftim dhe dalje në shesh e një gjëje të fshehtë me anë të frymëzimit;

devotshëm. Gradat e lartësimit në këtë çështje janë të panumërta, sepse dituria e Allahut Teala është e pafund. Grada më e lartë është grada e *nubuvvetit* (pejgamberllëkut), sepse aty sqarohen të gjitha të vërtetat (hakikatet), ato zbulohen pa mundim dhe vështirësi, dhe me rrugë të shpejtë. Njeriu që përfiton këtë lumturi nuk i afrohet fizikisht kësaj lumturie, por i afrohet asaj me njohjen e cilësive dhe hakikateve të Allahut. Nivelet e këtyre gradave janë stacione (vende ndalese), për ata që udhëtojnë drejt Allahut. Edhe këto janë të panumërta. Çdo udhëtar (salik) mund të dijë vetëm stacionet që i ka mbërri vet, dhe ato që i ka lënë mbrapa. Stacionet që i ka përpara nuk mund t'i dijë, por beson që përpara ka edhe shumë stacione. Sikur ne që i besojmë pejgamberllëkut dhe pejgamberit, por nuk e dimë hakikatin e pejgamberllëkut sepse hakikatin e pejgamberllëkut e di vetëm pejgamberi. Kjo është si foshnja ende e pa-lindur që nuk e di gjendjen e fëmijës, e as fëmija që nuk e di gjendjen e fëmijës që tashmë posedon dituri të domosdoshme; dhe si ky fëmijë që nuk e di mençurinë dhe nivelin e personit të rritur që ka përfituar dituritë teorike, edhe personi i mençur nuk di atë për të cilën Allahu Teala u ka qelë dyert e mëshirës pejgamberëve dhe evliave. Dyert e mëshirës të cilat Allahu Teala i hap për njerëzit, askush nuk mund t'i mbyll. Ndërsa kjo mëshirë (rahmet), falë bujarisë dhe mirësisë së Allahut Teala është me bollëk. Nuk është posaçërisht për një person, ose për disa persona, por shfaqet në zemrat të cilat përgatiten për frymëzim nga mëshira e Allahut Teala.

Ndërsa Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Sigurisht që gjatë jetës suaj nga Rabbi juaj ka frymëzim për ju. Përgatituni për këtë.”⁶

Përgatitje e mundshme në këtë rast është pastrimi i zemrës nga veset e këqija.

Për këtë mirësi të Allahut Teala, Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Allahu Teala çdo natë zbret në shtresën e parë të qiellit dhe pyet: *“A ka kush që kërkon, Unë ta pranoj kërkesën e tij?”*

Resulallahu s.a.v.s., në një tjetër hadith kudsî thotë:

“U shtuan dëshirat dhe kërkesat e robërve të mirë për takim me Mua. Por, përmallimi Im për ta është më i madh (i fortë).”⁸

Përsëri, Allahu Teala përmes hadithit kudsî thotë:

“Po të më afrohet robî Im Mua (me zemër dhe vepra të mira) një pëllëmbë, Unë (me rahmetin Tim) i afrohem atij një kut.”⁹

Të gjitha këto transmetime janë tregues që drita (nur) e diturisë duhet të qëndrojë e lidhur për zemër, këto dhurata të Allahut Teala tregojnë se Allahu nuk ndalon dhe nuk është dorështrënguar. Allahu Teala është larg këtyre ndalesave dhe larg të qenit dorështrënguar. Mbetja e zemrave mbyllur ndaj dritës së diturisë është për shkak të preokupimit të zemrave me gjëra të këqija. Zemrat janë si enë; ashtu si nuk hyn ajër

⁶ Transmetojnë Ebu Hurejre r.a. dhe Ebu Said r.a.

⁷ Autori i *‘Firdevsit’* Iraki, transmeton nga Ebu’d-Derda.

⁸ Nga *‘Musned-i Firdevs’*.

⁹ Buhariu dhe Muslimi, nga Ebu Hurejre r.a.

në një enë të mbushur me ujë, edhe në zemrat që merren me gjëra tjetër përveç Allahut Teala, nuk hyn njohja (*marifet*) e madhësisë së Allahut Teala. Resulallahu s.a.v.s., duke vënë këtë në shenjë, thotë:

“Sikur shejtani të mos kishte qarkulluar në zemrën e njeriut, ai (njeriu) do të kishte parë botën e melekëve në qiell.”¹⁰

Nga ky shpjegim i shkurtë është kuptuar se veçoria e njeriut është dituria dhe urtësia (*hikmet*). Nga degët e llojllojshme të diturisë, dituria më e ndershme është të njihet Dhati (Qenia) i Allahut Teala, cilësitë dhe veprat e Tij.

Në këtë është përsosmëria e njeriut. Lumturia e tij dhe afrimi Allahut Teala është me anë të kësaj përsosmërie. Andaj, trupi është bartësi i zemrës, e zemra është vendi i diturisë. Qëllimi i njeriut, si edhe veçori e tij, është dituria. Kjo është arsyeja pse është krijuar. Kali, edhe pse e ka të përbashkët me gomarin bartjen e ngarkesës, dallon nga gomari pasi që në luftë vrapon drejt armikut, e gjithashtu dallon edhe me formë dhe dukje të bukur. Kjo tregon se kali është krijuar për këtë urtësi. Kali që i humb këto cilësi bie në nivelin e gomarit. Edhe njeriu, disa cilësi i ka të përbashkëta me kafshët, e me disa cilësi të veçanta ndahet prej tyre. Këto veçanti janë që Allahu Teala u ka dhënë melekëve *mukarrebun*. Njeriu është një lloj i krijimit të veçantë, në mes të kafshëve dhe melekëve. Nga pikëpamja e ushqimit dhe shumimit, njeriu është si një bimë, nga pikëpamja e ndjenjave dhe lëvizjes me vetë-dëshirë – si kafshë, dhe nga pikëpamja e formës dhe trajtës si një fotografi në mur. Veçori e njeriut është të njoh hakikatin e sendeve. Ai që përdor të gjitha organet dhe gjymtyrët në dituri dhe veprim, duke u përngjarë

¹⁰ Buhariu dhe Muslimi, nga Ebu Hurejre r.a.

melekëve, e meriton pjesëmarrjen në shoqërinë e tyre dhe ka merituar të marrë emërtimin *melek*. Prandaj, gratë që e panë Jusufin alejhisselam, siç na lajmëron Allahu Teala në Kur’ani Kerim, thanë:

“Ky nuk është njeri, por qenka një melek fisnik!”

12-Jusuf: 31

Në anën tjetër, ai që ndjek rrugën e kënaqësisë trupore, i tërë synimi i të cilit është vetëm për t’u ushqyer, ai bie në nivelin e kafshës. Ose bëhet si kau jo i zgjuar, ose si derri grykës, ose si qeni sulmues, ose si deve urrejtëse, ose si luani kryelartë, ose si dhelpa hileqare, ose bëhet si një shejtan përçarës me të gjitha këto të këqija të mbledhura në vete. Çdo ndjenjë dhe gjymtyrë është një mjet për t’i arritur Allahut Teala. Për këtë do të bisedohet në librin **‘Shukur’**. Kush i përdor ndjenjat dhe gjymtyrët si ndihmës në udhëtimin drejt Allahut Teala – shpëton, kush devijon nga ky udhëtim, poshtërohet dhe humbet.

Si përmbledhje, në këtë çështje esenca e lumturisë është kjo: Qëllimi i njeriut duhet të jetë arritja e kënaqësisë (rizasë) së Allahut Teala, ahireti – vendbanim i përhershëm; duhet të pranohet kjo botë si vendqëndrim i përkohshëm, trupi si bartës, gjymtyrët si shërbëtorë të trupit, dhe vetë intelektin e njeriut – si sundimtar, i cili vendoset në qendër të shtetit; pra në zemër, që është qendra e trupit. **‘Kuvve-i hajalije’** (forca e imagjinatës) duhet të pranohet si një postier, që është vendosur në pjesën e përparme të trurit, sepse aty vendosen të gjitha informatat/lajmet e ndjenjave. Edhe **‘Kuvve-i hafiza’** (forca e kujtesës) e cila është e vendosur në pjesën e prapme të trurit, duhet të pranohet si përfaqësues thesari, sepse çdo gjë fshihet aty. Duhet të pranohet gjuha si përkthyes, gjymtyrët të cilat lëvizin si sekretar, pesë ndjenjat

si agjentë – informatorë, dhe çdonjërës prej tyre t'i jepet nga një detyrë. Si shembull, të ngarkohen me detyra si – syri me ngjyra, veshi me zëra, hunda me erëra, dhe gjymtyrët tjera me atë për çka janë kompetentë – për atë të përdoren. Sepse çdonjëra nga këto gjymtyrë, informatat që i marrin nga bota e vet, ia përcjellin *'kuvve-i hajalije'* (forcës së imagjinatës), ndërsa kjo ia dorëzon forcës së kujtesës (kuvve-i hafiza). Pra *kuvve-i hajalije* është postieri, e *kuvve-i hafiza* përfaqësues i thesarit. Ky përfaqësues i thesarit, informatat që i merr – ia dorëzon sundimtarit. Sundimtari merr nga këto informata ato të cilat i nevojiten për të administruar shtetin, për të arritur në qëllimin e udhëtimit dhe për të përballuar armiqtë të cilët e sulmojnë, si dhe për të dëbuar hajdutët që mund të dalin në rrugë dhe të pengojnë udhëtimin. Kur sundimtari vepron në këtë mënyrë, ai falënderon për mirësinë e Allahut, bëhet prej të lumturve. Në qoftë se sundimtari i lë pas dore këto që thamë dhe këto informata që i merr i përdor për zemërim, epsh dhe dëshira të tjera të momentit, ose gjatë udhëtimit ndalet dhe mundohet me ndërtimin e kësaj bote (dynjasë) – e kjo botë nuk është vatani i tij i vërtetë, por është ahireti - atëherë poshtërohet dhe humbet. Ai bëhet mosmirënjohës, ushtarët që ia dhuroi Allahu nuk i përdori kundër armiqve të Allahut Teala dhe tradhtoi ushtrinë e Allahut, bëhet i keq dhe meriton dënimin e Allahut. Ruana Allah prej kësaj!

Duke i vënë në fokus këto që treguam me shembuj, Ka'be el-Ahbar tregon:

"Shkova në vizitë te Aisha r.anha., dhe i thashë:

-Syri i njeriut e tregon rrugën, veshi lajmëron për rrezikun, gjuha është përkthyes, duart, krahët edhe këmbët janë si bartës që kryejnë shërbimin e postierit, ndërsa zemra është si sundimtari. Në qoftë se sundimtari është në rehati

dhe qetësi, edhe të afërmit e tij dhe ushtria (ndihmësit) janë në rehati dhe qetësi. Në këtë, Aisha r.anha. tha:

-Edhe unë e kam dëgjuar Resulallahun s.a.v.s. duke thënë kështu.¹¹

Edhe Alia r.a. zemrën e simbolizon kështu:

“Allahu Teala ka enë në sipërfaqen e tokës. Ato enë janë zemrat e njerëzve.

Zemrat që janë më të mira, më të buta, më të pastra dhe më të qëndrueshme janë më të dashura tek Allahu.” Pastaj, duke shpjeguar këto fjalë, tha:

“Zemra e tillë është në fe e qëndrueshme, në besim dhe bindje e pastër dhe ndaj shokëve e butë.”

Këtë shpjegim e vënë në shenjë ajetet:

“Janë të ashpër kundër jobesimtarëve, janë të mëshirshëm ndërmjet vete.” 48-Fet’h: 29

“Drita e Tij shëmbëllen me atë të një kamareje.”

24-Nurë: 35

Ubej b. Ka’b r.a. në tefsirin e këtij ajeti thotë: *“Është zemra e besimtarit që mbushet me dritë (nur)”*.

Dhe për ajetin:

“Ose janë si errësit në detin e thellë.”, 24-Nurë: 40;

ka thënë se e përfaqëson zemrën e munafikut.

Zejd b. Eslem në komentin e ajetit:

“Në Pllakën e Ruajtur mirë (Leuhi Mahfûdh)”

85-Buruxh: 22

ka thënë:

¹¹ Transmetojnë Ebu Nuajm në veprën *‘Tibb-i Nebevi’*, Taberani në *‘Musned-i Shami’* dhe Bejhaki në *‘Shuabu’l-Iman’*.

“Kuptimi nga Leuhi Mahfûdh është zemra e muminut (besimtarit).”

Edhe Sehl-i Tusteriu ka thënë:

“Zemra dhe gjoksi janë si Arshi dhe Kursi.”

Këta janë shembujt e zemrës.

VENDI I MBLEDHJES SË CILËSIVE TË ZEMRËS

Shpjegim dhe shembuj

Dije se njeriu ka dalë në shesh nga bashkimi i katër komponentëve. Për këtë arsye te njeriu janë përmbledhur katër cilësi, e që janë: egërsia, shtazorja, shejtanijet (djallëzorja) dhe rabbanijet (hyjnorja). Kur hidhërimi dhe ofendimet mposhtin njeriun, ai zemërohet dhe egërsohet, fizikisht dhe me fyerje sulmon çdokënd rreth tij. Kur e mposht shehveti (d.m.th: epshi - kërkesa për ngrënie, pirje, të folur, shikim, seks), bëhet si kafshë e dhënë pas barkut dhe seksit. Meqenëse tek njeriu gjendet një urdhër hyjnor (rabbani), siç është urdhëruar në ajet, ku Allahu Teala thotë:

“Thuaj: Shpirti është nën urdhrin e Rabbit tim.”

17-Isra: 85,

njeriu i mbështetet pretendimit për veten hyjni, për sundim dhe epërsi, dëshiron veçori në gjithçka dhe për të qenë vetëm ai zotëri - dëshiron të largohet nga nënshtimi urdhrave që i janë dhënë dhe nga modestia, ka zell për të gjitha dituritë dhe pretendon se i di të gjitha dituritë. Kur i thuhet që është dijetar – gëzohet, e kur i thuhet se është i paditur (xhahil) mërzitet. Ndërkaq, nga cilësitë e rububijetit është përfshirja e të gjitha të vërtetave (hakikat) dhe fuqia

absolute e çdo gjëje, për të cilën njeriu është lakmues i pangopur.

Njeriu dallon në pikëpamje të mendimit dhe kuptimit nga kafsha dhe në të njëjtën kohë përmbanë zemërimin dhe epshin (shehvet), si kafsha. Ai posedon edhe cilësinë e shejtanit, dhe me këtë është bërë posedues i fuqisë së të keqes. E përdor mendjen dhe mendimet në rrugë të këqija, kërkon rrugët e mashtrimit dhe të dredhive dhe mundohet të ekspozojë të keqen si mirësi. Pra, ky është ahlaku i shejtanit. Te çdo njeri ka cilësi nga këto katër esenca, d.m.th. nga rabbanijeti, shejtanijeti, egërsia dhe shtazorja. Të gjithë këto mblidhen në zemër, dhe çdokush merr qëndrim sipas personalitetit të vet. Te disa janë prezent të katërtat, te dikush njëra më shumë e tjetra më pak, d.m.th. është sikur nën lëkurën e njeriut të jenë mbledhur derri, qeni, shejtani dhe sundimtari. Derri simbolizon epshin (shehvet). Në esencë, derri nuk është qortuar për shkak të ngjyrës, formës a pamjes, por është qortuar sepse është i pangopur dhe armiqësor. E qeni simbolizon zemërimin. Kafshët e egërsuara – që kafshojnë - nuk janë të egra dhe nuk kafshojnë për shkak të ngjyrës, formës a pamjes, por ndoshta kanë në shpirtrat e tyre egërsi dhe dëshirë për kafshim. Në tiparet e brendshme të njeriut ekziston agresiviteti dhe natyra e kafshës së egër, e bashkë me këtë edhe epshi (shehveti) i derrit. Derri, ndjenjen e epshit e shtynë në vepra të këqija haptas dhe në veprime të shëmtuara; cilësia e kafshës së egër shihet në zemërim e dhunë; ndërsa mënyra e shejtanijetit, epshin e derrit dhe zemërimin e kafshës së egër mundohet të nxisë në veprim, mundohet të shfaqë të keqen si mirësi. Me këto, shejtani mundohet të gostisë ata që kanë prirje për këto gjëra. Edhe sundimtari, që është mendja, me shkëlqimin e dritës dhe me

mendjemprehtësi, është e ngarkuar me detyrë të nxjerrë në shesh ndyrësitë e shejtanit, me zemërim sulmon derrin, që të thyhet epshi i tij. Zemërimi e thyen epshin. Edhe agresiviteti i qenit thyhet me sulmin e derrit. Në këtë mënyrë, që të dytë nënshtrohen në drejtim të mendjes.

Në qoftë se mendja, të cilës po i themi *sundimtar*, vepron kështu, që e mposhtë epshin me zemërim dhe zemërimin me epsh, dhe bëhet imponues i kësaj, arrihet drejtësia, ajo manifestohet në trup, dhe të gjitha punët rrjedhin në rrugë të drejtë. Në qoftë se mendja nuk mund të mposhtë epshin dhe zemërimin, atëherë ata e mposhtin mendjen dhe e marrin nën drejtimin e tyre. Për ngopje të derrit dhe për të bërë qenin e lumtur, kërkon çdo lloj rruge të dredhisë, tërë angazhimi bëhet shërbim derrit (epshit) dhe qenit (zemërimin). Shumica e njerëzve janë në këtë gjendje. Të gjitha mendimet e tyre fokusohen në bark dhe në organin seksual, si edhe për të kritikuar armiqtë.

Sa e habitshme është se si këta njerëz çuditen me idhujtarët të cilët i adhurojnë statujat e gurit. Në qoftë se u hiqet perdja nga syri i zemrës do të shihnin siç shohin njerëzit e përkryer me syrin e zemrës gjendjen e vërtetë të vetes, se si të përkulur qëndrojnë para derrit, ndonjëherë në sexhde, e ndonjëherë në ruku, duke pritur të gatshëm urdhrat dhe sinjalin e tij; çka kërkon (derri) nga ushqimi dhe kënaqësitë e pashore - ata janë të gatshëm menjëherë të plotësojnë dhe të jenë në shërbimin e tij. Ose do të shihnin veten duke adhuroar të përkulur karshi një qeni agresiv, gati për të bërë vepra me urdhrin e tij, dëgjojnë fjalën e tij, mundohen të zbatojnë urdhrat e tij me përpikëri dhe kujdes. Ata me këtë

gjendje e gëzojnë shejtanin, sepse shejtani nxit derrin dhe qenin në kryengritje dhe i drejton njerëzit t'i përshtaten urdhrave të tyre. Andaj, duke iu përshtatur derrit dhe qenit, njeriu në të vërtetë i përshtatet shejtanit. Do të thotë, ai që i përshtatet nefsit dhe zemërimit, në të vërtetë është duke iu përshtatur shejtanit.

Prandaj, secili duhet të kontrollojë punët e veta. Duhet të mendojë me çfarë qëllimi lëvizë, me çfarë qëllimi ndalet, pse ngritët, pse ulet, pse folë, pse heshtë. Nëse njeriu shikon me syrin e zemrës, e kupton që tërë jetën ka vepruar në anë të nefsit dhe epshit. Kjo gjendje është kulmi i zullumit. Sepse me këtë sjellje, pronari është shndërruar në pronë, mbreti në skllav, zotëria në shërbëtor dhe fituesi në humbës. E drejta e mendjes është të drejtojë dhe të kontrollojë. E ky person ka vepruar kundër mendjes, duke u bërë shërbëtor i zemërimit, epshit dhe shejtanit. Duke iu përshtatur këtyre të triave, disa cilësi të këqija do të mblidhen në zemër, ashtu që, këto të këqija në zemrën e tij do të bëhen një gjendje e natyrshme, do ta errësojnë dhe mbysin zemrën.

Me përshtatje derrit, i cili simbolizon epshin, paraqiten të këqijat si paturpësia, karakteri i keq, lakmia dhe pangopësia, xhelozia, dyfytirësia, poshtërimi, veprat boshe dhe të ngjashme.

Përshtatja qenit, i cili simbolizon zemërimin; sjell të këqijat si sulmim, agresivitet, shqetësim, rrezik, madhështi, mendjemadhësi, kryelartësi, ofendim, fyerje, përbuzje, luks, dëshirë për gjëra të këqija, zullum dhe të ngjashme.

Kur njeriu është nën urdhrat e zemërimit dhe epshit, që në të vërtetë i është përshtatur shejtanit, paraqiten vese të këqija si intriga, mashtrimi, dredhia, paturpësia, përzierja, dhe të ngjashme.

Në qoftë se veprohet kundër kësaj, zemërimi, epshi dhe shejtani merren nën drejtimin e mendjes, e cila është cilësi *rabbani* (hyjnore), në zemër vendosen cilësitë të cilat janë nga rabbani, si dituria, urtësia (hikmet), bindja dhe kuptimi i esencës së çdo gjëje. Atëherë njeriu, përmes diturisë dhe *basiretit*¹² mbizotëron me këto të gjitha. Falë diturisë së përkryer, e meriton të jetë udhërrëfyes për të tjerët. Tani nuk i përshtatet zemërimit dhe epshit. Pra, duke marrë nën kontroll epshin, e vë atë në maturi, dhe te personi paraqiten nderi, kënaqësia, qetësia, devotshmëria, gëzimi dhe pamja e bukur. Veçanërisht, paraqiten turpërimi, zgjuarsia, toleranca, zemërmirësia dhe ahlaku i bukur. Tutje, duke zotëruar mbi zemërimin, kjo e sjell atë në maturi dhe bëhet posedues i ahlakut të bukur, trimërisë, zemërgjerësisë, kontrollimit të nefsit, durimit, dinjitetit, bamirësisë, qëndrueshmërisë, fisnikërisë, mirësjelljes dhe të ngjashme.

Zemra është si një pasqyrë që reflekton këto cilësi vepruese. Këto vepra hyjnë në zemër me radhë. Në qoftë se hyn ahlaku i bukur i përmendur më lartë, shtohet shkëlqimi dhe drita (nur) e zemrës. Aty shkëlqen madhështia e Hakut, fillojnë të zbulohen çështjet e vërteta që kërkon feja. Pikërisht duke vënë shenjë në këtë zemër, Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

¹² **Basiret:** mendjemprehtësi; syri i zemrës; të hetohet dhe kuptohet hakikati me zemër; të dihet hakikati i një sendi me zemër; fuqia e shenjtë (fuqia e Evliasë).

“Kur Allahu i dëshiron të mirën robit të Tij, e dërgon një vaiz (këshilltar) në zemrën e tij.”¹³

dhe në këtë hadith:

“Kujt i gjendet në zemër një vaiz që bën llogari, Allahu Teala bëhet mbrojtës mbi të.”

Kjo është edhe zemra në të cilën është vendosur dhikrullahu. Në ajet thuhet:

“Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!” 13-Ra’d: 28

Ndërsa veset e këqija janë si tym i zi. Ky tym ngritët në pasqyrën e zemrës, e duke u bërë shtresë në pasqyrë, e errëson dhe e verbëron atë. Zemra e tillë është pengesë për dritën (nur) hyjnor. Pra, kjo është zemër e mbuluar dhe e vulosur. Për këtë zemër, Allahu Teala thotë:

“Nuk është ashtu! Por veprat e tyre (të këqija) ua kanë mbuluar zemrat.” 83-Mutaffifin: 14

“A nuk e është e qartë për ata që trashëguan tokën e banorëve të mëparshëm të saj, se, nëse Ne dëshirojmë, i dënojmë për gjynahet e tyre dhe ua vulosim zemrat, që të mos dëgjojnë?!” 7-A’raf: 100

Mosdëgjimi i tyre është i lidhur me vulosjen e zemrës me gjynahe. Ndërsa duke lidhur dëgjimin në *takva* (devotshmëri):

“Frikësojuni Allahut dhe dëgjojeni!” 5-Ma’ide: 108

¹³ Ebu Mansur Dejlemi në **‘Musned-i Firdevs’** nga Ummu Selemi.

Dhe në një ajet të tjetër:

“Kini frikë Allahun se Allahu ju dhuron dituri”

2-Bekare: 282

Duke shumëuar gjynahet, zemra vuloset, dhe verbërohet nga e vërteta dhe nga kuptimi i mirësive të fesë. Nuk i jep rëndësi ahiretit, i jep rëndësi kësaj bote dhe i lidhet plotësisht dynjasë. Fjalët në lidhje me ahiretin hyjnë nga një vesh dhe dalin nga tjetri. Këto fjalë nuk vendosen në zemër, nuk stimulojnë në pendim, në edukimin e vetes dhe nuk përmirësojnë mangësitë. Të tillët janë pa shpresë nga ahireti.

Ky është kuptimi i fjalës **“me gjynahe, zemra errësohet”** që shpjegohet në Kur’ani Kerim dhe në hadithet e ndershme. Mejmun b. Mihran ka thënë:

“Kur njeriu bën një gjynah, në zemër i vendoset një pikë e zezë; kur bën teube – pastrohet. Nëse nuk bën teube dhe vazhdon në të këqija, pika-pika zemra plotësisht errësohet dhe kjo përfshinë tërë zemrën. Kjo është ‘ran’.”¹⁴

Ndërsa Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Zemra e besimtarit është shumë e pastër, aty ka një dritë që shkëlqen. Ndërsa zemra e qafirrit është e zezë, e errët dhe e kthyer mbrapsht.”¹⁵

Me përshtatje urdhreve të Allahut Teala dhe duke kundërshtuar epshin, zemra ndriçohet dhe shkëlqen; ndërsa çdokush që dalldiset në kryengritje, zemra i errësohet. Ai që pas një gjynahu të bërë, menjëherë bën një mirësi për ta fshirë ndryshkun e gjynahut, nuk i errësohet zemra. Në qoftë

¹⁴**Ran:** Ngurtësim i zemrës; njollose; shqetësimi i zemrës; ndryshk; papastërti.

¹⁵ Ahmed dhe Teberani në **“Sagir”** nga Ebu Saidi dhe është vazhdim i hadithit në vijim.

se bëhet njëjtë si me pasqyrën kur i fryhet dhe pastaj fshihet dhe përsëri fryhet dhe fshihet, asaj i pakësohet drita; kjo pasqyrë nuk mund të jetë plotësisht e pastër.

Resulallahu s.a.v.s., kështu thotë:

“Zemrat ndahen në katër lloje:

1. Zemra e pastër; aty ka një nur që shkëlqen. Kjo është zemra e besimtarit.

2. Zemra e errësuar dhe e kthyer mbrapsht. Kjo është zemra e qafirit.

3. Zemra e vendosur në këllëf dhe gojëlidhur - kjo është zemra e munafikut (përçarësit).

4. Zemra e braktisur, e larguar; aty ka edhe iman edhe dyfytërsi. Imani në këtë zemër është si ujë i pastër që shumon bizele, është jeshil. Ndërsa dyfytërsia është si plagë që i rritet, mbushur me gjak me qelb. Cili fiton, me atë vlerësohet.

Në një transmetim tjetër: **“...cili fiton, andej anon”**.¹⁶

Ndërsa Allahu Teala kështu thotë:

“Ata që i frikësohen Allahut, kur u vjen ndonjë mendim i ligë nga shejtani, i kujtojnë (urdhrat e Tij), e atëherë e shohin rrugën e drejtë.” 7-A’raf: 201

Pra, shkëlqimi i zemrës dhe soditja shpirtërore realizohet me dhikër, dhe kjo është e mundur vetëm me devotshmëri. Devotshmëria është dera e dhikrit, dhikri - derë e zbulimit të fshehtësisë (*keshf*), dhe zbulimi i fshehtësisë është dera e madhe e shpëtimit përmes së cilës arrihet Allahut.

¹⁶ Ahmed dhe Teberani në **“Sagir”** nga Ebu Saidi, dhe është vazhdim i hadithit të mëparshëm.

GJENDJA E ZEMRËS NË LIDHJE ME DITURINË

Ta dish se zemra është vendi i diturisë. Kur themi zemër, flasim për personalitetin tonë shpirtëror (zemër shpirtërore), që drejton organet tona. Të gjitha këto organe i shërbejnë dhe i përshtaten kësaj zemre. Kur themi *zemër*, nuk e kemi fjalën për zemrën materie. Ne po flasim për këtë zemër shpirtërore; Çka është pasqyra në lidhje me ngjyrat dhe format, edhe kjo zemër është njëjtë në lidhje me hakikatin e njohurisë. Siç pasqyrohet forma në pasqyrë, ashtu edhe çdo njohuri ka një hakikat, dhe çdo hakikat ka një formë. Kjo formë vendoset në pasqyrën e zemrës dhe aty del në shesh. Andaj, pasqyra është tjetër, figura e personit është tjetër, kurse pasqyrimi i tij në pasqyrë prapë diçka tjetër. Këto janë tri gjëra të ndryshme. Edhe këtu ka tri ndarje: (1) zemra, (2) hakikati i gjërave dhe (3) shfaqja e këtyre hakikateve në zemër. Dijetari posedon zemrën në të cilën kanë hyrë hakikatet e gjërave. Hakikatet e gjërave janë vetë njohuria. E dituria përbëhet nga shfaqjet e hakikateve të gjërave në pasqyrën e zemrës.

Si shembull të ndarë, ta marrim shpatën: Për të mbajtur shpatën, duhet një mbajtëse, e për të kapur mbajtësen duhet një dorë. Pasi të jetë gjetur mbajtësja dhe dora, ekziston edhe vet shpata që duhet mbajtur. Ngjashëm me këtë, arritjes së njohurive dhe vendosjes së tyre në zemër, i thuhet *dituri*. Në mes ekziston edhe një zemër, por dituria ende nuk është përfutur. Sepse dituria përbëhet prej arritjes e atyre hakikateve në zemër, që ende nuk janë realizuar. Për shembull kemi mbajtësen e shpatës, kemi dorën që e mbanë, por nuk ka mbajtje, sepse shpata ende nuk është marrë në dorë.

Po, mbajtja përbëhet nga marrja në dorë e shpatës dhe futja e saj në shuplakë. Ndërsa te dituria, vet sendi i njohur nuk hyn në zemër. Në këtë pikëpamje ka dallime. Për shembull, me njohjen e një zjarri dhe me të diturit për të, vet zjarri nuk hyn në zemër, por në zemër na vendoset pamja e zjarrit përshtatshëm me hakikatin dhe cilësitë e zjarrit. Ndoshta prezantimi me pasqyrë është më i përshtatshëm se sa me shpatë. Kjo sepse vetë personi nuk vendoset në pasqyrë, por vetëm pamja e tij. Ngjashëm kësaj, vendosjes në zemër të një pamjeje në përputhje me hakikatin e diturisë, i jepet emri *dituri*. Siç do të tregohet më poshtë, si nuk shkëlqen pamja në pasqyrë nga këto pesë shkaqe, edhe në zemër nuk shkëlqen dituria, po nga këto pesë shkaqe:

1. Mangësia e reflektimit në pasqyrë. Nuk ka pasqyrim nëse më parë pasqyra nuk është lustruar.
2. Edhe po të jetë pasqyra në rregull, ajo nuk do të pasqyrojë nga ndryshku, papastërtia a pislëku.
3. Mos kthimi i pasqyrës në drejtimin e duhur, ngelja e objektit prapa pasqyrës.
4. Ekzistimi i ndonjë perdeje apo pengese në mes të pasqyrës dhe objektit.
5. Mosdija se në cilën anë është objekti i kërkuar. Natyrisht që tolerohet ai i cili nuk e di anën, prandaj edhe nuk kthehet në atë anë.

Edhe zemra është një pasqyrë e aftë për të reflektuar në vete hakikatin e çdo gjëje. Por për shkak të pesë arsyeve të dhëna në vazhdim, këto hakikate nuk pasqyrohen në zemër:

1. Mangësi në vetë zemër, si zemra e fëmijës. Meqë ajo është e mangët, njohuria nuk mund t'i pasqyrohet aty.

2. Ndotja me njolla e zembrës nga gjynahet e bëra dhe errësimi i zembrës nga ndjenjat e epshit pengojnë shfaqjen e hakut. Për këtë na tregon Resulallahu s.a.v.s.:

“Për çdo gjynah, në zemër bëhet një njollë që gjurmët nuk i humbin.”

Sepse për të fshirë njollën e gjynahut, duhet bërë menjëherë një vepër të mirë. Në qoftë se bëhet mirësi pa u bërë asnjë gjynah, zemra lustron më shumë dhe shkëlqen. Nëse është bërë gjynah më herët, mirësia e humb vlerën, sepse vetëm e fshin atë njollë të gjynahut. Zemra kthehet në gjendje të mëparshme, por nuk i shtohet ndriçimi. Kështu që, duke ngritur zembrën me gjynah në një anë, dhe duke bërë mirësi (sevap) menjëherë pas asaj në anën tjetër, me çka pastrohet ajo njollë, është haptas një dëm dhe padyshim që është mangësi. Padyshim pasqyra që lustron për të pastruar njollën pas ndotjes nuk është e njëjtë si pasqyra që shkëlqehet dhe ndriçon pa ndotje. Lustrimi i zembrës bëhet me largimin nga dëshirat e epshit dhe drejtim në zbatimin e urdhrave të Allahut Teala. Për këtë, Allahu Teala thotë:

“Ata që luftojnë për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t'i udhëzojmë drejt udhëve Tona.” 29-Ankebut: 69

Dhe Resulallahu s.a.v.s, thotë:

“Ai që punon me atë që di, Allahu Teala ia mëson atij edhe atë që nuk e di.”¹⁷

¹⁷ Ebu Nuajm në veprën *‘Hilje’*.

3. Largimi i zemrës nga drejtimi i hakikatit të kërkuar. Një zemër e mirë që i përshtatet urdhrave të fesë, sado që është e padjallëzuar dhe e pastër, pasi që nuk kërkon dhe nuk e drejton pasqyrën e vet (zemrën) në drejtimin e duhur, aty nuk shfaqet ndriçimi i hakut. Ndoshta, në përgjithësi është e preokupuar me hollësitë e ibadeteve trupore ose mundohet me sigurimin e jetesës, nuk e përdor potencialin për të menduar Krijuesin dhe hakikatet e fshehta hyjnore. Por, në zemër i shkëlqejnë dhe i zbulohen (*keshf*) vetëm ato që është duke i menduar - mangësitë e hollësive të ibadeteve. Nëse është i preokupuar me mendim rreth turpit dhe mangësitë e nefsit, ajo i zbulohet. Nëse mendon rreth sigurimit të jetës, në zemër ajo i ndriçon. Nëse preokupimi i zemrës me hollësitë e ibadeteve e pengon shkëlqimin e hakut në zemër, e si mos ta pengojë zbulimin e hakikatit në zemër okupimi i saj me kënaqësitë dhe dëshirat e pshore të kësaj bote?

4. Ekzistimi i perdes në mes. Një zemër që nuk i përshtatet dëshirave të epshit dhe mendon hakikatet, mund të mos i zbulohen hakikatet e gjërave për shkak se aty ekziston perdja. E kjo është nën ndikimin e mësimit nga fëmijëria se njohja e hakikateve nuk është e mundur. Kjo është një perde e rëndë. Kjo është si mësuesit e kelamit që shartojnë mendimet e medh'hebit me rrugë të imitimit. Kelamistët, e bile edhe shumica e salihëve janë nën këtë ndikim. Ky besim i tyre i ngrirë, bëhet pengesë në zbulimin e të vërtetave (*hakikat*).

5. Mosdija se në cilin drejtim mund të përfitohet dituria e kërkuar. Për shembull ai që kërkon dituri nuk është e mundur ta kërkojë një dituri që nuk ekziston (të panjohur), por kjo është e mundur duke menduar dituritë përshtatshëm asaj që kërkon. Nëse i mendon këto dituri dhe i radhitë ato në

vete me një radhitje të veçantë siç kanë përcaktuar dijetarët, drejtohesh kah ana e kërkuar dhe në këtë mënyrë hakikati i kërkuar shfaqet në zemër. Sepse dituria e kërkuar e cila nuk është e lindur (*fitri*) mund të përfitohet vetëm me kërkimin e saj nga dituritë ekzistuese. Madje, çdo dituri përfitohet nga dy dituri të mëparshme. Këto dy dituri të mëparshme bashkohen dhe, me një mënyrë të veçantë, duke u kuptuar - çiftëzohen. Nga çiftëzimi i tyre lind një dituri e tretë. Sikur me bashkimin e mashkullit me femrës që lind një person i tretë. Gjithashtu, personi që dëshiron të përfitojë një mëz, nuk është e mundur ta përfitojë atë me një gomar dhe një deve. Për këtë duhet patjetër bashkimi i një kali dhe një pele, dhe me bashkimin e tyre fitohet mëzi. Ngjashëm kësaj, çdo dituri ka dy të vërteta në dispozicion të vetvetes dhe në mes tyre ka një mënyrë të caktuar të bashkimit. Nga bashkimi i tyre përfitohet dituria e kërkuar.

Mosnjohja e këtyre dy të vërtetave dhe mënyrës së bashkimit të tyre, është pengesë për përfitimin e një diturie të re. Shembulli i kësaj është siç u shpjegua më lartë - mosdija se në cilin drejtim është dituria e kërkuar. Këtë mundemi ta shpjegojmë edhe me një shembull tjetër: Personi që dëshiron ta shoh zverkun në pasqyrë, nuk mund ta bëjë këtë nëse e ngritë pasqyrën në nivel të fytyrës. Nëse pasqyrën e vendos pas kokës, prapë nuk mund ta shoh, meqenëse kësaj here pasqyra është larg syrit. Por nevojitet edhe një pasqyrë, njëra përpara dhe tjetra mbrapa, e atëherë mund ta shoh zverkun. Natyrisht që në mes tyre duhet krijuar lidhja. Zverku paraqitet në pasqyrën e vendosur mbrapa dhe reflektohet në pasqyrën përpara, dhe tek atëherë personi mund ta shoh zverkun e vet. Edhe në përfitimin e diturive ekzistojnë rrugë të ndryshme.

Në këto rrugë ka më shumë tendenca dhe shtrembërime se sa që shpjeguam në shembullin me pasqyrë. Pak ka persona në sipërfaqen e tokës që mund të zbulojnë dhe të dallojnë rrugët e mashtrimeve në këto tendenca.

Këto janë pra shkaqet që pengojnë zemrën në njohjen e hakikatit të gjërave. Përndryshe çdo zemër, qysh në krijim është e gatshme për të njohur hakikatin e të gjitha gjërave. Sepse zemra është e nderuar, është nën urdhër hyjnor (*emr-i Rabbani*), dhe me këtë cilësi është e veçantë. Duke treguar këtë, Allahu Teala thotë:

“Ne u ofruam amanetin qiejve, tokës dhe maleve, e ata nuk deshën ta marrin përsipër atë dhe u frikësuan prej tij, ndërsa njeriu atë e mori mbi vete.” 33-Ahzab: 72

Këtu ka një shenjë të hapur që zemra është e ndarë nga qiejt, toka dhe malet, dhe është një posedues i veçantë. Me këtë veçanti, i mjafton fuqia për të mbajtur amanetin hyjnor. Ky amanet është marifeti dhe tevhidi. Zemra e çdo njeriu është e përshtatshme për ta bartë këtë amanet. Por, në bartjen e peshës dhe në arritjen e hakikateve e pengojnë shkaqet që shpjeguam më lartë.

Ndërsa Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Çdo fëmijë lind në fitratin e Islamit, ndërsa prindërit e tij e bëjnë jahudi apo të krishterë apo ia imponojnë zjarrputizmin.”¹⁸

“Sikur të mos qarkullonte shejtani në zemrën e njerëzve, njerëzit do të shihnin melekët e qiejve.”¹⁹

¹⁸ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a..

Edhe me një rast:

Është pyetur Resulallahu s.a.v.s.:

- *O Resuli i Allahut, kush është më i miri nga njerëzit?*

e Resulallahu s.a.v.s. u përgjigj:

- **Çdokush, zemra e të cilit është mahmum.**

- *Çka do të thotë mahmum?,*

e pyetën, e Resulallahu u përgjigj:

- **Zemra e të devotshmit, që është e pastër nga urrejtja, dredhia dhe zilia.**²⁰

Për këtë shkak Omeri r.a ka thënë:

“Zemra ime e pa Rabbin tim, sepse devotshmëria ngriti perden mes Rabbit tim dhe zemrës time.”

Atij që i ngrihet perdja mes Rabbit të tij dhe zemrës së tij, i pasqyrohet pamja e botës shpirtërore (*mulku melekut*) në zemër. E sheh një pjesë të Xhennetit që është më e gjerë se bota dhe qiejt, ndërsa tërë Xhenneti është shumë më i gjerë. Sepse bota dhe qiejt janë ekzistenca të dukshme. Këto, sado që janë të gjëra, në fund mbarojnë dhe përfundojnë. Ndërsa bota e melekut është sekret i fshehur nga syri. Atë mund ta sheh vetëm ai që sheh me syrin e zemrës. Ajo botë nuk ka fund. Në realitet pjesa që përhapet në zemër është e kufizuar por në të vërtetë dhe në dituri hyjnore, bota e melekutit është e pafund. Botëve në tërësi, të dukshmes dhe të padukshmes, u thuhet *“Hazret-i Rububijet”*, për arsye se *“Hazret-i Rububijet”* e rrethon tërë ekzistencën. Sepse në esencë ekziston vetëm Dhati i Allahut dhe e’ali (veprat) e Tij.

¹⁹ Hadithi është cituar më herët.

²⁰ Ibn Maxh transmeton nga Abdullah b. Omeri.

Mbretëria e Tij dhe njerëzit janë veprat e Tij. Andaj, çka shfaqet nga këto në zemër, sipas disave, është vetë Xhenneti.

Ndërsa sipas dijetarëve të vërtetë, kjo është shkak për të hyrë në Xhennet. Gjerësinë që do të ketë besimtari në Xhennet është në lidhje me gjerësinë e të njohurit të tij (marifetit të tij) dhe masës së shfaqur të Dhatit të Allahut, cilësive dhe e'alit (veprave) të Tij në zemër. Ndërsa përshtatja urdhrave dhe veprat me gjymtyrë janë për pastrim dhe shkëlqim i zemrës. Prandaj është thënë: **“Ai që pastron *nefsin* (veten) ka arritur në shpëtim”**, dhe qëllimi i këtij pastrimi është që drita (nur) e imanit të hyjë në zemër dhe që drita (nur) e njohurisë të shkëlqejë aty. Këto kuptime i kanë ajetet:

“Allahu ia hap zemrën për (të pranuar) Islamit atij që dëshiron ta udhëzojë.” 6-En'am: 125

“A është njëlloj si ai që Allahu ia ka hapur kraharorin për të pranuar Islamit, duke qenë kështu në dritën (nurin) e Rabb-it të vet” 39-Zumer: 22

Po, kjo shfaqje (texheli) dhe ky iman (besim) kanë tri gradë:

1. Imani i njerëzve të rëndomtë (*avam*). Ky iman përbëhet nga imitimi/trashëgimi.

2. Imani i kelmistëve. Edhe ky është iman i përzier me një lloj dëshmie. Ky iman, edhe pse është më i fortë se imani i njerëzve të rëndomtë, prapë është afër tij.

3. Imani i arifëve²¹. Ky është imani që shikon (soditë) me nurin e bindur.

Këto tri gradë do t'i shpjegojmë me një shembull - Imani është sikur të besuarit se personi i caktuar gjendet brenda në shtëpi:

1. Është sikur t'i zihet besë personit të besueshëm, i cili nuk është gënjeshtar dhe i cili të lajmëron ty se 'filan personi është në shtëpi'. Lajmit të tij i beson dhe bindesh vetëm me dëgjim. Ky besim i yti është si imani i rëndomtë, është iman i imituar. Njerëzit e rëndomtë, kur arrijnë në moshën e pjekurisë mësojnë nga prindërit për ekzistimin e Allahut, për cilësitë e Tij, si Ai di çdo gjë, si çdo gjë bëhet me dëshirën e Tij, si është i Plotfuqishëm dhe për cilësitë tjera të Tij. Gjithashtu, kanë dëgjuar për Pejgamberët dhe veprat e tyre dhe të gjitha këto i pranojnë ashtu si i kanë dëgjuar. Në këtë iman janë të qëndrueshëm dhe me këtë besim gjejnë qetësi, nuk mendojnë ndryshe nga ajo që kanë mësuar, sepse ata plotësisht iu kanë besuar prindërve dhe mësuesve. Ky iman është shkak për shpëtimin e tyre në ahiret. Poseduesit e këtij imani do të jenë nga të parët në mesin e të lumturve (*As'hab-i Jemin*²²). Këta nuk janë nga të afërmit (*mukarrebun*), sepse te këta nuk ka zbulim (*keshf*), dhe zgjerimi i gjoksit që paraqitet nga drita (nuri) i bindjes. Kjo për arsye se ka mundësi të ketë gabime në besimin e dëgjuar nga individët dhe nga më shumë persona. Pra, edhe Jahuditë dhe të Krishterët i kanë zemrat e

²¹**Arif** [rrjedh prej fjalës irfan]: ai që di; ai që njeh; i ditur; ai që njeh Hakun; ai që me Hak e njeh Hakun.

²²**“As'hab-i Jemin”**: është grupi i parë, në ahiret këta do të marrin librin e veprave [amelit] në anën e djathtë dhe si përfundim do të hyjnë në Xhennet.

qeta me ato që kanë dëgjuar nga prindërit, por megjithatë besimi i tyre është gabim, sepse rruga u është treguar gabim. Myslimanët e rëndomtë i besuan Hakut dhe u bindën, por jo pse arritën këtë të vërtetë, por për shkak se atyre u është treguar e vërteta.

2. Është sikur dëgjimi prapa murit i zërit dhe fjalëve të personit që gjendet brenda. Besimi i bazuar në dëgjimin e zërit dhe fjalëve të personit që gjendet brenda shtëpisë sigurisht që është më i fortë se sa besimi bazuar në atë që ndokush ty të lajmëron se në atë shtëpi gjendet personi. Sigurisht që ti beson më shumë kur e dëgjon zërin e Ahmedit jashtë murit, se sa kur të thuhet se Ahmedi është në shtëpi. Sepse ai që është duke e menduar fytyrën e personit, kur e dëgjon zërin e tij, ai zë është dëshmi për fytyrën, prandaj edhe gjykon se ky është zëri i tij. Ky besim është i përzier me dëshmi. Megjithatë, edhe kjo mund të përzihet me gabime. Kjo sepse zëri i ngjanë zërit. Sado që të jetë e mundur që me një dëgjim të kujdesshëm të dallohet zëri nga zëri, nëse në atë moment dëgjuesi nuk analizon mirë dhe nuk bën ndarjen e duhur, gabimi është i mundur.

3. Grada e tretë është kur hyn brenda dhe aty e sheh Ahmedin. Nuk ka dyshim se ky është besimi (imani) më i fortë. Kjo është vërtetë njohuri (marifet) dhe soditje shpirtërore (mushahede); që dëshmon bindjen. Ky është imani i të afërmëve (mukarrebun) dhe të singertëve (siddik), sepse ata besojnë duke soditur. Edhe imani i të rëndomtëve dhe ai i kelamxhinjëve përfshihen në këtë iman. Por ky iman dallon nga imani i tyre sepse nuk ka gjasë për gabim. Megjithëkëtë, ka dallim edhe në gradat e njohurisë.

Dallimi për nga njohuria është si dallimi në mes të personit i cili në kohë të drekës e sheh Ahmedin në mesin e dhomës, dhe tjetrit, i cili e sheh Ahmedin nga largësia, në një qosh të errët. Padyshim që këta nuk janë të njëjtë në njohuri. Sepse, i dyti ka parë vetëm një formë por nuk ka mundur të shoh detaje në formën e tij. Kështu është edhe vërtetësia në njohje të urdhrave hyjnorë.

E dallim ka edhe sa i përket sasisë së diturisë.

Për shembull, dikush e sheh Ahmedin në mesin e shtëpisë, dhe afër tij e sheh Muhammedin, Alinë dhe Veliun. Ndërsa tjetri e sheh vetëm Ahmedin. Shtimi i sasisë së diturisë varet nga njohuritë e fituara.

Kjo është gjendja e zemrës në lidhje me dituritë. Të vërtetën e di vetëm Allahu Teala.

GJENDJA E ZEMRËS NË LIDHJE ME DITURITË RACIONALE DHE ATO TË SHERIATIT, SI DHE DITURITË E KËSAJ BOTE DHE BOTËS TJETËR

Dije se, siç e shpjeguam më lartë, zemra nga krijimi është e përgatitur të pranojë hakikatin. Megjithëkëtë, dituritë që arrijnë në zemër ndahen në dy:

1. dituritë racionale, dhe
2. dituritë e shariatit.

Dituritë racionale janë dituri që dihen me natyrën e mendjes e jo me imitim dhe të dëgjuar. Edhe dituritë racionale ndahen në dy:

- a. Dituritë e lindura (fitri; dituritë natyrore), dhe
- b. Dituritë e fituara

a) Dituritë e lindura janë dituri për të cilat nuk dihet nga dhe si arrijnë, siç janë dituritë që dy është më i madh se një, që një njeri nuk mund të gjendet në dy vende në të njëjtin moment, që diçka e krijuar nuk mund të bëhet e përjetshme, që diçka në të njëjtën kohë ekziston dhe nuk ekziston. Këto dituri ekzistojnë në vet krijimin e njeriut. Secili e posedon këtë dituri, por nuk e di se prej nga kjo dituri. Përndryshe, e di sigurt që kjo dituri vjen nga Allahu Teala.

b) Dituritë e fituara janë dituritë që fitohen me mësim dhe me dëshmi/argument.

Të dyjave mund të ju thuhet '*dituri racionale*'. Të parës i thuhet dituri mendore-racionale, fitri, dituri e domosdoshme dhe dituri e qartë. Të dytës i thuhet; dituri e fituar me mend, me mësim, me dëshmi, me dëgjim dhe me vështrim. Për këtë arsye Alia r.a. thotë:

“ E pashë mendjen dy llojesh; njëra e lindur (fitri) dhe tjetra e fituar. Pa ekzistuar mendja e lindur, mendja e fituar nuk siguron dobi, siç nuk kanë dobi nga dielli ata që kanë syrin e verbër.”

Resulallahu s.a.v.s thotë:

“Allahu Teala nuk ka krijuar asgjë më të vlefshme se mendja.” Në këtë hadith të Resulallahut s.a.v.s, qëllim është e para – d.m.th. mendja e lindur (fitri).

Kurse në hadithin ku Resulallahu s.a.v.s., i drejtohet Alisë r.a.:

“Siç i afrohen njerëzit Allahut Teala me mirësitë shumëllojshme, edhe ti afrohu me mendje” qëllimi është mendja e dytë, d.m.th. mendja e fituar.

Afrimi Allahut Teala nuk është i mundur me diturinë e lindur (fitri). Afrimi Allahut bëhet me dituri të fituar, por, vetëm për ata të cilët, njëjtë si Alia r.a., e përdorin mendjen për të përfituar dituritë e duhura, për t’iu afruar Rabbit të gjithësisë - Allahut Teala. Zemra është si syri. Natyra e mendjes në zemër është si fuqia e të pamurit në sy. Ndjenja e shikimit është latif (jo-materie) dhe atë nuk e posedon i verbri, kurse ekziston te ai që sheh, edhe kur të mbyllë sytë, edhe në terr. Mendja në kohën e fëmijërisë nuk është e aftë të njohë sendet, deri sa arrin kohën e pjekurisë, ashtu siç nuk është njeriu në gjendje të shohë deri sa të duket drita. Moszhvillimi i aftësisë së zemrës së fëmijës para pjekurisë është shkak pse nuk shfaqen dituritë aty.

Pena (*Kalem*), është një krijesë e Allahut. Allahu Teala atë e ka bërë një mjet për të shkruar dituritë në zemrën e njeriut. Në ajet thuhet:

**“i Cili, me anë të penës ia mësoi,
ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte.”** 96-Alak: 4, 5

Siç nuk u përngajnë cilësitë e Allahut cilësive njerëzore, edhe pena e Tij nuk i përngjanë penës së njerëzve. Siç nuk është Ai materie, as pena e Tij nuk është e tillë. Sado që të jetë e drejtë që nga ky pikëvështrim të ketë përshtashmëri mes syrit të zemrës dhe syrit në ballë, nga pikëpamja e nderit dhe vlerës së lartë (*fazilet*) - mes tyre nuk ka ndonjë përshtatje. Syrit të zemrës që kupton i themi *basiret*²³, e pikërisht ky basiret është shpirtëror (latif). Basireti është kalorës, e trupi si kali. Verbëria e të parit është shumë më e rrezikshme se verbëria e të dytit.

Meqenëse ekziston lidhja mes syrit të zemrës dhe syrit në kokë, Allahu Teala e bashkërenditi shikimin e brendshëm me shikimin e jashtëm. Allahu Teala tha:

“Zemra nuk e mohoi atë që e pa.” 53-Nexhm: 11
kuptimit të zemrës ia dha emrin *ru’jet* (pamje/shikim). Përsëri ngjashëm kësaj:

“...Ibrahimit ia mundësuam t’i shohë madhësitë e qiejve e të tokës...” 6-En’amë: 75.

Me këtë shikim (*ru’jet*), nuk mendohet në shikimin e jashtëm (*ru’jet zahir*), dhe ky shikim nuk është ekskluzivisht vetëm për Ibrahimin a.s.. Mirësia e Allahut është për të gjithë robërit e Tij.

Ashtu siç i është thënë *shikim* (*ru’jet*) kuptimit të zemrës, edhe të kundërtës së saj i është dhënë emri *verbëri*, pra *verbëria* është e kundërta e të kuptuarit:

²³ **Basiret**: syri i zemrës; të hetohet dhe kuptohet hakikati me zemër; të dihet hakikati i një sendi me zemër; fuqia e shenjtë (fuqia e Evliasë).

“Në të vërtetë sytë nuk verbërohen, por verbërohen zemrat në kraharor.” 22-Haxh: 46

“Ai, që në këtë botë ka qenë i verbër, do të jetë i verbër edhe në botën tjetër dhe më i humbur nga rruga e drejtë.” 17-Isra: 72

Këto janë dituri racionale.

Sa i përket diturisë së fesë: edhe këto janë dituri që merren me trashëgim dhe me imitim nga Pejgamberët. Duke dëgjuar dhe mësuar, si librin e Allahut, ashtu edhe sunnetin e Resulallahut s.a.v.s., bëhet e mundur që ato të kuptohen. Kjo dituri mundëson përkryerjen e cilësive të zemrës. Me ndihmën e kësaj diturie, zemra shpëton nga sëmundjet shpirtërore. Sado që njeriu ka nevojë për dituritë racionale ato nuk mjaftojnë që zemra të arrijë lumturinë, sikur që mendja nuk mjafton për mirëmbajtjen e shëndetit trupor. Veçoritë e ilaçit mësohen nga mjekët. Vetë mendja nuk mund t’i dijë ato veçori. Por përsëri, pas dëgjimit për to, mendja i kupton. Nuk është i mjaftueshëm dëgjimi pa mendjen, ose e kundërta. Është padituri (*xhahilijet*) të mjaftohemi vetëm me imitim, pa e përdorur mendjen. Dhe është mashtrim të mjaftohemi vetëm me mendje, duke braktisur kështu dritën (nurin) e Kur’an-it dhe sunnetin. Nuri i mendjes, Kur’anit dhe sunnetit duhet të jenë së bashku. Sepse dituritë racionale janë si ushqim, kurse dituritë e sheriatit janë si ilaçi. Nëse i sëmuri nuk merr ilaçin e duhur për shërim, ai dëmtohet nga ushqimi që merr. Edhe sëmundjet e zemrës shërohen në të njëjtën mënyrë, me shfrytëzimin e ilaçit të duhur të sheriatit. E ky ilaç janë veprimet dhe ibadetet që praktikuan pejgamberët, me qëllim që zemra të jetë në rrugë të drejtë.

Personi që nuk shëron zemrën me ibadete të shariatit, duke u drejtuar kah dituritë racionale është si personi që han ushqim të caktuar ende pa u shëruar, dhe dëmtohet edhe më shumë. Ata që mendojnë se dituritë racionale dhe ato të shariatit e përjashtojnë njëra-tjetrën, dhe se këto të dyja nuk mund të mbliidhen në një vend, janë të verbër për ta njohur të vërtetën (hakikatin). Bile, ka prej tyre që deklarojnë se ka kundërshti edhe mes urdhrave të shariatit! Këta, duke supozuar se në fe ka kundërshtim – hutohen, dhe ndahen prej imanit, sikur qimja prej vajit. I tilli mendon që në fe ka kundërshti, nga paaftësia e vet,. Ai i përngjanë të verbrit, i cili duke hyrë në shtëpinë e tjetrit, pengohet me karrige dhe tavolina, dhe i thotë të zotit të shtëpisë: *“Po pse nuk i keni vendosur këto mobile në vende të veta?!”*. Nuk është në dijeni, nga verbëria e vet, që mobilet janë në vend. Përgjigja që mund t’i jepet këtij personi është: *“Turpërohu, nuk po e mendon verbërinë tënde, e po kërkon të meta te tjetri.”*

Kjo ishte lidhja e Diturisë së Shariatit me Dituritë Racionale.

Kurse Dituritë e fituara, ndahen në dy:

1. Dituritë e Dynjasë (kësaj bote), dhe
 2. Dituritë e Ahiretit (botës tjetër).
-
1. Dituritë e kësaj bote janë: mjekësia, matematika, inxhinieria, astronomia, zanatet (mjeshtëritë) dhe dituritë tjera teknike.

2. Dituritë e ahiretit janë: dituritë për gjendjet e zemrës, për mangësitë e ameleve (veprimeve) dhe dituritë se si të njihet Dhati dhe cilësitë e Allahut.

Siç e shpjeguem në librin e diturisë, këto dy dituri janë në opozitë me njëra-tjetrën, pra, thellimi në njërën nënkupton lënie pas dore të tjetrës. Siç thotë Hazreti Alia r.a.:

“Ato janë si peshorja me dy tasa, si lindja dhe perëndimi dhe si dy gra të një burri; nëse njëri i afroresh, tjetra largohet.”

Prandaj, njerëzit që janë autoritet në mjekësi, matematikë, inxhinieri, filozofi... janë të paditur në dituritë e ahiretit. Gjithashtu, dijetarët e shquar të ahiretit janë të paditur në dituritë e kësaj bote. Sepse forca e mendjes zakonisht nuk është e mjaftueshme për të mbledhur të dyja në një vend; njëra bëhet pengesë për përsosmërinë e tjetrës.

Për këtë arsye Resulallahu s.a.v.s thotë:

“Shumica e banorëve të Xhenetit janë të paditur në punët e dynjasë.”²⁴

Hasani Basriu, në një fjalim thotë:

“Ne takuam njerëz të tillë që, po t’i takonit ju, do të thoshit që ata janë të çmendur. E sikur ata t’ju takonin juve, do të thoshin se ju jeni shejtanë!”

Do të vëresh se ata të cilët janë ekspertë në dituritë tjera, kur dëgjojnë një çështje të çuditshme nga urdhrat e fesë, tentojnë ta mohojnë atë duke thënë *“këtu ka*

²⁴ Transmeton Bezzar nga Enesi.

kundërshti". Mos u mashtro nga mohimi i tyre. Ai që vrapon kah lindja, sigurisht që nuk e di se çka gjendet në perëndim.

Kështu është edhe me punët e dynjasë dhe ahiretit. Për ta, Allahu Teala thotë:

"Ata dinë vetëm anën e dukshme të kësaj jete, ndërsa për jetën tjetër janë të pakujdesshëm." 30-Rum: 7

"Andaj, ti largohu prej atij që i ka kthyer shpinën Kur'anit dhe që nuk do tjetër vetëm jetën e dynjasë!

Ajo është e tërë dituria që kanë arritur ata."

53–Nexhm: 29, 30

"Sigurisht, ata që nuk shpresojnë se do të takohen me Ne, që janë të kënaqur me jetën e kësaj bote, duke gjetur prehjen në të dhe që janë të pavëmendshëm ndaj shenjave Tona."10-Junus: 7

Posedimi i të dy diturive, të dynjasë dhe të ahiretit, nuk i jepet çdokujt. Kjo i jepet vetëm Pejgamberëve, të cilët i mësojnë njerëzit, edhe në punët e dynjasë edhe në ato të ahiretit. Pejgamberët janë përforcuar me Xhebrailin nga Forca Hyjnore, që nga kjo forcë ndihmohet çdo krijesë. Sa u përket njerëzve të tjerë, nëse zemrat e tyre merren me punët e dynjasë, duke lënë pas dore ahiretin, ata nuk mund të arrijnë në përkryerje.

DALLIMI NË MES TË FRYMËZIMIT DHE PËRFITIMIT TË DITURISË ME MËSIM

Ta dish se ka mënyra të ndryshme të shfaqjes në zemër të disa diturive, e që shfaqja e tyre nuk është e domosdoshme. Nganjëherë, ajo dituri lind në zemër, duke mos u ditur prej nga mbërriti aty. E nganjëherë shfaqet në zemër me rrugë dëshmie dhe mësimi.

Shfaqjes së diturisë pa dëshmi dhe mësim i thuhet '*ilham*' (frymëzim). Edhe diturisë së përfituar me dëshmi i thuhet '*itibar*' (e vërtetë logjike/konsideratë analogjike) dhe '*istibsar*' (mendjemprehtësi).

Dituria që lind në zemër pa mësim e mundim ndahet në:

a) Dituria për të cilën nuk dihet se nga vjen. Kësaj i thuhet '*ilham*' (frymëzim) i zemrës. Kjo është dituria e evliave dhe bamirësve.

b) Dituria për të cilën personi e di shkakun; në këtë rast është e mundur edhe të shihet meleku që vendos diturinë në zemër. Kësaj diturie i thuhet '*vahj*' (shpallje) dhe ajo është dituri e posaçme për pejgamberët.

Dituria që përfitohet me anë të dëshmisë dhe mësim, i takon shkencëtarëve.

Mënyra e saktë për t'u shpjeguar kjo çështje, është: Zemra është e aftë në vetvete për pasqyrimin (*texheli*²⁵) të hakikatit të të gjitha gjërave. Por, siç shpjeguar më lartë, njëri nga pesë shkaqet pengon pasqyrimin e këtyre hakikateve. Ai shkak bëhet një perde në mes të pasqyrës së zemrës dhe *Levh-i Mahfudh*-it. Në *Levh-i Mahfudh* është i shkruar përcaktimi hyjnor i të gjitha ndodhive, deri në ditën e kiametit. Pasqyrimi i hakikateve nga pasqyra e *Levh-i Mahfudh*-it në pasqyrën e zemrës është si pasqyrimi i formës prej një pasqyre në tjetrën e cila është përballë. Perdja mes dy pasqyrave mund të ngrihet me dorë, e nganjëherë atë e ngrëhë edhe era. Njëjtë, nganjëherë fryjnë erërat e mirësisë hyjnore, dhe ngritin perden nga syri i zemrës dhe aty pasqyrojnë shkrime nga *Levh-i Mahfudh*. Këto pasqyrime (*texheli*) nganjëherë bëhen në ëndërr, dhe ai që i ka parë, nëpërmjet të ëndrrave i di ato që do të ndodhin. Ngritja e plotë e perdes nga mesi është e mundshme vetëm me vdekje. Me mirësinë e fshehtë të Allahut Teala, perdja mund të ngrihet edhe duke qenë njeriu i zgjuar, dhe bëhet pasqyrimi. Prapa perdes, në zemër vendosen dituri të pazakonshme. Kjo vendosje nganjëherë bëhet shpejt - si era që frynë, e nganjëherë bëhet ngadalë, pikë-pikë, e rrallë herë bëhet në vazhdimësi.

²⁵**Texheli:** pasqyrim; shfaqje; reflektim; manifestim; njohje; kuptim; dalja në shesh e fuqisë hyjnore dhe pamja e saj; të njihet hakikati në zemrën e robit me anë të ndikimit të nurit të Hak-ut,; shfaqje në zemër e Emrave të Bukur dhe cilësive të Allahut Teala.

Nga pikëpamja e njohurive, nuk ka dallim mes diturisë që arrihet me frymëzim (ilham) dhe asaj që përfitohet me mësim. Dallimi ekziston vetëm në ngritjen e perdes, e që nuk është në vullnetin e robit. Ngjashëm kësaj, as shpallja (vahj) nuk është diçka e ndarë nga ilhami. Ndarja është vetëm në shikimin e melekut që sjell diturinë. Në vahj, dituria përfitohet me anë të melekut. Ndërsa Allahu Teala urdhëron:

“Nuk ka asnjë njeri që t’i ketë folur Allahu ndryshe, vetëm se me anën e vahjit (frymëzimit), ose pas ndonjë perdeje, ose t’i dërgojë të dërguar (melek), e ai t’i shpallë me lejen e Tij atë që do Ai.” 42-Shura: 51

Pasi të kesh kuptuar këtë, dije se: Sufitë anojnë më shumë kah dituritë e frymëzimit (ilhamit) se sa kah dituritë që përfitohen me mësim. Prandaj nuk dëshirojnë të lexojnë dhe studiojnë veprat e fesë dhe bisedat për dëshmi. Ata thonë: *“ndoshta është e mundur që dituria të mësohet përmes luftës me nefsin, largimit të cilësive të këqija, këputjes së interesimit për çdo gjë dhe drejtimit kah Allahu me tërë ekzistencën.”* Kur njeriu arrin këtë gradë, Allahu Teala mbikëqyrë zemrën e robit dhe garanton shkëlqimin e saj me nurin e diturisë. Kur Allahu Teala merr zemrën nën mbikëqyrje, Ai vendos në atë zemër rahmetin e Tij dhe aty fillon të shkëlqejë nuri (drita), gjoksi zgjerohet, zbulohen fshehtësitë e melekut; me mirësinë e rahmetit ngritet perdja nga syri i zemrës dhe në zemër fillojnë të shkëlqejnë hakikatet e fshehtësisë hyjnore. Prej robit pritët vetëm që të jetë gati; të pastrojë zemrën duke vrojtuar derën e rahmetit që do t’ia qel Allahu Teala dhe me dëshirë të sinqertë të përgatitet dhe të jetë i etur për këtë rahmet. Pejgamberëve dhe evliave u është zbuluar fshehtësia

hyjnore, në gjoksin e tyre ka rrjedhur nur, por kjo nuk është nga leximi dhe mësimi, kjo është për shkak se ata i kthyen shpinën dhe larguan interesimin nga kjo botë (dynja), dhe duke pastruar zemrën nga të gjitha preokupimet për punët e kësaj bote me të cilat ka qenë e zënë zemra më parë, dhe duke iu drejtuar me tërë ekzistencën e tyre Allahut. Ata thonë: *“Kush bëhet me Allahun edhe Allahu bëhet me të.”*

Sufitë besojnë që për të arritur në këtë gradë, së pari duhet që tërësisht të ndërpritet interesimi për këtë botë, të largohet zemra nga gjithçka: nga dashuria për shokun, pasurinë, fëmijën dhe familjen, atdheun, diturinë; duhet hequr dorë nga puna, pozita dhe funksioni. Bile, njeriu duhet të arrijë në atë gjendje të tillë që prezenca apo mos-prezenca e dikujt për të është e njëjtë. Pastaj, duke u kënaqur vetëm me farz dhe sunnet, duhet të qëndrojë i tërhequr në një qoshe të shtëpisë, duke iu lidhur plotësisht meditimit; as me tefsirin e Kur’anit nuk duhet të merret, bile as me Kur’an dhe hadithe. Duhet të përpiqet që të mos përkujtojë asgjë, pos Allahut. Kështu, në halvet (vetmi), me zemër të qetësuar, duhet të vazhdojë të thotë *“Allah, Allah...”* dhe të arrijë në gjendje të tillë që gjuhën nuk e lëvizë, dhe përsëri thotë *Allah, Allah...* Ai vazhdon me këtë gjendje deri sa dhikri kalon nga gjuha në zemër. Më pas, duhet pasur durim deri sa nga zemra humbet edhe fjala, shkronjat, dhe mbetet vetëm kuptimi.

Arritja deri në këtë gradë dhe vazhdimësia në të varet nga vullneti i robit. Por, ai nuk ka zgjedhje tjetër pos të pres hapjen e rahmetit të Allahut, ashtu siç Ai ua hap edhe Evliave dhe Enbiave (pejgamberëve). Nëse në këtë gjendje është besnik, me dëshirë të pastër dhe i qëndrueshëm në

sinqeritet; nëse nuk e tërheq epshi, nuk e kaplojnë dëshirat e kësaj bote, atij i shkëlqen në zemër drita e vërtetë (hak), dhe në momentet e para ajo dritë i vjen dhe i kalon – si vetëtimë. Më pas vjen përsëri, dhe kjo gjendje nganjëherë zgjatë e nganjëherë kalon shpejtë. Nganjëherë, kjo dritë vjen pak nga pak. Nganjëherë ngel në një formë. Në këtë çështje, gradat e velive (miqve të Allahut) janë të ndryshme, siç janë edhe pamjet dhe ahlaku i tyre. Esenca e kësaj rruge përbëhet nga pastrimi dhe lustrimi i zemrës, pastaj gjithçka është përgatitje dhe pritje, asgjë më shumë.

Ndërsa personat e teorisë dhe mësimit, ata nuk e mohojnë ekzistimin dhe mundësinë e kësaj rruge, edhe pse e dinë se kjo rrallë arrihet, siç ndodh me pejgamberët dhe evliatë. Por ata e shohin këtë rrugë si të vështirë. Ata besojnë që kjo rrugë jep rezultate tepër vonë. Ata thonë që mundësia është e vogël që të plotësohen të gjitha këto kushte, dhe që ndërprerja e interesimit (për jetën e kësaj bote) deri në arritjen e kësaj grade, mund të jetë e mundur për një moment, por jo në vazhdimësi. Sepse, ata besojnë që, edhe një vesvese mund ta trazojë zemrën. Ashtu siç thotë Resulallahu s.a.v.s.:

“Zemra e besimtarit rrotullohet më shumë se sa uji i vluar në tenxhere.”²⁶

si edhe:

“Zemra e besimtarit është mes dy gishtave të fuqisë së Rahmanit.”²⁷

²⁶ Ahmed dhe Hakimi nga Mikdad b. Esved.

²⁷ Muslim nga Abdullah b. Omeri.

Dijetarët e teorisë gjithashtu thonë: gjatë përpjekjes, nganjëherë mund të prishet natyra, të trazohet mendja dhe të sëmuret trupi. Gjithashtu, nëse në përfundimin e kësaj vetmie dhe pastrimi të moralit, nuk zbulohen hakikatet e diturisë, në zemër ngjiten mendime të këqija e zemra lidhet me to për një kohë të gjatë, dhe jeta i përfundon pa arritur shpëtimin.

Ka shumë sufi që kanë hyrë në këtë rrugë, por kanë ngecur nga njëzet vite në një imagjinatë. Nëse njëri nga ta do të ishte posedues i diturive para se të hyjë në këtë rrugë, atëherë ai do të kuptonte menjëherë që ajo gjendje është një imagjinatë dhe do ta shpëtonte veten me lehtësi. Prandaj, të merresh me dituri është më mirë, dhe më afër qëllimit.

Sufitë e tillë mendojnë që, sikur Resulallahu s.a.v.s që u bë dijetar dhe fakih pa mësuar, me vahj dhe ilham, edhe ata, duke vazhduar në vetmi, mund të arrijnë këtë gradë. Ata që mendojnë kështu, i kanë bërë vetes të padrejtë dhe e kanë harxhuar jetën kot. Kjo i përngjanë gjendjes së personit i cili braktis punën me shpresë se patjetër do të gjej një thesar. Edhe pse ekziston mundësia që të gjendet thesari, shanset që të ndodh kjo janë shumë të vogla. I tillë është edhe ky njeri – ai nuk guxon të ngelet prapa me mësim, me shpresë që e arrin ilhami. Por, pasi të mësojë dituritë të cilat i kanë mësuar dijetarët, me pas nuk ka dëm që të priten zbulimet e fshehtësive (keshf) që u janë zbuluar dijetarëve tjerë. Ata thonë se me përpjekje, kjo është e mundur të përfitohet.

NDRYSHIMI MES DY GRADAVE

Shpjegim me shembuj

Dije se është jashtë kompetencës së ndjenjave të kuptojnë zemrën dhe gjendjet e mahnitshme të saj. Çka nuk mund të kuptohet me ndjenja, mund të shpjegohet vetëm përmes shembujve. Prandaj, të provojmë të kuptojmë këtë me dy shembuj:

Shembulli i parë. Të marrim një pishinë. Uji i kësaj pishine ka mundësi që vjen nga dy rrugë: përmes lumit nga lartë, ose përmes pusit që është gërmuar dhe pastruar, nën pishinë. Përmes rrugës së dytë ka ujë vazhdimisht, dhe me cilësi të mirë. Zemra është si kjo pishinë, e dituria si uji. Kurse pesë ndjenjat janë si lumenjtë që sjellin ujin. Ashtu siç është e mundur që dituria të përcillet në zemër përmes këtyre ndjenjave, njëjtë është e mundur që ajo të përcillet edhe përmes soditjes shpirtërore (*mushahede*). Ashtu siç e mbush pishinën uji që vjen nga rrethina, ashtu edhe zemra mbushet me dituri. Gjithashtu mund të ndërpriten këta lumenjë në vetmi (uzlet) dhe me heqjen e syrit nga jashtë, duke u zhytur në thellësitë e zemrës për të pastruar atë dhe duke ngritur shtresat e perdeve, për t'u mbushur zemra me dituri nga burimi brenda vet zemrës.

Nëse pyet se si shpërthen dituria nga zemra e cila është e zbrastë: dije se kjo është një nga gjendjet e fshehta të zemrës. Kjo fshehtësi nuk diskutohet shumë në dituritë praktike. Këtu, vetëm kaq mund të tregojmë: hakikatet e gjërave janë të shkruara në *Levhi-mahfudh* dhe në zemrat e *melaikeve mukarreb* (të afërt).

Kjo është si puna e arkitektit, i cili fillimisht bën planin dhe më pas, bazuar në atë plan edhe ndërton. Edhe Allahu Teala, Krijuesi i gjithësisë, së pari bëri projektin e gjithësisë prej fillimit e deri në fund, dhe e shkroi atë në Levhi-mahfudh. Pastaj, atë shkrim e bëri të ekzistojë në një mënyrë të qëndrueshme, dhe kjo ekzistencë e gjithësisë ka një pamje në ndenja dhe në imagjinatë (hajal).²⁸ Personi që shikon tokën dhe qiejt, kur i mbyllë sytë, pamja që ngel në hajal e bën të mendojë sikur po i shikon ende ato. Edhe po të humbasin toka dhe qiejt, pamja e tyre ngel në kokën e tij. Pastaj, kjo pamje nga hajali kalon në zemër. Hakikati i asaj që hyn në ndjenjë dhe hajal, shfaqet në zemër. Hakikatet që shfaqen në zemër përshtaten në hajal, e hakikatet në hajal u përshtaten hakikateve të jashtme. Edhe gjithësia ekzistuese përputhet me projektin në Levhi-mahfudh. Sipas kësaj, gjithësia ka katër faza:

1. Ekzistenca në Levh-i Mahfudh, plani dhe projekti. Kjo është para-ekzistenca.
2. Ekzistenca e vërtetë.
3. Ekzistenca në hajal, dmth. pamja imagjinative.
4. Pamja që ka mbetur në mendje, dmth. në zemër.

Nga këto krijesa, disa janë shpirtërore, e disa materiale. Disa nga krijesat shpirtërore janë më të ndjeshme dhe më të fshehta se krijesat tjera shpirtërore. Kjo është mirësi nga urtësia hyjnore (hikmet). Sepse nëpërmjet syrit aq të vogël

²⁸ **Hajal:** diçka e projektuar me mendje; hakikati që nuk dihet me mendje e që projektohet; një gjë që shihet me hije; mendimi që kalon nga mendja dhe që nuk ka vërtetësi; imazh; imagjinatë; pasqyrim; hije; hije pas perdes.

hyn bota dhe qiejt, pastaj ato kalojnë në hajal, dhe nga hajali në zemër. Ti mund të dish vetëm atë që të arrin ty. Sikur në qenien tënde të mos krijoheshin shembuj dhe vend për tërë gjithësinë, ti nuk do të mund të njihje tjetrin pos vetes.

Allahu është i Plotfuqishmi Absolut që rregulloi këto gjendje të mahnitshme në sy dhe zemra, dhe po ashtu është Ai që i bën syrin dhe zemrat të verbra për kuptimin e këtyre hakikateve. Bile, zemrat e shumë njerëzve kanë ngelur të padijshme për veten dhe gjendjet e mahnitshme në vete! Por, le t'i kthehemi ne qëllimit tonë dhe të themi:

Ashtu siç shihet dielli – herë duke e shikuar atë direkt e herë duke u reflektuar dielli në ujë, edhe hakikati i gjithësisë dhe pamja e tij shfaqet në zemër herë nga ndjenjat e herë nga Levh-i Mahfudh. Kur hiqet perdja mes personit dhe Levh-i Mahfudhit, ai sheh aty gjëra, dhe prej aty i rrjedh dituria dhe atëherë ai nuk ka nevojë të marrë dituri nga shqisat. Kjo bëhet sikur uji që shpërthen nga dheu dhe mbush pishinën. Kur personi pason *hajal*-in (imagjinatën), e cila vjen nga shqisat, atëherë kjo i bëhet perde, e cila e pengon shikimin në Levh-i Mahfudh. Kjo gjendje është sikur uji që vije nga lumenjtë dhe mbush pishinën, e në atë kohë nuk ka nevojë për burim të ujit, ose si shembulli i atij që shikon reflektimin e diellit në ujë, e jo vet diellin.

Pra, zemra ka dy dyer: Njëra derë hapet në botën e melekut (*alemul melekut ose alemul gajb - bota e fshehur*) dhe Levh-i Mahfudh. Dera tjetër u hapet pesë shqisave, e kjo është në këtë botë (*alem-ul dynja ose bota e dukshme*). Kjo botë (bota e dukshme), me një anë i përngjajnë botës së

melekut (bota e fshehur). Secili e njeh hapjen e derës së zemrës përmes shqisave, dhe marrjen e diturisë përmes tyre. Ndërsa hapja e derës së zemrës në botën e melekut për të soditur Levh-i Mahfudh-in është sikur të soditet dhe të mendohen gjendjet e mahnitshme të ëndrrës së bindshme dhe të dihen ato që kanë ndodhur ose që do të ndodhin, pa pasur nevojë për shqisat. Kjo derë u hapet vetëm atyre që e mendojnë dhe e bëjnë dhikër (përmendin) Allahun Teala.

Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

- Kanë fituar garën vetëm ata që i bëjnë robëri Allahut.

As'habët pyetën:

- Kush janë ata o Resulallah? Resulallahu s.a.v.s. tha:

- Janë ata që bëjnë dhikër Allahun me dashuri. Ai dhikër do të heq barrën nga shpina e tyre, dhe pastaj do të vijë në ditën e kiametit të lehtë.

Tutje Resulallahu s.a.v.s. transmetoi fjalët e Allahut Teala:

“Pastaj me fytyrën Time do t’u drejtohem atyre. Atyre që u drejtohem me fytyrën Time, a mund ta mendojnë ata se çka do t’u dhurojë?” Pastaj Allahu Teala tha:

E para gjë që do t’u dhurojë është vendosja e dritës (nur) në zemrat e tyre. Nga atëherë, siç i lajmëroj Unë ata, edhe ata lajmërojnë prej Meje.”²⁹

Hyrja në zemër e këtyre lajmeve që shpjeguam është nga dera e dytë - dera e brendshme.

²⁹ Pjesën e parë të hadithit e transmeton Muslimi nga Ebu Hurejre r.a. Gjithashtu transmeton edhe Hakimi dhe thotë që sipas kushteve të Muslimit, hadithi është sahih.

Dallimi mes diturisë së nebive me evliatë, dhe dijetarëve me filozofët

Dituritë e Pejgamberëve dhe evliave vijnë nga brenda zemrës, nga dera që i hapet botës së melekut. Dituria e dijetarëve dhe filozofëve vjen nga dera e shqisave që i hapet kësaj bote. Është e pamundur që të tregohen në pjesën e diturisë praktike gjendjet e mahnitshme të lëkundjes së zemrës mes botës së melekut dhe kësaj bote (botës që nuk shihet dhe botës që shihet), me të gjitha hollësitë e saj. Mirëpo, dhamë shembullin e parë që mund të tregojë ndërhyrjen në mes të dy botëve.

Shembulli i dytë: Edhe shembulli i dytë të tregon ty dallimin në mes të veprimeve të evliasë dhe veprimeve të dijetarëve. Dijetarët punojnë për të përfituar dituri, dhe për t'i vendosur ato në zemër, ndërsa evliatë punojnë për të pastruar dhe shkëlqyer zemrat.

Tregohet se dy artistë, një kinez dhe një romak, po bënin gara para një mbreti. Romaku thoshte:

- *Arti im është më i miri*, e kinezi thoshte:

- *Arti im është edhe më e mirë*. Mbreti tha:

- *Tregoni mjeshtërinë tuaj përballë njëri-tjetrit në këtë dhomë, të shohim se cili është më i mirë*, dhe vendosi një perde mes tyre, që ata të mos shihnin njëri-tjetrin se çfarë janë duke bërë. Artisti romak filloi të ngjyrosë me lloj-lloj ngjyrash, kurse artisti kinez bëri vetëm lustrim, pa u ndalur. Më në fund, romaku tha:

- *Unë e përfundova*.

- *Edhe unë!*, tha kinezi. Mbreti i tha kinezit:

-Si është e mundur që ti përfundove, kur ky aq shumë punoi, aq shumë ngjyra harxhoi, kurse ti çfarë bëre? Kinezi tha:

-S'ka gjë, ngriheni perden dhe shikoni. Perdja u ngrit, dhe mbreti shikoi me habi artin e bukur të romakut, e kur u kthye kah ana e kinezit, ishte edhe më shumë i habitur; përmes lustrimit, arti i romakut reflektohej në anën e kinezit. Lustrimi kishte bërë detyrën e pasqyrës, dhe kinezi fitoi. Kështu edhe evliatë – zemrën e pastrojnë, lustrojnë dhe shkëlqejnë. Sikur arti i romakut që reflektohej në anën e kinezit, edhe hakikatet (të vërteta të qarta, me gjithë shkëlqimin e tyre) reflektojnë në zemër. Ndërsa dijetarët dhe filozofët janë si artisti romak – mësojnë dituritë për t'i qëndisur ato në zemër.

Në cilën do mënyrë të realizohet, zemra e besimtarit nuk vdes, me vdekjen nuk asgjësohet dituria e as nuk humbet shkëlqimi. Për këtë jep shenjë Hasan Basriu kur thotë:

“Dheu nuk e ha vendin e imanit, por ai vend (zemra), bëhet mjet i afrimit tek Allahu Teala.”

Personi nuk bëhet mospërfillës me përfitimin e diturive, me shkëlqimin e zemrës për pranimin e diturive dhe për mundimin në këtë çështje. Sepse lumturia e personit vjen me dituri dhe njohje. Për këtë arsye në lumturi nuk janë të gjithë të njëjtë. Sikur pasuria që është më shumë ose më pak varësisht kapitalit që posedohet, edhe gradat e lumturisë janë të ndryshme, varësisht nga besimi (iman) dhe njohuritë (marifet). Njohuritë janë dritë (nur). Besimtarët me këto njohuri të dritës i afrohen Allahut Teala. Prandaj Allahu Teala thotë:

“Drita e tyre shkëlqen para dhe në të djathtë të tyre.” 57-Hadid: 12

Në një hadith thuhet:

“Gjithsesi se disa njerëzve do t’u jepet dritë (nur) sa malet, e disave më pak se kaq, sa që në fund dikujt do t’i jepet dritë vetëm në gishtat e mëdhenj të këmbëve, e që kjo dritë do të shkëlqejë dhe do të ndalet, e kur shkëlqen, ai do të lëvizë, e kur ndalet drita, do të ndalet edhe ai. Ata do të kalojnë nëpër Urën e Siratit, përmes dritës së tyre, kështu që disa do të kalojnë me shpejtësi sa hap-e-mbyll sytë, disa me shpejtësi të vetëtimitës, disa me shpejtësi të reve, disa do të kalojnë me shpejtësi të rënies së yllit, të tjerë me shpejtësi të vrapit të kalit në vrullin e luftës, kurse ai të cilit i është dhënë dritë në gishtin e madh të këmbës, do të zvarritet me fytyrë, duar dhe këmbë, ai rrëshqet dhe me një dorë ngjitet, ndonjëherë ngjitet me një këmbë, e anash do ta zë zjarri, dhe kështu do të jetë deri sa të çlirohet.”³⁰

Nga kjo shihet shumë qartë se në besim (iman), njerëzit janë të ndryshëm (me grada). Tani u kuptua se imani i Ebu Bekrit r.a., nëse peshohet me imanin e të gjitha krijesave, përveç Resulëve dhe Nebive, do të ishte më i rëndë, dhe kjo është ngjashëm me thënien se nëse peshohet nuri i të gjitha yjeve me nurin e diellit, është nuri i diellit që do të ishte më i rëndë. Nuri i imanit të avamit (njerëzve të rëndomtë) është si drita e llambës dhe qiriut, që kur ndriçon shihet vetëm rrethi i vet. E kur dielli ndriçon, bota shihet me tërë gjerësinë e saj, shihet çdo vend. Njëjtë, zgjerimi i gjoksit me nurin e njohurisë (marifet) është i ndryshëm. Zemrat e arifëve e zënë gjerësinë e botës së melekut.

³⁰ Taberani dhe Hakim nga Ibn Mesud r.a., e Hakimi thotë se është sahih dhe i përmbush kushtet e Buhariut dhe Muslimit.

Për këtë Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Në Ditën e Gjykimit do të thuhet: ‘Nxirreni nga zjarri atë në zemrën e të cilit ka pasur iman qoftë edhe një thërrmijë edhe sa gjysma e thërrmijës, edhe sa një e katërta e saj, edhe sa një qime e hollë, edhe sa një grimcë’.”³¹

Të gjitha këto janë tregues për gradat e ndryshme të imanit, dhe kaq pak iman që ceket ne hadith nuk parandalon hyrjen në xhehenem, por pengon qëndrimin e përjetshëm atje. Gjithashtu, prej hadithit mund të kuptohet se ai që posedon më shumë se një thërrmijë iman, nuk do të hyjë në xhehenem, e nëse hyn, do të urdhërohet që të nxirret. Përsëri Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Një qenie që mund të jetë më i mirë se njëmijë qenie të njëjta, është besimtari.”³²

Resulallahu s.a.v.s., këtu preferon zemrën e arifit mbi zemrat e njëmijë njerëzve të rëndomtë. Allahu Teala thotë:

“Ju gjithsesi jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë të vërtetë.” 3-Al’imran: 139

Allahu Teala këtu preferon besimtarët, dhe synim nuk janë besimtarët imitues (*mukalid*), por besimtarët *arif-i bilah*. Përsëri Allahu Teala thotë:

“Allahu lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri.”

58-Muxhadile: 11

³¹ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Saidi.

³² Shënon Taberani nga Selmani, dhe Ahmedi nga Ibn Omeri, me zinxhir të mirë të transmetuesve.

Edhe këtu janë cekur ata që besuan, dhe synohen ata që besojnë pa dituri. Allahu Teala i ndau ata prej besimtarëve që posedojnë dituri. Në këtë ndarje, edhe pse besimi i tyre është pa dituri dhe është besim me imitim, prapë ata janë quajtur mu'min.

Duke komentuar ajetin:

“...të cilëve u është dhënë dituri”,

Ibn-i Abbasi r.a. thotë:

–“Allahu Teala e ngrit alimin (dijetarin) shtatëqind gradë mbi mu'minët. Largësia në mes të çdo grade është sa lagësia e tokës me qiellin.”

Kurse Resulallahu s.a.v.s. tha:

“Shumica e banorëve të Xhenetit do të jenë ata që nuk janë zgjuar (vështirë kuptojnë) dhe naiv kurse grada Illijun është për të zgjuarit.”³³

...dhe thotë:

“Epërsia e dijetarit mbi abidin është si epërsia ime mbi as'habin tim më të ulët.”³⁴

Me një transmetim tjetër: **“Si epërsia e hënës së plotë mbi yjet.”**

Nga këto dëshmi e kuptove që banorët e Xhenetit posedojnë gradë të ndryshme, varësisht njohurive (marifeteve) të tyre. Prandaj Dita e Kiametit është *“Tegabun”*

³³ Hadithi është përmendur më herët.

³⁴ Shënon Tirmidhiu nga Ebu Umame, duke konfirmuar besueshmërinë e tij.

(dita e mashtrimit), sepse ata që kanë mbetur të privuar nga rahmeti i Allahut Teala janë në humbje dhe mashtrim. Kur i privuari të shohë gradat e larta në xhenet, është sikur ai që posedon dhjetë dërhëmë e i sheh milionat – e shikon me mall. Edhe pse ai që posedon dhjetë dërhëmë llogaritet si i pasur, dallimi me atë që ka milionat është shumë i madh. Edhe për atë që humb atë që i takon, ose nuk e merr gradën e duhur – sa humbje e madhe që është kjo! Ngase ahireti është më i lartë dhe më i vlefshëm se çdo gjë.

DËSHMITË E SHERIATIT PËR RRUGËN E DREJTË TË SUFIVE NË PËRFITIMIN E NJOHURIVE

Dije se: atij që me rrugën e frymëzimit i vendoset në zemër diçka sado e vogël nga e panjohura, dhe që vështron me syrin e zemrës, ai e kupton dhe njeh të vërtetën e rrugës së drejtë. Ata që nuk kanë përjetuar diçka të tillë dhe që nuk e njohin veten, është e udhës të mos e mohojnë një gjë të tillë, ngase gradat e njohurive janë vërtetë të rralla dhe delikate. Transmetimet, përvojat dhe argumentet e sheriatit janë dëshmitarë të kësaj ekzistence. Allahu Teala thotë:

“Ata që luftojnë për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t’i udhëzojmë drejt udhëve Tona.”²⁹-Ankebut: 69

Pra, çdo urtësi që shfaqet në zemër pa e mësuar atë me anë të ibadetit të vazhdueshëm, shfaqet me rrugën e zbulimit (*keshf*) dhe frymëzim (*ilham*).

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Kush punon përshtatshëm asaj që di, Allahu do t’i dhurojë atij dituri për atë që nuk di dhe do t’i ndihmojë veprat e tij deri sa ai ta fitojë Xhenetin. E kush nuk punon përshtatshëm asaj që di, ai do të bredhë në këtë dituri dhe nuk do të fitojë ndihmën e Allahut në veprat e tij, dhe kështu do të meritojë zjarrin.”³⁵

Allahu Teala kështu thotë:

**“Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t’i gjejë rrugëdalje (nga çdo vështirësi)
dhe do t’i japë risk prej nga nuk e pret.”** 65-Talak: 1, 2

³⁵ Hadithi i përmendur edhe në *‘Librin e diturisë’*.

pra, e bën dijetar edhe pa mësuar, dhe e bën të zgjuar përkundër mungesës së përvojës.

Dhe thotë:

“O besimtarë! Nëse i frikësoheni Allahut, Ai do t’ju japë aftësinë e të gjykuarit drejt.” 8-Enfal: 29

Pra, jep një dritë (nur) dhe me anë të këtij nuri e ndan të vërtetën nga e pavërteta dhe shpëton prej dyshimeve. Për këtë arsye Resulallahu s.a.v.s., në duanë e tij kërkoi shumë nur nga Allahu Teala:

“Allahu im! Më dhuro nur dhe ma shto nurin. Dhuroi nur zemrës time, dhuroi nur varrit tim, dhuroi nur dëgjimit dhe shikimit tim, dhuroi nur flokut tim, lëkurës time, gjakut tim dhe eshtrave të mija!”³⁶

“A është njëlloj si ai që Allahu ia ka zgjeruar kraharonin për të pranuar Islamin, duke qenë kështu në dritën e Rabbit të vet.” 39-Zumer: 22

Resulallahu s.a.v.s., u pyet për fjalën **“Shereha”** në këtë ajet, dhe ai tha:

“Ajo është një gjerësi. Sepse kur nuri derdhet në zemër gjoksi zgjerohet dhe hapet për të.”

Resulallahu s.a.v.s, bëri dua për Ibn Abbasin:

Allahu im! Bëje atë fakih dhe mësoja te’vilin.³⁷

³⁶ Hadith muttefekun alejhi në transmetim të Ibn Abbasit.

³⁷ Imam Ahmedi, Ibn Hibban dhe Hakimi nga Ibn Abbasi.

Alia r.a. ka thënë:

“Nuk ka asgjë që Resulallahu s.a.v.s., ka fshehur nga ne, përveç të kuptuarit (fehimi) që Allahu Teala ia dhuron robit të Tij për të kuptuar Librin e Tij, e kjo nuk arrihet me mësim. Kjo është dhuratë e Allahut.”

“Ai ia dhuron urtësinë (hikmet) atij që do.”

2-Bekare: 269

Është thënë se shpjegimi i këtij ajeti është:

“Urtësia (hikmet) është të kuptuarit e Kur’anit.”

Allahu Teala thotë:

“Ne e bëmë Sulejmanin ta kuptonte drejtë çështjen.” 21-Enbija: 79

Asaj që iu zbulua Sulejmanit a.s. iu dha emri *‘fehmi’*.

Ebu Derda r.a. ka thënë:

“Besimtari, pas perdes së hollë shikon me nurin e Allahut. Vallahi kjo është vërtetë, Allahu Teala vendos nurin në zemrën e besimtarit, dhe e shndërron atë në fjalë në gjuhën e tyre”.

Njëri nga të vjetrit ka thënë:

“Hamendja e mu’minit është si kehanet (parashikim i qëlluar, zbulim)”.

Ndërsa Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Ruajeni prej firasetit të mu’minit, sepse ai shikon me nurin e Allahut Teala.”³⁸

Në këtë aludojnë ajetet në vijim:

³⁸ Tirmidhiu nga Ebu Seidi. Hadithi është cekur më herët.

“Në atë (ngjarje), vërtet ka argumente për ata që mendojnë.” 15-Hixhr: 75

“Ne ua kemi treguar qartë shenjat Tona atyre që besojnë bindshëm.” 2-Bekare: 118

Hasan Basriu transmeton që Resulallahu a.s., ka thënë:

“Dituritë janë dy lloje: njëra është dituria e brendshme - në zemër, e kjo është dituri e dobishme.”³⁹

Një alim (dijetar) u pyet se çka është dituria e brendshme, e ai tha:

“Dituria e brendshme është një fshehtësi e Allahut Teala. Cilit do prej miqve të tij që dëshiron Allahu, ia vendos atë në zemër. As meleku e as njeriu nuk e dinë diturinë e kësaj fshehtësie.”

Edhe Resulallahu s.a.v.s. thotë në një hadith:

“Vërtetë në ummetin tim ka të tillë të cilët pastaj dalin në shesh të mësuar, të dobishëm, të frymëzuar dhe të edukuar, dhe të cilët përgjigjen, dhe Omeri është vërtetë njëri nga ta.”⁴⁰

Ibn Abbas r.a. kur lexonte: *“Para teje ne nuk kemi dërguar asnjë të dërguar, as lajmëtar, e as nga ata të cilëve u kumtohet...”*, e lexonte edhe *‘vela muhdesin’* pra ka dëshiruar të thotë që muhdesin janë njerëzit e drejtë (sidik). *Muhdes* janë ata që janë të frymëzuar, e të frymëzuarit janë ata të cilëve diçka u zbulohet përbrenda, në thellësinë e zemrave të tyre, e jo me anë të shqisave të jashtme. Kur’ani Kerim qartas

³⁹ Është cekur në *‘Librin e diturisë’*.

⁴⁰ Buhariu nga Ebu Hurejre r.a.

thekson se devotshmëria (*takva*) është çelës i udhëzimit dhe zbulimit, e kjo është dituri që fitohet pa mësuar. Allahu Teala thotë:

“Vërtet, në ndërrimin e natës me ditën dhe në atë që ka krijuar Allahu në qiej dhe në Tokë, ka shenja për njerëzit që i frikësohen Allahut.” 10-Junus: 6

Shenjat në tokë dhe në qiej Allahu i ka caktuar në mënyrë që të devotshmit të kuptojnë. Përsëri, Allahu Teala thotë:

“Ky (Kur’ani) është sqarim për njerëzit, është udhëzim dhe këshillë për të devotshmit.” 3-Al’Imran: 138

Ebu Jezid Bestamiu dhe të tjerë arifë thonë:

“Nuk është alim ai që ka mësuar përmendësh prej librit, dhe kur i harron ato bëhet i paditur. Alim i vërtetë është ai që pa lexim dhe pa mësim përmendësh merr dituri prej Rabb-it të tij kur të dëshirojë” Si shenjë për këtë, Allahu Teala thotë:

“...dhe i kishim mësuar nga ana Jonë dije.”18-Kehf: 65

Edhe pse të gjitha dituritë vijnë prej Allahut, disa dituri mësohen edhe nëpërmjet njerëzve të tjerë. Por, këto dituri nuk quhen *‘ilm-i ledunni’*, sepse ilm-i ledunni është dituria i pavarur, larg nga ndikimi i jashtëm, vendosur në thellësi të zemrës.

Këto që treguam deri këtu janë disa nga dëshmitë Kur’anore, hadithet dhe tregimet e të mëdhenjve. Nëse do të rendisnim të gjitha dëshmitë Kur’anore, hadithet dhe tregimet tjera, do të bëhej një ngarkesë e madhe.

Gjithashtu janë aq të shumta sa që nuk mund të numërohen dëshmitë nga jeta e as'habëve, tabi'inëve dhe pasardhësve të tyre. Shembull:

Hazreti Ebu Bekri r.a., duke qenë në shtratin e vdekjes i tha së bijës, Aishes r.a.: *"Ata janë dy vëllezërit dhe dy motrat e tua."* Gruaja e Ebu Bekrit ishte shtatzënë dhe më pas lindi vajzë. Më këtë Ebu Bekri r.a. tregoi një keramet. Kurse në një hudbe të xhumasë Omeri r.a., duke iu drejtuar Sarijes të cilin e kishte dërguar tashmë si komandant të ushtrisë në Iran, i tha: *"Mbështetu malit, mbështetu malit."* Sarija ishte duke humbur luftën, dhe këtë e pa Omeri r.a. nga minberi në Medine, prandaj i tha Sarijes t'i mbështetet malit dhe kështu, duke luftuar vetëm në një drejtim arriti fitoren. Të parit e kësaj nga ana e Omerit r.a. dhe përcjellja e zërit të tij nga Medina në Iran, është prej kerameteve të tij.

Edhe Enes b. Maliku r.a., kështu tregon:

- *Një ditë, pashë në rrugë një grua. E shikova me bishtin e syrit dhe bukuria e saj më mahniti. Menjëherë pas kësaj u takova me Osmanin r.a.. Osmani më tha:*

- *Erdhe të më takosh me gjurmë të zinasë në sy! A nuk e di që zinaja e syrit është shikim? Ose bëj teube ose të dënoj (ta'zir⁴¹). I thashë:*

- *A thua ka vahj (shpallje) pas Resulallahut s.a.v.s.? Osmani tha:*

-*Jo, s'është vahj, por është shikim me syrin e zemrës (basiret), vërtetim dhe mendjezgjuarësi (feraset) e vërtetë'.*

⁴¹**Ta'zir:** kuptimet leksikore: refuzim; i detyruar; ardhje në rrugë të drejtë; edukim; të treguarit e kufirit.. Në drejtësinë Islame, është një term për dënimet që ka praktikuar *ulul-emri*, ose sulltani, ose përfaqësues i tyre kur për ndonjë faj/gabim nuk ka dënim të përcaktuar nga sheriat.

Edhe Ebu Said el-Hazzar tregon:

- Një ditë hyra në Mesxhid-i Haram. Aty pashë një njeri i cili kishte veshur dy xhaketa (pulloverë leshi). Thashë me vete:

-Këta njerëz janë ngarkesë për të tjerët. Menjëherë, ai person u kthye kah unë dhe tha:

-Allahu e di mendimin që kalon brenda jush. Frikësohuni prej Tij, dhe unë menjëherë hoqa dorë nga ai mendim. Në këtë, ai tha:

-Allahu është Ai që pranon teuben e robit, dhe u largua, e më nuk e pashë.

Zekerija b. Davudi tregon:

- I biri i Mesruk Ebu'l-Abbas i shkoi në vizitë Ebu'l-Fadl-it nga fisi Hashim. Ebu'l-Fadl ishte i sëmurë, me familje kallaballëk dhe pa kurrfarë të ardhurash. Kur Ebu'l Abbasi po largohej, mendoi se si ky njeri nuk kishte kurrfarë të ardhurash – ‘a thua, si jeton?’ Menjëherë Ebu'l Fadli tha:

-O Ebu'l Abbas, nxirri nga zemra këto mendime të këqija. Allahu Teala ka dhurata të fshehta, të cilat ia jep kujt të dojë’.

Edhe Ahmed Nakib kështu tregon:

- Një ditë shkova ta vizitoja Shibliun. Ai mu drejtua për një telashe, dhe unë e pyeta se për çka ishte fjala. Shibliu më tha:

- Këtë mëngjes duke medituuar më erdhi nga brenda një zë: ‘Ti je njeriu më dorështrënguar’, por pastaj e refuzova këtë mendim: ‘Nuk jam dorështrënguar!’ Përsëri më erdhi nga brenda një zë: ‘Po, ti je dorështrënguar.’ Për të shpëtuar nga kjo vendosa: ‘Atë që kalon në dorën time sot, do t’ia jap të varfrit të parë që do ta takoj’. Duke menduar kështu, mu afrua

njëri nga shërbëtorët e Halifes me pesëdhjetë dukatë dhe më tha:

- Merri këto dhe harxhoi për nevojat e tua. Unë i mora dhe dola në rrugë. E pashë një të varfër duke u qethur te berberi. Hyra brenda dhe ia dhashë dukatet të varfrit, por ai më tha t'ia jap berberit!

- Çfarë je duke bërë, këto janë shumë, i thashë, e i varfri ma ktheu:

-O ti, a nuk thamë ne që ti je dorështrënguar? Kur tha kështu, nuk munda të durojë më dukatet, dhe ia dhashë berberit. Berberi tha:

-Jo, ne kemi bërë pazar që nga ky i varfër të mos marr para, unë nuk mund të marr dukatin tënd. I mora dukatet dhe menjëherë i hodha në lumin Tigër dhe thashë:

-Allahu ka poshtëruar atë që ty (dukatit) të jep rëndësi'.

Edhe Hanza b. Abdullah el-Alaviu tregon:

- Hyra në prani të Ebu'l-Hajri Tijanit. Në vete vendosa: Do t'i jap selam, do të qëndroj pak në shtëpinë e tij, por nuk do të ha. Vërtetë, qëndrova pak dhe kur u ngrita pashë se ai po vinte pas meje me një pjatë me gjellë dhe më tha:

-O djalosh, tashmë dole nga shtëpia ime dhe vendimi yt u anulua; tani mund të hash, merre këtë gjellë', dhe kështu më shpalosi një keramet. Zaten, ai ishte i njohur për keramete.

Ndërsa Ibrahim er-Raki thotë:

- Desha ta vizitoj Ebu'l-Hajri Tijanin. Në kohën e akshamit ai u bë imam, dhe falëm namazin e akshamit bashkë. Ai e lexoi Suren Fatiha krejt ngadalë. Kur përfundoi namazi dola jashtë për nevojë dhe të marr abdes. Një luan më

sulmoi dhe unë menjëherë e thirra Tijanin. Ai vrapoi, dhe duke iu drejtuar luanit, i tha:

-A nuk të thash që mos t'i prekësh mysafirët e mi?, dhe luani u tërhoq e shkoi. Unë kreve punë dhe u ktheva brenda. Ebu'l Hajri tha:

-Ju ishit të zënë me përmirësimin e zahirit (të jashtmes) tuaj dhe u frikësuat nga luani. Ne, meqë pastruam të brendshmen tonë, luani u frikësua nga ne.

Ka shumë shembuj ku shehlerët kanë njohur gjendjen e brendshme të njerëzve dhe e kanë treguar atë. Gjithashtu ka edhe plot tregime të kerametit për ata që e kanë parë Hidrin dhe e kanë pyetur gjësend, apo që kanë dëgjuar zëra në zbrazëtirë dhe lloj-lloj tregime tjera të ngjashme të kerameteve. Sa gjynah që ai vetëm se nuk sheh i mohon tregimet. Ai që mohon vërtetësinë e tyre, mohon edhe shpjegimin e hollësishëm për to.

Për të vërtetuar ekzistimin e kerametit aq sa askush nuk mund të mohojë, ekzistojnë dy dëshmi të forta:

1. Gjendja e ëndrrave të sakta është e çuditshme. Në gjendje të ëndërrimit, shfaqen fshehtësitë nga bota e fshehtë. Nëse shfaqet në ëndërr, përse të mos shfaqet kur jemi zgjuar? Mes gjumit dhe gjendjes së zgjuar nuk ka tjetër dallim, pos qetësisë së shqisave. Ai që është në ëndërr nuk merret me punët e shqisave. Por ka edhe shumë që janë zgjuar, por që për shkak të përhumbjes në mendime, nuk u reagojnë shqisat. As nuk dëgjojnë të folurit, as nuk shohin atë që u kalon pranë.

2. Lajmërimet e Resulallahut s.a.v.s nga *e fshehura (gajb)* dhe për ato që do të ndodhin në të ardhmen, gjë që e shpreh haptas Kur'ani Kerim. Ajo që është e mundshme (xhaiz) për Pejgamberin, është e mundshme edhe për ummetin e tij. Sepse edhe Pejgamberi është njeri. Pejgamberi është personi të cilit i zbulohen të vërtetat (hakikat) dhe që merret me edukimin e njerëzve. Atëherë, përse të jetë i pamundur zbulimi edhe për dikë tjetër, por që nuk merret me edukimin e njerëzve? Sigurisht që edhe këtyre u zbulohet. Por këta nuk quhen Pejgamberë, këta quhen evlia. Ai që u beson Pejgamberëve dhe ëndrrave të vërteta, beson që në zemër ekziston një derë e jashtme e cila u hapet shqisave (botës së jashtme), dhe një derë e brendshme e cila i hapet botës së melekut (botës së fshehur), e që është dera e ilham-it (frymëzimit) dhe vahjit (shpalljes). Ai që pranon ekzistimin e frymëzimit dhe shpalljes nuk mund të kufizojë nxënien e diturisë vetëm përmes mësimin, por duhet ta dijë që edhe përpjekja shpirtërore mund të bëhet mënyrë e përfitimit të diturisë. Kjo tregon esencën për shpjegimet tona lidhur me dyert e zemrës të cilat i hapen botës së dukshme dhe botës së fshehtë. Ashtu si shfaqen në ëndërr gjëra të cilat kanë nevojë për shpjegim, ashtu në forma të ndryshme melekët u shfaqen pejgamberëve dhe evliave; këto janë nga fshehtësitë e mahnitshme të zemrës. Këto mund të shpjegohen vetëm me diturinë *mukashefe*. Këtu ne të njoftuam me kaq, sepse kaq mjafton për nxitje në përpjekjen shpirtërore dhe në kërkim të diturisë në këtë mënyrë.

Njëri nga evliatë tregon:

- *M'u paraqit meleku me kërkesë që të shkruaj për veprat e mia që afrojnë tek Allahu, dhe tha:*

- *Të lutem, trego prej veprave të zemrës e ne të shkruajmë. Unë u thashë melekëve:*

- *A nuk po i shkruani veprat e mia farz? Melekët thanë:*

- *Gjithsesi, po i shkruajmë, dhe unë thashë:*

- *Aq mjafton.*

Ky shpjegim tregon që as melekët *kiramen katibin* nuk janë të informuar për veprat e zemrës, por i dinë vetëm veprat e jashtme.

Përsëri, njëri prej arifëve kështu tregon:

- *E pyeta njërin prej evliave të mëdhenj lidhur me një çështje. Ai shikoi në anën e majtë dhe tha:*

- *Allahu rahmet bëftë, çka thua? Shikoi në anën e djathtë dhe tha:*

- *Allahu rahmet bëftë, çka thua? Pastaj shikoi në gjoks dhe tha:*

- *Allahu rahmet bëftë, çka thua?*

Dhe pastaj më dha një përgjigje aq të çuditshme që unë kurrë nuk kisha dëgjuar. Në fund e pyeta për këto veprime të tij. Ai tha:

- *Unë nuk e dita përgjigjen në pyetjen tënde, e pyeta melekun në të majtë – nuk e diti. Meleku në anën e djathtë është më i dijshtëm, e pyeta atë, e as ai nuk diti. Pastaj iu drejtova zemrës dhe përgjigjen që ta dhashë ty e mora prej zemrës, dhe zemra doli më e ditur se dy melekët.*

Ky është kuptimi i fjalëve të shenjta të Resulallahut s.a.v.s.:

“..të cilët pastaj dalin në shesh të mësuar, të dobishëm, të frymëzuar dhe të edukuar, dhe të cilët përgjigjen, dhe Omeri është vërtetë njëri nga ta.”

Sipas veprave të arritura është shënuar që Allahu Teala thotë:

“Cilit rob Timit i dominon në zemër dhikri Im, Unë bëhem Drejtues i tij, Miku i tij dhe Bashkëbisedues i tij.”

Ebu Sulejman Darani, Allahu rahmet i bëftë, ka thënë:

“Zemra është si një kupolë. Përreth ekzistojnë dyer të mbyllura. Kur një derë hapet me vepra, nga ajo derë niset një rrugë drejt melekut dhe Mela-i A’la-së. Kjo derë hapet me përpjekje dhe me largim nga gjërat e dyshimta, nga dëshirat e epshit. Për këtë Omeri r.a., u ka thënë komandantëve të ushtrisë: ‘Dëgjoni fjalët e personave që i përulen Allahut, sepse atyre nga ana e Allahut Teala u shfaqet e vërteta dhe atë e flasin’.”

Përsëri njëri prej dijetarëve ka thënë:

“Ndihma e Allahut është në gjuhën e dijetarëve; ata flasin vetëm fjalët e mençura dhe të vërteta të cilat Allahu Teala i ka përgatitur për ta.”

Edhe një dijetar tjetër kështu ka thënë:

“Mund të themi që atyre që i përulen Allahut, Allahu uzbulon disa fshehtësi.”

NGACMIMI I SHEJTANIT ME VESVESE NË ZEMËR

Kuptimi i vesveses dhe shkakut i fitores

Dije se: siç treguam më lartë, zemra është si një kupolë me shumë dyer ku nga këto dyer derdhen brenda gjendjet, ose është si një nishan ku nga çdo anë hidhen shigjeta, ose si një pasqyrë e varur në të cilën pasqyrohen lloj-lloj figura, ose është si një pishinë në të cilën rrjedhin kanale të ndryshme të shkarkimit të ujit. Ndikimi i vazhdueshëm i këtyre sepepeve (shkaqeve) në zemër mund të bëhet nga jashtë përmes pesë shqisave, ose nga brenda përmes ahlakut, zemërimit, epshit dhe imagjinatës, të cilat ekzistojnë në natyrën e njeriut që nga krijimi. Kur njeriu kupton diçka nga njëra shqisë e jashtme, në zemër mbetet një gjurmë. Njëjtë, kur njeriu e kaplojnë epshet, për shkak të ngrënies së tepërt ose për shkak të temperamentit, edhe nëse njeriu kundërshton - në zemër mbetet ndikimi i tyre. Imagjinatat e realizuara në neftin e njeriut ngelin aty dhe imagjinata kalon nga një gjë në tjetrën. Për shkak të lëvizjes së imagjinatës, edhe zemra lëviz nga njëra gjendje në tjetrën. Qëllimi këtu është të dihet që ndryshimi dhe ndikimi në zemër vjen nga këto sepepe.

Ndikimi më i fuqishëm në zemër vjen nga shfaqja e kujtesës, d.m.th. janë gjërat që shfaqen në zemër nga mendimet dhe përkujtimet. Kësaj i thuhet kujtesë. Sepse zemra i kujton ato, pasi t'i ketë harruar. Këto kujtesa janë që nxisin dëshirën. Kjo për shkak që synimi, vendimi dhe dëshira vinë pas përkujtimit të diçkaje. Kujtesa është fillimi i çdo pune. Kujtesa vë në lëvizje dëshirën, dëshira vendimin, e vendimi qëllimin. Kurse qëllimi vë në lëvizje gjymtyrët, dhe kështu bëhet vepra.

Kujtesa që vë në lëvizje dëshirat dhe kërkesat ndahet në dy: një pjesë janë të këqija, të cilat në të ardhmen do të dëmtojnë, dhe pjesa e dytë janë mirësitë të cilat në të ardhmen do të bëhen të dobishme. Meqenëse këto janë dy kujtesa të ndara, ato edhe marrin emra të ndarë. Kujtesës që fton në mirësi i thuhet *ilham*, kurse kujtesës që fton në dëm i thuhet *vesvese*. Ti e di që këto kujtesa janë realizimet që vinë më vonë, e gjithçka që bëhet më vonë ka një shkaktar (sebe) për t'u bërë. Sa shtohen ndodhitë, shtohen edhe sebet.

Ky rregullim mbi përfundimet e sebepeve është një pjesë e njohur nga ligji i sebepeve të Allahut Teala. Në shembullin e ndriçimit të dhomës me dritën e zjarrit dhe nxirjes së tavanit me tym, ti e kupton që sebeti i ndriçimit është tjetër e sebeti i nxirjes tjetër. Edhe për ndriçim dhe nxirje të zemrës ka dy shkaqe të ndara. Sebetit të kujtesës që thërret në mirësi (hajr) i thuhet melek, dhe sebetit të kujtesës që thërret në keqbërje (sherr) i thuhet shejtan.

Forca që përgatit zemrën për pranimin e frymëzimit të mirësisë quhet *tevfik* (ndihma e Allahut për robin), kurse forca që përgatit zemrën për pranimin e vesveses së shejtanit quhet *igva* (grindje) dhe *hizlan* (i privuar nga ndima e Allahut). Ti e di që kuptimet e ndryshme kërkojnë emra të ndryshëm. Meleku është një krijesë e tillë e Allahut Teala që ka për detyrë të sjellë mirësi e dituri, të zbulojë të vërtetën, të pretojë mirësi (hair), të urdhërojë punë të mira. Allahu Teala për këtë e krijoi. Kurse shejtani është një krijesë e Allahut Teala, që detyra e tij është plotësisht e kundërta e detyrës së melekut, pra premtori sherrin, të keqen, urdhëron të shëmtuarën, thirr në gjynah dhe kur njerëzit dëshirojnë të

bëjnë mirësi dhe punë të vlefshme, shejtani e frikëson me varfëri. Vesvese është e kundërta e ilhamit, shejtani e kundërta e melekut. Si shenjë për këtë Allahu Teala thotë:

“Ne krijuam prej çdo sendi dy lloj.” 51-Dharijat: 49

Të gjitha krijesat janë në çift. I vetmi Allahu është tek. Ai është tek që krijon çiftet. Zemra është nën ndikimet e melekut dhe shejtanit.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Në zemër vjen presion nga dy drejtime. Njëra është nga meleku; premtion mirësi dhe vërteton drejtësinë. Kush e vëren këtë në zemër, le ta dijë se kjo është nga Allahu Teala dhe le ta falënderojë Allahun për këtë. Dhe vesvese vjen nga shejtani, premtion të keqen, përgënjeshton drejtësinë dhe e largon (njeriun) nga e mira. Kush e vëren këtë në zemër, le të kërkojë tek Allahu strehim dhe mbrojtje nga shejtani i mallkuar.”⁴²

Më pas Resulallahu s.a.v.s. lexoi ajetin Kur’anor:

“Shejtani ju frikëson me skamje dhe ju urdhëron të bëni vepra të pamoralshme.” 2-Bekare: 268

Hasani Basriu thotë: *“Ato janë dy preokupime dhe dëshira të cilat shëtiten në zemër. Njëra vjen nga Allahu, e tjetra nga armiku. Rahmeti i Allahut Teala qoftë mbi atë rob i cili mendon mbi preokupimte në zemër, dhe dëshiron atë që i vjen nga Allahu dhe refuzon e lufton atë që vjen nga armiku.”*

⁴² Hadithin e shënon Tirmidhiu, i cili konfirmon besueshmërinë e tij, dhe Nesai në veprën *‘el-Kubra’* nga Ibn Mesud.

Për rrotullimin e zemrës mes këtyre dy gjendjeve,

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Zemra e besimtarit është mes dy gishtave të fuqisë së Rahmanit.”⁴³

Allahu Teala është larg dhe i pastër nga gishtat e përbërë prej gjakut, kockës, nervit, mishit dhe damarëve. Kur thuhet *“gisht”*, nënkuptohet rrotullimi dhe lëvizja me shpejtësi. Zaten, as ti nuk ke nevojë për gishtin si gisht, por për punët që gishti i kryen. Edhe Allahu Teala duke ia përshtatë zemrën melekut dhe shejtanit bën në zemër çka të dëshirojë. Siç i janë përshtatur gishtave rrotullimet e gjërave materiale ashtu edhe zemra duke iu përshtatë melekut dhe shejtanit, vendoset në gjendje të dëshiruar - pra për ta kthyer atë majtas e djathtas.

Zemra, për nga natyra është në gjendje të pranojë në mënyrë të barabartë edhe ilhamin e melekut edhe vesvesen e shejtanit. Preferenca e njërës nga to vjen nga përshtatja e pshirit dhe pasimi i dëshirave e kënaqësive të përkohshme, ose nga largimi prej tyre dhe kundërshtimi i të njëjtave. Nëse njeriu i përshtatet e pshirit dhe zemërimit përmes ndjekjes së dëshirës dhe kënaqësisë së përkohshme, bie në provokim të shejtanit. Në këtë mënyrë, zemra i bëhet strehim shejtanit. Sepse dëshira dhe kënaqësitë e përkohshme janë ushqim i shejtanit dhe strehë e tij. E në qoftë se lufton me e pshirin dhe nuk e lejon atë ta provokojë, por përkundrazi - mbështillet me moralin e melekëve, zemra e tij arrin të bëhet një qendër ku melekët mblidhen.

⁴³ Muslimi nga Abdullah b. Omeri.

Kur zemra është e mbushur me dëshirat e përkohshme dhe nëse është e pafuqishme ndaj epshit, zemërimit, lakmisë, pangopësisë, dëshirave të pafund dhe të ngjashme, ajo zemër nuk mund të shpëtojë nga ndikimi i vesveses së shejtanit.

Për këtë, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Çdokush ka një shejtan.”

Kur u pyetën: *“Edhe ju e keni shejtanin?”*

Resulallahu s.a.v.s., tha:

“Po, edhe unë kam shejtanin, por Allahu Teala më ndihmoi dhe shejtani im u bë mysliman, dhe më urdhëron vetëm të mira.”⁴⁴

Epsi i atij që është i matur dhe të cilit Allahu Teala i ndihmon, atë epsi nuk e thërret në gjëra të këqija, e si ky edhe shejtani, i cili mbështillet me epsi, tani mund të thërras vetëm në të mira. Kur personi i përshtatet dëshirave të nefsit, dashuria e kësaj bote ia përfiton zemrën, dhe shejtani e gjen një derë për vesvese. E kur zemra merret me dhikrin e Allahut, shejtani largohet, ngushtohet mundësia e hyrjes së shejtanit në zemër, dhe meleku menjëherë e merr vendin e tij dhe fillon ilhami (frymëzimi). Në frontin e luftës për zemër vazhdon gara mes ushtarëve të shejtanit dhe melekut, derisa njëri fiton dhe hyn në zemër nga dera e hapur, ulet aty, vendoset dhe ngel me vendosmërinë që tjetri aty të mos shëtisë.

Ka shumë zemra të cilat i kanë pushtuar ushtarët e shejtanit, dhe të cilat ata i zotërojnë. Ata që kanë preferuar dynjanë duke harruar ahiretin, kanë mbushur zemrën me vesvese.

⁴⁴ Muslimi nga Ibn Mesud.

Fillimisht, përhapja e ushtarëve të shejtanit në zemër vjen nga përshtatja e pshirave dhe dëshirave. Pas kësaj, zemra mund të fitohet prapa vetëm me boshatisjen e zemrës nga forcat e shejtanit, e që janë pikërisht epshi dhe dëshirat. Pas boshatisjes së zemrës nga to, vjen radha e riparimit me përmendje Allahun (dhikër), gjë që mundëson ndikimin e melekut.

Xhabir b. Ubejd el-Adaviu thotë:

“Iu ankova për vesvesen në mua Ala b. Zijadit. Zijadi më tha:

- Zemra është si një shtëpi ku hyn hajni. Në qoftë se ka diçka - e merr, nëse nuk ka – shkon. Pra, shejtani nuk hyn në atë zemër e cila nuk ka dëshira dhe kërkesa të përkohshme.”

Ndërsa në ajet është urdhëruar:

“Në të vërtetë, ti nuk ke kurrfarë pushteti ndaj robërve të Mi!” 17-Isra: 65

Ndërsa ata që ju përshtatën dëshirave të përkohshme janë robë të dëshirave të veta e jo robë të Allahut:

“A e ke parë ti atë që duke e ditur, dëshirat e veta i ka bërë zot?!” 45-Xhathije: 23

Në këtë ajet ka shenjë për ata të cilët dëshirat e veta i kanë bërë zot - ata që pasojnë dëshirat e përkohshme nuk janë robë të Allahut, por janë robë të dëshirave të veta të përkohshme.

Për këtë arsye, kur Amr b. el-As r.a., i tha Resulallahut s.a.v.s.:

-“O Resulallah, shejtani hyri mes meje dhe namazit”, Resulallahu s.a.v.s. i tha:

“Ai është shejtani me emrin Hanzeb. Kur ndjen prezencën e tij, strehoju Allahut dhe pështyj tri herë në anën e majtë.”⁴⁵ Amr tha:

-“Edhe unë ashtu veprova, dhe Allahu Teala e largoi atë prej meje.”

Me një hadith kështu thuhet:

“Vërtet, abdesi ka një shejtan me emrin *Velhan*, prandaj kërkoni strehim te Allahu nga ai.”⁴⁶

Largimi i vesveses nga zemra është i mundur vetëm kur në zemër vendoset diçka tjetër që nuk jep vesvese, dhe çdo gjë që vendoset në zemër përveç dhikrit të Allahut, e ndihmon vesvesen e shejtanit. Vetëm përmendja (dhikri) i Allahut e ruan zemrën prej vesveses së shejtanit dhe është e ditur që me përmendjen e Allahut, shejtani nuk ka kurrfarë ndikimi. Gjithçka shërohet me të kundërtën e vet, dhe e kundërta e vesveses së shejtanit është përmendja (dhikri) e Allahut dhe kërkimi i ndihmës prej Tij. Ky është edhe kuptimi i fjalëve: **“Eudhu billahi mineshejtanirraxhim. La havle ve la kuvvete illa billahil-alijjil-adhim.”**

Vetëm të devotshmit, tek të cilët dominon përmendja e Allahut (dhikrullah), është e mundur të gjejnë rrugën e drejtë. Shejtani rreth tyre mund vetëm të sillet si një hajdut mashtrues.

⁴⁵ Transmeton Muslimi nga Ibn Ebu el-As.

⁴⁶ Ibn Maxhe dhe Tirmidhiu në transmetim të Ubejj ibn Ka'b.

Ndërsa Allahu Teala thotë:

“Vërtet, ata që janë të ruajtur, kur i prek ndonjë iluzion nga shejtani, ata përkujtojnë (Allahun) dhe atëherë shohin (të vërtetën).” 7-A’rafë: 201

Në transmetimin e ajetit **“min sheri-l vesvasi’l hannas”**, 114-Nas: 4, Muxhahidi ka thënë:

“Hannasi shpërndahet në zemër. Kur përmendet Allahu, ai mblidhet e ikë. Kur zemra dalldiset në pavëmendje, hannasi përsëri vepron.”

Këto janë gati-gati si përplasja e vazhdueshme e errësirës me dritën. Si arritja e dritës dhe shkuarja e errësirës, me përmendjen e Allahut - shejtani largohet. Meqenëse këto janë të kundërta të njëra-tjetrës, Allahu Teala thotë:

“Ata i ka vënë poshtë shejtani dhe i ka bërë që të harrojnë përmendjen e Allahut.” 58-Muxhadile: 19

Enesi r.a. transmeton që Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

“Vërtet, shejtani vendos feçkën e tij në zemrën e njeriut, e nëse ai kujton Allahun Teala, shejtani tërhiqet, por nëse e harron Allahun, shejtani ia përpin zemrën.”⁴⁷

Në transmetimin e një hadithi nga Ibn Vazzah, thuhet:

“Nëse njeriu, kur arrin moshën katërdhjetë vjeçare nuk bën teube për gjynahet e bëra, shejtani ia lëmon fytyrën me dorën e tij dhe thotë: ‘Kjo është një fytyrë që nuk shpëton’.”

⁴⁷ Transmetojnë Ibn Ebi’d-Dynja, Ibn Adije dhe Ebu Jala el-Musili.

Ashtu siç përzihet epshi në mishin dhe gjakun e njeriut, edhe autoriteti i shejtanit përzihet me mishin dhe gjakun e njeriut dhe e rrethon zemrën e tij.

Për këtë arsye, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Shejtani qarkullon nëpër trupin e njeriut si gjaku që qarkullon nëpër damarë. Ngushtoni rrugët të tij me uri.”⁴⁸

Sepse rruga e qarkullimit të shejtanit në njeriun është epshi. Ndërsa epshin e thyen uria. Meqenëse epshi e rrethon zemrën nga çdo anë, Allahu Teala na paralajmëron me këto fjalë të Iblisit:

“(Iblisi) Tha: *Për shkak se Ti më flake tej, unë do t’u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë e do t’u qasem atyre nga përpara dhe nga mbrapa, nga e djathta dhe nga e majta!*” 7-A’raf: 16-17

Edhe Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Vërtet, shejtani i qaset njeriut në mënyra të ndryshme: i qaset ashtu që t’ia bëjë Islamin të urryer duke i thënë: *‘Vallë, do ta pranosh Islamin e të largohesh nga feja jote dhe feja e të parëve tu!?’*

Njeriu e kundërshton dhe e pranon Islamin, e më pas ai i qaset duke e dekurajuar nga hixhreti, duke i thënë: **‘Vallë, do të braktisësh qiellin tënd dhe tokën tënde!?’** Njeriu e kundërshton dhe largohet nga vendi i tij, e shejtani më pas i qaset duke e dekurajuar nga lufta në rrugën e Allahut, duke i thënë: **‘Vallë, a do të luftosh në rrugë të Allahut, kur kjo nënkupton humbjen e jetës dhe të pasurisë; do të luftosh dhe do të vritesh, e gratë tua të martohen dhe pasuria jote**

⁴⁸Hadithin e kemi përmendur më herët.

të shpërndahet?!' Njeriu e kundërshton dhe lufton në rrugë të Allahut. Kush vepron kështu dhe vdes në atë rrugë, Allahu Teala e merr mbi Vete përgjegjësinë që ta fus në xhenet.”⁴⁹

Resulallahu s.a.v.s., vesvesen e shpjegon si tentim për pengim nga lufta muxhahidinin (luftëtarin); me mendimet se me vdekjen e tij, gruan dhe pasurinë ia merr tjetërkush. Mendime të këtilla janë të njohura për secilin. Çdo kujtim ka një sebeb, dhe ai sebeb ka nevojë për emër, në mënyrë që të njihet. Emri i sebepeve të kujtimit është shejtan. Nuk mund të ketë njeri pa shejtan. Për këtë arsye Resulallahu s.a.v.s., thotë: **“çdo njeri ka një shejtan.”** Dallimi është në përshtatje ose kundërshtim shejtanit.

Me këto shpjegime u bënë të kuptueshme konceptet e vesveses e ilhamit, melekut e shejtanit, dhe *tevfike hizlan*.

Po shejtani, a është materie apo s’është? Nëse është materie, si hyn në trupin e njeriut? Pas shpjegimeve të diturisë praktike, nuk ka nevojë të diskutohen thashetheme të tilla. Zaten, të shpjegohet qenia e shejtanit është sikur t’i thuhet njeriut se gjarpri i ka hyrë në këmishë, e ai të pyes se sa është i madh gjarpri, çfarë ngjyre ka, e çfarë forme është. Kur ta dëgjojë njeriu një kërcënim të tillë, ai duhet të gjejë çare dhe të shpëtojë sa më shpejtë. Njëjtë, kur dëgjohet për shejtanin, i cili është edhe më i dëmshëm se gjarpri, duhet punuar për largimin e tij, e jo të mendohet se a është ai materie apo jo.

⁴⁹ Shënon Nesai në transmetim të Subre b. Ebi Fakih, me zinxhir të besueshëm të transmetuesve.

Dihet mirë se duhet kundërshtuar mendimet të cilat çojnë në të keqe, sepse mendime të tilla do të na çojnë gjithsesi edhe te shkaktari. Gjithashtu dihet që armik është gjithçka që edhe në të ardhmen do ta ftojë njeriun në të keqe. Atij që e njeh armikun, i takon edhe ta luftojë atë. Allahu Teala, në disa ajete Kur'anore na ka njoftuar se shejtani është armiku jonë, dhe na ka tërhequr vërejtjen të mos biem në kurthin e tij. Disa prej këtyre ajeteve janë:

“Me të vërtetë, shejtani është armik për ju, andaj vështrojeni si armik! Ai vetëm i josh ithtarët e vet, që të bëhen shokë të zjarrit të përflakur.” 35-Fatir: 6

“Vallë, a nuk ju kam urdhëruar, o bijtë e Ademit, që të mos e adhuronit shejtanin, se ai është vërtet armik i hapët i juaji.” 36-Jasin: 60

Mbi të gjitha, njeriut i takon që të largojë armikun nga vetja. Por, për të ndjekur armikun duhet njohur fuqia dhe armët e tij. Armët e shejtanit janë dëshirat e përkohshme dhe epshi. Kjo mjafton për të mençurin. Kurse, të njihen cilësitë, hakikati dhe qenia e shejtanit, Allahu na ruajt prej sherrit tij, dhe të njihet hakikati i melekëve, është fushë e arifëve të cilët zhyten në dituritë *mukashefe*. Këto nuk janë të nevojshme të dihen në dituritë praktike (muamele).

Prapë, për një pjesë të kujtimeve të ngjashme me këto por të cilat thërrasin drejtpërdrejtë dhe sigurt në mirësi, duhet ditur padyshim që ato nuk janë vesvese, dhe duhet ditur se këto janë ilham (frymëzim). Duhet ditur gjithashtu që ekziston edhe ngurrimi për disa kujtime, se a janë frymëzim i melekut apo vesvese e shejtanit. Një tjetër mashtrim i

shejtanit është të paraqitet e keqja si mirësi. Kjo është e vështirë të dallohet. Këtu, shumica kanë rënë në rrezik. Kur shejtani nuk ka fuqi të ftojë në një të keqe të hapur, ai mundohet që të keqen ta paraqes si mirësi.

Për shembull, një dijetarit i thotë: *“Shikoji këta njerëz, këta janë shkatërruar në pavëmendje (gaflet), padituria i ka mundur. Ata janë të drejtuar kah xhehenemi. A nuk të dhimbsen këta robë të Allahut? Tregoju rrugën atyre me mësim dhe këshillë. Allahu Teala ty të dhuroi një zemër me aftësinë e të kuptuarit, të ka bërë gjuhë-ëmbël e me shprehje tërheqëse. Duke mos përhapur diturinë bëhesh mosmirënjohës, dhe duke mos ftuar në rrugë të drejtë meriton zemërimin e Allahut!”*, dhe me mashtrime të ndryshme e inkurajon dijetarin për të dhënë mësim. Më pas e shtyn të zbukurohet dhe të paraqitet karshi njerëzve me të folur të bukur dhe si njeri i mirësisë, duke i thënë: *“Nëse kështu nuk vepron, fjala jote nuk ndikon te njerëzit, dhe ata nuk e pranojnë të vërtetën.”* Këtë ia vendos mirë në kokë, dhe dijetari e mbjell farën e hipokrizisë, dëshirën për t’u pranuar nga njerëzit, për pozitë, murrjen para xhematit me dituri të shumtë, dhe zgjon në vete ndjenjën e përçmimit të të tjerëve. Ai mendon se duke dhënë mësim dhe këshillë, po bën mirësi, ndërsa qëllim ka të bëhet me pozitë, i nderuar, i rëndësishëm dhe i dashur mes njerëzve. Për këtë shkak shkon në shkatërrim, dhe ende mendon se është pranë Allahut, mes të zgjedhurve. Rreth këtyre, Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Allahu Teala e forcon këtë fe edhe me ata që nuk kanë fat në ahiret.”

Përsëri, kështu thotë:

“Vërtet, Allahu Teala e ndihmon këtë fe edhe me ata njerëz që janë të përbuzur.”

Për këtë është thënë që Iblisi, duke iu paraqitur Isasë alejhisselam, e thirri dhe i tha:

-Thuaj “La ilahe ilallah.” Isa alejhisselam tha:

*-Këto fjalë janë hak, por unë nuk i them me urdhrin tënd; sepse e dinte që në prapavijën e kësaj thirrjeje të tij në mirësi, ka fatkeqësi. Mashtrimet e tilla të shejtanit janë të shumta. Dijetarët, abidët, zahidët, të varfrit, të pasurit, ata që nuk dëshirojnë të dëgjojnë për gjynahet e veta, dhe shtresat e tjera që nuk zhyten në gjynahe të hapura, me mashtrime të tilla shkatërrohen. Në **“Librin e Krenarisë”**, që është një e katërta e librit *Ihja*, do të tregojmë një pjesë nga mashtrimet e shejtanit. Nëse Allahu na jep jetë e koha mundësi, në të ardhmen po mendoj të shkruaj një libër të veçantë për këtë çështje. Këtë libër do ta titulloj **“Telbis-i Iblis”**, sepse mashtrimet e shejtanit janë përhapur mes shoqërive dhe njerëzve, dhe kanë hyrë deri në medh’hebe, dhe në besim. Bile, ka vdekur shpirti i mirësisë, dhe vetëm forma dhe pamja ka mbetur. Të gjitha këto kanë ardhur nga mashtrimet e shejtanit.*

Njeriut i duhet të mendojë për secilin kujtim që i vjen dhe ta studiojë atë, se a është frymëzim i melekut apo vesvese e shejtanit. Në këtë çështje duhet të mbështetet plotësisht në largpamësinë për të bërë studimin, e jo në dëshira të përkohshme. Se a është një kujtim frymëzim apo vesvese, mund të kuptohet vetëm me nurin e devotshmërisë,

me mendjemprehtësi shpirtërore, largpamësi dhe me aftësi të diturisë. Pikërisht ashtu siç thotë Allahu Teala:

“Ata që i frikësohen Allahut, kur u vjen ndonjë mendim i lig nga shejtani, i kujtojnë (urdhrat e Tij), e atëherë e shohin rrugën e drejtë.” 7-A’raf: 201

Por, ai që nuk zgjedh devotshmërinë, i përshtatet dëshirave të veta të përkohshme dhe për këtë shkak anon kah mashtrimet e shejtanit, ai hutohet, bie në kthetrat e shejtanit, dhe pa e ditur, rrëshqet në shkatërrim.

Rreth tyre, Allahu Teala njofton:

“Atëherë, do të përballen me atë që nuk e kanë llogaritur...” 39-Zumer: 47

Është thënë që këtu flitet për ata të cilët kanë menduar që veprat e tyre janë të mira, por në të vërtetë ato janë punë të këqija.

Nga dituritë e shumta praktike, më të vështirat janë njohja e dredhive të nefsit (vetëmashtrimit) dhe mashtrimit të shejtanit, kurse kjo pjesë e njohjes është farz për çdo mysliman. Por, shumica e njerëzve këtë e kanë lënë pas dore, duke u marrë me gjëra që bëjnë të harrohen vesveset e shejtanit, që i mundësojnë shejtanit të sundojë mbi ta, armiqësinë e shejtanit dhe mënyrat e mbrojtjes prej tij.

Për të shpëtuar nga shumica e vesveseve, e vetmja zgjidhje është të mbyllen dyert e kujtimit. Dyert e kujtimit janë pesë shqisat. Edhe dyert e këtyre pesë shqisave vinë nga brenda epshit dhe interesimit për këtë botë (dynja). Vetmia në një dhomë të errët mbyll dyert e shqisave. Largimi nga

familja mbyll derën e vesveses që vjen nga brenda. Edhe pas kësaj, përsëri në zemër ka kacafytje dhe luftë. Ekziston dëshira për të penguar zemrën nga dhikri (përmendja e Allahut). Për këtë nevojitet luftë, e cila vazhdon deri në vdekje, sepse asnjë njeri në jetë nuk mund të shpëtojë nga shejtani.

Ndonëse, njeriu nganjëherë mundet ta forcojë veten duke mos iu përshtatur shejtanit, me përpjekje, ai largon nga vetja sherrin e shejtanit. Sidoqoftë, deri sa qarkullon gjaku në damarë, njeriu nuk guxon të mbetet pa përpjekje dhe mbrojtje. Sepse, deri sa njeriu është në jetë, dyert e zemrës së tij janë të hapura për shejtanin, dhe kurrsesi nuk mbyllen. E këto dyer janë epshi, zemërimi, xhelozia, lakmia dhe dyer tjera të së keqes. Kur dyert janë të hapura dhe armiku zgjuar, duhet bërë përpjekje për mbrojtjen e dyerve.

Dikush e pyeti Hasan Basriun:

-O Ebu Said, a fle shejtani? Hasan Basriu buzëqeshi, dhe i tha:

-Po të flinte ai, ne do të rehatoheshim pak.

Pra, për besimtarin kurrsesi nuk ka shpëtim prej shejtanit, por ka mënyra se si ai të largohet dhe dobësohet.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Besimtari mund ta dobësoj shejtanin e vet, ashtu siç e dobëson njeriu devenë në rrugëtim.”⁵⁰

Ibn Mesudi r.a., thoshte: *“Shejtani i besimtarit është i dobët.”*

⁵⁰ Ahmedi nga Ebu Hurejre r.a..

Kurse Kajs b. Haxhxaxh ka thënë: *“Shejtani im më tha:
- Kur hyra te ti isha si një shtazë e majmë. Tani jam bërë
si një trumcak. E pyeta:
- Pse u bërë ashtu?, e ai më tha:
-Më shkrive me dhikrullah’.*

Për të devotshmit nuk është e vështirë t’ia mbyllin dyert shejtanit dhe të mbrojnë dyert e jashtme të cilat inkurajojnë në gjynahe të jashtme. Vendi i rrëshqitjes së tyre është nga dyert e fshehura. Këto dyer i di secili, por nuk mund t’i mbrojë. Në këtë aluduam me tregimin e dijetarit më lartë. Vështirësia qëndron në atë se dyert që i hapen shejtanit janë të shumta, kurse është vetëm një derë që i hapet melekut dhe kjo derë e vetme përzihet me dyer tjera të shumta. Në këtë çështje, njeriu është si i ngeluri në errësirën e natës para rrugëve që shkojnë në shumë drejtime. Pa lindur dielli dhe pa shikuar gjithçka me sy hapur, ai nuk mund të përcaktojë drejtimin e duhur. Këtu, syri i hapur është syri i zemrës, i lustruar me devotshmëri. E drita e diellit është dituria që përfitohet nga Kur’ani dhe Sunneti, e që zbulon rrugët e ndërlikuara. Vetëm kështu ai mund ta gjej rrugën. Përndryshe, rrugët janë të shumta, dhe të gjitha janë të errëta dhe të ndërlikuara.

Abdullah b. Mesud r.a., ka thënë:
*“Një ditë, Resulallahu s.a.v.s., na vizatoi një vijë të drejtë dhe tha:
- **Kjo është rruga e Allahut, dhe që qon Allahut. Pastaj, nga ana e djathtë dhe e majtë e vijës vizatoi disa vija tjera, dhe tha:***

-Edhe këto janë rrugë, në secilën rrugë ulet në krye një shejtan, i cili thërret kah vetja. Pastaj e lexoi këtë ajet, duke treguar për ekzistimin e rrugëve të shumta:

“Kjo është rruga lme e drejtë; pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t’ju ndajnë nga rruga e Tij.”

6-En’am: 153

Ne dhamë një shembull të njërës nga rrugët e mbyllura. E treguam një rrugë qëmashton edhe dijetarët, shehlerët, abidët dhe personaqë ruhen nga gjynahet e hapëta. Tani ta tregojmë një rrugë tjetër, që nuk është e fshehtë, që është e hapur, por përsëri njeriu mashtrohet dhe nuk mund të shpëtojë veten.

Kjo është një ndodhi që transmetohet nga Resulallahu s.a.v.s.:

“Për të mashtruar një murg çifut, shejtani e mendoi një zgjedhje të këtillë: E goditi një vajzë të bukur nga një familje e pasur, e bëri me sëmundje epileptike dhe familjes i dha vesvese që ‘murgu është mundësi e shërimit’. Ata erdhën te murgu, i cili fillimisht nuk pranoi, por meqë nuk mundi të durojë këmbënguljen e tyre, në fund pranoi. Atëherë, shejtani (pëshpëriti) i dha vesvese murgut që të marrë virgjërinë e vajzës. Vajza mbetet shtatzënë. Shejtani i pëshpërit murgut: ‘Do të poshtërohesh, zgjedhja është të mbysësh vajzën’, dhe murgu e mbyti. Shejtani përsëri i jep vesvese murgut, dhe i thotë që ta varrosë vajzën, e kur të vijë prindërit e saj, t’u thotë që ka vdekur. Murgu ashtu edhe vepron. Kësaj here, shejtani kthehet te prindërit e vajzës, dhe me vesvese i bën prindërit të dyshojnë. Ata shkojnë dhe shohin që vajza vërtet ka vdekur dhe është

mbytur. Familja e zuri murgun dhe deshën ta vrasin për atë që ka bërë. Shejtani i thotë murgut: *‘unë i bëra të gjitha këto, prandaj ti mua më bëj dy sexhde, dhe unë të shpëtoj’*. Murgu i bën shejtanit sexhde, e shejtani i thotë që nuk ka asgjë me të.”⁵¹

Ky është i tilli për të cilin Allahu Teala thotë:

“Siç bën shejtani, i cili i thotë njeriut: ‘Mos besoj!’. Por, kur ky bëhet mohues, shejtani i thotë: ‘Unë nuk kam të bëj me ty!’ 59-Hashr: 16

Shiko mashtrimin e shejtanit, si e mashtroi murgun. Fillimi i gjithë kësaj është pranimi për të shëruar vajzën duke dëgjuar vesvesen e shejtanit. Në esencë, kjo nuk është diçka e rëndësishme, për më tepër - njeriu mendon që bën mirësi. Me dëshirë të fshehtë, kjo në zemrën e tij shihet si e bukur. Ai i hyn kësaj pune me zell, gjoja për mirësi, pastaj del nga rruga dhe dalë-ngadalë përparon në drejtim të gabuar, edhe në përfundim bie në një gjendje të pa shpëtim. Allahut i strehohemi nga këso lloj rreziqe. Si shenjë e kësaj, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Ai që shëtit rreth gardhit, lehtë mund të kalojë në të ndaluarën.”⁵²

⁵¹ Ibn Ebi’d-Dynja në vepër e tij *‘Mekaid-i Shajtan’*.

⁵² Buhariu dhe Muslimi nga Numan b. Beshiri.

NDËRHYRJET E SHEJTANIT NË ZEMËR

Shpjegim i rrugëve

Dije se, zemra është si një kala, dhe shejtani është si një armik që dëshiron të hyjë në atë kala. Ai dëshiron ta pushtojë dhe zotërojë kalanë. Mbrojtja e kalasë nga armiku është e mundur vetëm duke ruajtur dyert dhe duke sanuar mangësitë. Ai që nuk i di vendndodhjet e dyerve dhe mangësitë e kalasë, sigurisht që nuk mund të mbrojë kalanë. Mbrojtja e zemrës nga vesveset e shejtanit është *farzi ajn* për secilin. Gjithçka që nevojitet për të arritur të domosdoshmen, është gjithashtu e domosdoshme (*vaxhib*). Edhe dëbimi i shejtanit është i mundur me njohjen e rrugëve të hyrjes së tij. Andaj, edhe njohja e rrugëve të hyrjes së shejtanit është *vaxhib*. Rruga e hyrjes së shejtanit në zemër dhe dyert e tij janë cilësitë e njeriut. Aq sa ka cilësi, aq ka edhe dyer të shejtanit. Por, ne këtu do të bisedojmë për disa prej rrugëve, që janë si lugina të gjera, të volitshme për të kaluar nëpër to ushtria e shejtanit.

Epshi dhe zemërimi janë ndër rrugët më të gjera për hyrjen e shejtanit. Zemërimi asgjëson mendjen. Kur dobësohen ushtarët e mendjes, ushtria e shejtanit kalon në sulm. I zemëruari është zbavitje në duart e shejtanit, ashtu siç është lodra zbavitje në duart e fëmijës. Sipas transmetimit, Iblisi u takua me Musanë alejhisselam, dhe i tha:

- O Musa, ti je i zgjedhur për shpalljen e Allahut, dhe je një peygamber me të cilin Allahu ka biseduar. Kurse unë jam një prej krijesave të Tij, që bëra një gjynah, dhe u dëbova. Tani dua të bëj teube, prandaj ndërhyj për mua që të më pranohet teubeja tek Allahu.

Musa a.s. u kthye në Tur-i Sina për të biseduar me Allahun, e Allahu i tha:

-“**Përmbush amanetin**”, dhe Musa a.s. e tregoi çështjen. Allahu Teala i tha:

-“**Le t’i bëjë sexhde varrit të Ademit, që Të pranoj teuben e tij.**”

Musa a.s. ia tregoi kushtin Iblisit, e Iblisi, me mburrje dhe nevrikosje, tha:

-Unë atij për së gjalli nuk i bëra sexhde, e t’i bëj sexhde varrit të tij?!, e pas kësaj, i tha Musasë a.s.:

-Ti u mundove për mua, e tani kam obligim ndaj teje. Në tri raste më përkujto, dhe prej meje nuk të vjen dëm. E para, kur zemërohesh. Sepse në atë kohë shpirti im është në zemrën tënde, syri im në syrin tënd, dhe unë qarkulloj në trupin tënd sikur gjaku yt që qarkullon në damarët e tu. Prandaj mendo në mua kur të zemërohesh, sepse kur njeriu zemërohet unë i fryjë zjarr në hundën e tij dhe ai nuk di se çka është duke bërë. Gjithashtu më kujto mua kur të ndeshen dy ushtri. Sepse në atë kohë unë u afrohem njerëzve dhe i ftohi nga lufta duke ua përkujtuar atyre gratë, fëmijët, fqinjët. Dhe mos qëndro vet në një vend me gruan që e ke hallall ta martosh. Sepse unë aty bëhem përfaqësues i juaj te njëri-tjetri dhe patjetër zgjoj intrigë. Edhe atëherë më kujto mua.

Me këto fjalë, Iblisi flet për zemërimin, epsin dhe lakminë. Sepse ikja nga fronti i luftës është dëshirë për këtë botë.

Mos-bërja sexhde në varrin e Ademit është shenjë e xhelozisë, e që është rruga më e gjerë e shejtanit.

Thuhet se njëri nga evliatë e pyeti shejtanin:

- *Më trego si e mposht ti njeriun, e ai devijon?, e shejtani i tha:*

- *Kur zemërohet dhe kur entuziazmohet me dëshirat e veta, unë e mashtroj.*

Tregohet se Iblisi iu paraqit një murgu. Murgu e pyeti Iblisin:

- *Cili ves i njeriut të ndihmon ty?, e Iblisi i tha:*

- *Kur zemërohet njeriu, ai bëhet te ne si lodra në duart e fëmijës.*

Thuhet se Iblisi ka thënë:

“E si mundet të më mposhtë njeriu mua? Sepse, kur është në qejf, shkoj dhe i hyj në zemër, e kur zemërohet – i ulem mbi kokë!”

Tjera dyer të gjera të Iblisit janë xhelozia dhe lakmia. Kur njeriu lakmon diçka, ajo e bën të verbër dhe të shurdhër nga e vërteta.

Ndërsa Resulallahu s.a.v.s, thotë:

“Dashuria jote për një gjë, të bën ty të verbër dhe të shurdhër.”⁵³

Nuri i syrit të zemrës i njeh rrugët e hyrjes së shejtanit. Kur xhelozia dhe lakmia e verbërojnë syrin e zemrës, njeriu nuk sheh dhe në atë kohë shejtani gjen rrugë për të hyrë brenda. Shejtani i paraqet lakmitarit si të bukur gjithçka që nxit dëshirat e tij, edhe nëse ato janë të shëmtuara.

⁵³ Ebu Davud nga Ebu ed-Derda. r.a.

Sipas transmetimit, Nuhi alejhisselam u ngjit në anije me nga një çift prej secilit lloj. Një ditë e pa në anije një plak të cilin nuk e njohte, dhe e pyeti:

-Kush je ti, kush të mori ty në anije? Plaku tha:

-Unë jam shejtani. Hyra në anije për të përfiturat zemrat e njerëzve të tu ashtu që zemrat e tyre janë me mua, e trupi i tyre me ty. Nuhi a.s. tha:

-O i mallkuar, jashtë nga anija! Shejtani tha:

-Ka pesë gjëra që i di, tri do t'i tregoj, që të më lësh në anije, me ato unë i mashtroj njerëzit.

Allahu Teala i shpalli Nuhit a.s. që të injorojë ato tri shenja, por t'i mësojë dy të tjerat, gjë të cilën Nuhi a.s. ia përcolli shejtanit, në çka shejtani tha:

- Ato janë dy gjëra që mua kurrë nuk më zhgënjëjnë, dhe me të cilat i shkatërroj njerëzit. Ato janë xhelozia dhe lakmia. Zaten, për shkak të xhelozisë unë edhe u bëra shejtani i mallkuar. E sa i përket lakmimit, Allahu Teala në xhenet ia lejoi Ademit çdo gjë, e vetëm një pemë ia ndaloi. Unë e mashtrova Ademin pikërisht me lakmi ndaj pemës.

Tjetër derë e gjerë e hyrjes së shejtanit në zemër është ngopja me ushqim, qoftë edhe hallall. Kjo sepse, njeriu kur ngopet – përforcon epshin, e epshi është armë e shejtanit. Sipas transmetimit, Iblisi iu paraqit Jahja b. Zekerijasë alejhisselam. Jahja a.s. pa në dorë të Iblisit grepa të shumëllojshëm, dhe e pyeti”

-Çfarë janë këta grepa? Iblisi i tha:

-Këto janë epshet, me to e mashtroj njeriun, dhe e vari në to. Jahjaja a.s. e pyeti:

-A mundesh të më mashtrosh edhe mua? A mundesh edhe mua të më vendosësh në grep? Iblisi i tha:

-Po, kur ti ha shumë, ne të japim rëndim në namaz dhe dhikër. Në këtë, Jahjaja a.s. tha:

-Atëherë unë kurrë nuk do të ha shumë. Iblisi tha:

-Edhe unë askujt më nuk do t'i jap këshillë.

Është thënë që në të ngrënit e tepërt ka gjashtë dëme:

1. Largon nga zemra frikën prej Allahut.
2. Largon nga zemra mëshirën ndaj krijesave.
3. Pengon në zbatimin e urdhrave të shariatit.
4. Nëse dëgjon fjalët e mençura, zemra nuk zbutet.
5. Nëse flet fjalë të mençura, nuk ndikon te të tjerët.
6. Shkakton disa sëmundje.

Edhe një derë tjetër e gjerë e hyrjes së shejtanit është dashuria për luks në shtëpi, mobile dhe rroba. Kur shejtani sheh në zemrën e njeriut këtë sëmundje, ai ulet në atë zemër si në strofull dhe nuk largohet prej aty. Njeriun e inkurajon me adaptimin e shtëpisë, me zbukurim të dyerve, dritareve dhe oxhakut, me ndërtimin e shtëpive të mëdha, me posedimin e mjeteve luksoze të transportit etj., dhe tërë jetën ia lidh për to. Kur shejtani njëherë e lidh njeriun për to, ai më nuk ka nevojë të qëndrojë pranë tij, dhe kur e lidh njërin kështu, shejtani shkon te tjetri. E njeriu vazhdon ashtu tërë jetën dhe mbetet në rrugë të shejtanit. Duhet frikësuar që të mos vdiset në këtë gjendje.

Derë tjetër e gjerë për hyrje të shejtanit është edhe lajkatimi (kërkesa e pangopur). Kur lajkatimi dominon në zemër, shejtani me këmbëngulje dhe në mënyra të ndryshme i zbukuron njeriut shtirjen dhe dyftyrësinë ndaj atij të cilit i bëhet lajka, deri në atë masë sa ai njeriut i bëhet idhull.

Njeriu vazhdimisht mendon se si ti afrohet idhullit të tij, sa që edhe braktis thirrjen në mirësi dhe në ikje prej të keqes.

Sipas transmetimit nga Safvan b. Selim, Iblisi iu paraqit Abdullah b. Hanzelit dhe i tha:

- *Dëgjo, të të mësoj një gjë.* Abdullahu iu përgjigj:

- *Nuk kam nevojë për mësimin tënd.* Iblisi i tha:

- *Dëgjoje ti këshillën, nëse do – e merr, e nëse nuk do nuk e merr, dhe unë vazhdoj rrugën time; O biri i Hanzelit! Çdo gjë që kërkon, kërko prej Allahut. Kur zemërohesh, shiko si është gjendja jote – sepse kur ti zemërohesh, unë dominoj me ty.*

Edhe një nga dyert e mëdha të hyrjes së shejtanit në zemër është nxitimi. Resulallahu s.a.v.s, thotë:

“Ngutja është prej shejtanit, ndërsa mos-ngutja është prej Allahut.”⁵⁴

Allahu Teala thotë:

“Njeriu është krijuar i ngutur.” 21-Enbija: 37

“Vërtet që njeriu është i ngutur.” 17-Isra: 11

Allahu Teala urdhëron Resulallahun s.a.v.s.:

“Mos nxito për ta lexuar Kur’anin para se të përfundojë shpallja e tij.” 20-Ta’ha: 114

Sepse veprimi duhet të bëhet pasi të njihet dhe të kuptohet. Për të njohur dhe kuptuar është i nevojshëm mendimi, kurse ngutja është pengesë e tyre. Në kohën e ngutjes shejtani jep vesvese.

⁵⁴ Tirmidhiu nga Sehl b. Sadi

Sipas transmetimeve, kur lindi Isa alejhisselam, shejtanët u mblodhën rreth Iblisit dhe e pyetën:

- *Përse sonte u rrëzuan idhujt? Iblisi tha:*

- *Andej ka një ngjarje të re. Qëndroni pak këtu, dhe u sill rreth e rrotull, por nuk gjeti asgjë. Pastaj i pa melekët që kishin rrethuar Isanë a.s., kuptoi që Isaja kishte lindur, dhe menjëherë u kthye te shejtanët dhe u tha:*

- *Lindi një pejgamber. Për çdo shtatzënë kam pasur njohuri, përpos kësaj. Tani e humbëm shpresën që do të adhurohen idhujt. Por pas kësaj njeriut do t'i hyjmë përmes ngutjes.*

Tjetër derë e gjerë e hyrjes së shejtanit është pasuria, si dukatë, argjend, pará, shtëpi dhe kafshë. Çdo gjë që është më shumë se nevoja bëhet qendër e shejtanit. Zemra në të cilën ka aq sa mjafton është bosh. Por, nëse njeriu me zemër të tillë gjen në rrugë 100 dukatë, në zembrën e tij zgjohen 10 dëshira, dhe kërkesa e secilës dëshirë është 100 dukatë, prandaj 100 dukatet e gjetura as nuk do të mjaftonin. Ndërsa, pa i gjetur 100 dukatet e parë, ishte shumë rehat. Duke menduar që është i pasur me 100 dukatet e gjetura, tani kupton që i nevojiten edhe 900 dukatë të tjerë për të plotësuar dëshirat si shtëpi më e madhe, mobile, tesha, grua, shërbëtorë.

Secila nga këto kërkesa lind kërkesa të reja, dhe jeta kalon pa u ardhur fundi këtyre kërkesave, me çka ai meriton xhehenemin, sepse vetëm xhehenemi është fundi i dëshirave dhe epsheve.

Sabit Bennani tregon:

Kur Resulallahu s.a.v.s. u dërgua si peygamber, Iblisi u tha shejtanëve:

- Diçka ka ndodhur, shikoni çka është.

Shejtanët u shpërndanë në tërë dynjanë dhe nuk gjetën asgjë. Pastaj, Iblisi tha:

- Tani unë do të shikoj. Kur u kthye, tha:

- Muhammedi a.s. është dërguar si peygamber.

Iblisi vazhdimisht u dërgonte shejtanët as'habëve të Pejgamberit a.s., me dëshirën që t'i bëjë ata të grinden, por pa sukses, ata nuk mundën të bëjnë gjë, dhe i thanë Iblisit:

- Kurrë nuk kemi parë njerëz të tillë, ne atyre nuk mund t'ju japim vesvese. Edhe pak vesvese që u japim, kur falin namazin e zhdukin. Iblisi u tha:

- Duroni, leni për pak kohë. Së shpejti kjo botë do t'u hapet atyre. Ata do të anojnë nga kjo botë, dhe ne do të bëhemi të suksesshëm.

Përsëri, sipas transmetimit, një ditë Isa a.s., u mbështet në një gur. Iblisi erdhi dhe i tha:

- O Isa edhe ti ke zell për këtë botë.

Në këtë, Isa a.s. e mori gurin në dorë dhe e goditi Iblisin në kokë, duke i thënë:

- Merre, ky gur dhe tërë kjo botë qofshin tuat.

Kjo është e vërteta, ai që përdor bile edhe gurin si jastëk, konsiderohet se posedon diçka nga kjo botë. Si shembull, ai që ngrihet natën për të falë namaz, nëse afër ka një gur në të cilin mund të mbështetet, guri vazhdimisht e kujton atë në mbështetje dhe në gjumë. Po të mos ishte guri aty, ai nuk do të mendonte as për mbështetje e as për gjumë.

E si është atëherë gjendja e atij që ka jastëk dhe dyshek mëndafshi? Si ngrihet ai nga një shtrat i tillë dhe me çfarë gëzimi i bën ibadet Allahut Teala?

Edhe një tjetër derë e gjerë e hyrjes së shejtanit është koprracia dhe frika nga varfëria. Kjo frikë e pengon njeriun nga shpenzimet e duhura, nga dhënia e zeqatit dhe sadakasë, si dhe e nxit njeriun në grumbullim, e përfundimi është dënimi i dhimbshëm.

Sipas Kur'anit, dënim i dhimbshëm është premtuar për ata që grumbullojnë pasuri pa u kujdesur se a është hallall apo haram, dhe që nuk japin zeqatin. Hajseme b. Abdurrahman përcjell se shejtani ka thënë:

“Njeriu deri tani nuk ka mundur të më mposhtë, e edhe pas kësaj në tri gjëra nuk mund ta bëjë atë - në fitimin e padrejtë, harxhimin pa nevojë dhe mosdhënien atij që ka merituar.”

Kurse Sufjani Sevri ka thënë:

“Arma më e fuqishme e shejtanit për ta mbytur njeriun është frika nga varfëria. Shejtani nuk ka armë më të fuqishme kundër njeriut se kjo.

Kur kjo vesvese i vendoset njeriut në zemër, ai zhytet në gjëra të panevojshme, largohet nga e drejta, flet gjëra boshe, e bile edhe për Rabbin e vet mendon keq.”

Kur njeriu është koprrac për të fituar pasuri, ai vazhdimisht endet pazareve. E rrugët dhe pazaret janë vendqëndrimet kryesore të shejtanëve.

Resulallahu s.a.v.s., tregon:

“Kur zbriti Iblisi në tokë, i tha Allahut Teala:

- O Rabb, mua më përzure dhe më zbritë në tokë.

Atëherë, më jep mua një vendbanim. Allahu Teala i tha:

- Vendbanimi yt është hamami. Iblisi tha:

- Më jep një vend për mbledhje, ku do të qëndroj.

Allahu Teala tha:

- Vend i mbledhjes për ty janë rrugët, çarshitë dhe pazaret.

- Më jep ushqim.

- Ushqimi yt është ai ushqim që hahet pa bismilah.

- Më jep pije.

- Pija jote është çdo gjë që dehë.

- Më jep një lajmëtar.

- Lajmëtari yt është muzika.

- Më jep një libër.

- Libri yt është poezia.

- Më jep një shkrim.

- Shkrimi yt është tatuazhi.

- Më jep të folur.

-Fjalët tua janë gënjeshttrat.

- Më jap kurthe për njerëz.

- Kurthi yt janë femrat.

Një prej dyerve të gjera të hyrjes së shejtanit është fanatizmi ndaj medh'hebit si dhe kundërshtimi me urrejtje, përçmimi dhe ofendimi. Kjo gjende e shkatërron edhe gjynahqarin edhe besimtarin. Sepse ofendimi i njerëzve dhe kërkimi i mangësive të tjerët është një ves i keq. Atij që ka një ves të tillë, shejtani ia paraqet këtë si të mirë, dhe kjo vendoset në zemrën e personit dhe personi tërë mundin e

shpenzon në këtë rrugë. Ai është i kënaqur me këtë veprim, duke menduar që mundin është duke e shpenzuar në rrugë të fesë. Kurse ai është direkt në rrugë të shejtanit. Për shembull, dikush bëhet fanatik i Ebu Bekrit r.a., dhe nga të gjithë as'habët, ai e do Ebu Bekrin r.a. më së shumti. Në anën tjetër, ai pa drojë ushqehet me haram, pa drojë flet fjalë boshe dhe gënjeshtër, hyn në lloj-lloj ngatërresash, por këmbëngul se Ebu Bekri r.a., është më i lartë dhe me këtë mendon që angazhohet për fe.

Po të shihte Ebu Bekri r.a., këtë gjendje të tij, ai vet i pari do të bëhej armik tije! Sepse miku i Ebu Bekrit r.a., ndjek drejtimin e tij, e ruan gjuhën. Për të mos folur bosh, Ebu Bekri r.a. vendoste një gur në gojë. Si mund të jetë mik i Ebu Bekrit r.a. ai që flet gjëra të kota!?

Dikush tjetër preferon Alinë r.a., dhe e shohim që është fanatik i tij. Ai preferon Alinë r.a., nga të gjithë as'habët e tjerë, dhe këtë e llogarit si ibadet, por megjithatë nuk hyn në rrugën e tij. Kur ishte halife, Alia r.a., bleu një këmishë për tre derhemë dhe meqë këmisha i kishte krahët e gjatë, ai ia preu krahët me gërshtë, dhe me modesti e veshi atë këmishë. Derisa ai ishte një njeri i tillë, dikush që pretendon se është i dashuruari i tij pa pikë hezitimi vesh rroba të mëndafshit dhe zbukurohet me fitim haram. Dhe prapë pohon se e do Alinë r.a.! Ai nuk e di se armiku i parë i tij në ditën e kiametit do të jetë vetë Alia r.a..

Sikur ta dija, nëse dikush do të merrte nga shoku i vet fëmijën e tij, dritën e syrit të tij, dhe të fillonte ta godiste, ta rrihte, t'ia shkulte flokët dhe t'ia shkurtonte ato me gërshtë,

më tej të deklarojë se si ai e do shokun e tij, se si i është besnik; do të doja ta di se si do të ndihej atëherë ai njeri. Kurse dihet që për Ebu Bekrin, Omerin, Osmanin, Alinë dhe as'habët e tjerë të Resulallahut s.a.v.s., feja dhe Sheriati ishin më të dashura se familjet e tyre, bile, më të dashura se vetvetja. Ata që lëshohen në gjynahe shkatërrojnë sheriatin dhe e shkurtojnë atë me gërshërët e epshit, dhe në atë mënyrë i bëjnë qejfin Iblisit, armikut të Allahut dhe armikut të robëve të Tij të sinqertë. Vallë, si do të jetë gjendja e tyre në Ditën e Gjykimit kur të takohen me as'habët dhe me robët e sinqertë të Allahut?! Bile, sikur gjërat të zbuloheshin dhe sikur këta ta dinin se çka është ajo që as'habët dëshironin për ummetin e Muhammedit s.a.v.s., do të turpëroheshin nga përmendja e tyre deri sa janë duke bërë vepra të tilla të shëmtuara. Përveç kësaj, shejtani i mashtron duke u dëftuar se, ai që vdes duke e dashur Ebu Bekrin dhe Omerin, atë nuk do ta prek flaka e xhehenemit; të tjerët i mashtron duke u dëftuar se ai që vdes duke e dashur Alinë, nuk ka arsye të frikësohet. Kurse Resulallahu s.a.v.s. për Hazreti Fatimanë thotë:

“Fatimeja është pjesë e imja.”⁵⁵

E prapëseprapë, i tha:

“Bëj vepra të mira, sepse unë, vërtetë, nuk do të të jem në dobi te Allahu Teala.”⁵⁶

E njëjta vlen edhe për ata që janë fanatikë ndaj Shafisë, Ebu Hanifes, Malikut, Ahmedit dhe imamëve të tjerë. Secilit që pretendon se i takon njërit prej medh'hebeve të imamëve,

⁵⁵ Transmeton Musevver ibn Mahreme.

⁵⁶ Buhariu dhe Muslimi transmetoin nga Ebu Hurejre r.a.

por nuk përcjellë shembullin e atij imami, i njëjti imam do t'i jetë kundërshtar në Ditën e Gjykimit. Do t'i thuhet:

“Drejtimi (medh’hebi) im është bazuar në veprim, jo në fjalë. Fjalët kanë qenë në shërbim të veprave, e jo për të folur bosh. Pse ti veprime ndryshe? Jeta ime dhe veprat e mia janë medh’hebi im dhe drejtimi të cilin e kam përcjellë, dhe në atë rrugë kam arritur kënaqësinë (rizanë) e Allahut Teala. Pas gjithë kësaj, ti rrejshëm deklaroje se po përcjellë medh’hebin tim.”

Kjo është njëra nga hyrjet e mëdha të shejtanit, ku shumica e njerëzve janë shkatërruar. Medreset u janë dhënë njerëzve të cilët kanë pak frikë nga Allahu, të cilët do të kuptojnë fenë, por në anën tjetër kanë dëshirë të madhe për dynjallëk. Ata vazhdojnë të kenë pasues të shumtë, ani pse vet nuk kanë mundur të jenë pasues e as të arrijnë reputacion, përpos me fanatizëm. Mendojnë se këtë e kanë në gjoksin e tyre, por nuk i kanë tërhequr vërejtjen popullit për kurthet e shejtanit, i kanë injoruar ato, bile, edhe e kanë zëvendësuar shejtantin në vendosjen e kurtheve!

Njerëzit kanë këmbëngulur në atë rrugë dhe kanë harruar themelet e fesë së tyre. Ata janë shkatërruar vetë dhe kanë shkatërruar të tjerët, e Allahu Teala të na falë, neve dhe ata.

Hasani Basriu tregon:

“Kemi dëgjuar që Iblisi kishte thënë:

- E futa ummetin e Muhammedit (s.a.v.s.) në gjynahe, e ata më thyen qafën duke kërkuar falje nga Allahu Teala. Më pas, i futa në gjynahe për të cilat nuk kërkuan falje nga Allahu Teala, e ato janë dëshirat e nefsit.

Të vërtetën e ka thënë i mallkuari, sepse njerëzit nuk e kanë ditur që ndjekja e dëshirave të nefsit është një nga arsyet që qon në gjynahe prandaj si të kërkonin falje për këtë?

Një nga kurthet e rrezikshme të shejtanit është që të shtyjë njeriun të harrojë atë (d.m.th. shejtanin) ashtu që do të lëshohet në mendime të ndryshme për dallimet mes medh'hebeve dhe në thashetheme.

Abdullah ibn Mesud r.a. thotë:

“Një grup njerëzish u mblodhën për dhikër. U erdh shejtani me dëshirë që t’u prishë dhe ndërpres tubimin, por nuk ia arriti. Më pas, shejtani shkoi te një grup tjetër, e në atë takim njerëzit flisnin për dynjallëkun. Atyre ua prishi takimin, dhe ata u ngritën dhe filluan të rriheshin. Megjithatë, ata nuk ishin qëllimi i shejtanit. Atëherë, njerëzit nga grupi i parë (që ishin në dhikër) u ngritën dhe u morën me ndarjen e njerëzve të grupit të dytë. Pas ndarjes, ata e lanë takimin e vet dhe u shpërndanë, e ky edhe ishte qëllimi i shejtanit.”

Një tjetër kalim i gjerë për shejtanin është edhe shtyrja e të padijshmëve dhe të pa-udhëzuarve në mendime për Allahun Teala, për Qenien (Dhat) e Tij dhe cilësitë (Sifat) e Tij, dhe për çështje tjera, të cilat mendja e tyre nuk mund t’i konceptojë. Kështu ata fillojnë të dyshojnë në bazat e fesë, ose e paramendojnë Allahun të tillë çfarë Ai nuk është, dhe kështu shkojnë në mosbesim dhe bidat, duke u gëzuar për ata që u ka ardhur në zemër duke menduar që kjo është një njohuri e vërtetë dhe zbulim e cila u është treguar atyre si rezultat i mençurisë së tyre. Budallenjtë më të mëdhenj janë ata të cilët më së fuqishmi besojnë në mendjen e vet, kurse

më të kujdesshmit janë ata të cilët dobësitë i gjejnë në vete, e që vazhdimisht mësojnë duke pyetur dijetarët.

Aisha r.a. transmeton se Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

-Vërtet shejtani vjen te njëri nga ju dhe përmes vesveses pyet:

- *Kush të krijoi?, e personi përgjigjet:*

- *Allahu Teala! E shejtani vazhdon:*

- *E kush e krijoi Allahun? Kur dikush nga ju të vërejë këtë, le të thotë:*

- *Unë besoj në Allahun dhe Pejgamberin e Tij, sepse kjo do ta largojë vesvesen.*⁵⁷

Resulallahu s.a.v.s. nuk ka urdhëruar që të hulumtohet dhe të diskutohet për mënyrën e shërimit nga nxitjet e tilla të shejtanit, sepse këto janë nxitje të cilat mund të gjinden te njerëzit e zakonshëm, por jo edhe te dijetarët. Obligim i njerëzve të zakonshëm të padijshëm është të besojnë, të përulen dhe të merren me ibadete dhe me jetën e tyre të përditshme, e që diturinë t'ua lënë dijetarëve.

Njeriu i zakonshëm dhe i paditur, edhe po të bëjë ziná ose të vjedh, edhe kjo do të ishte më e mirë për të se sa të flasë për diturinë sepse ai që flet për Allahun Teala dhe për fenë pa dituri mund të shkojë në mosbesim (kufër), e për këtë të mos jetë në dije. Kjo të kujton atë i cili lëshohet në thellësitë e detit, e nuk di të notojë. Kurthet dhe rrugët e mashtrimit të shejtanit rreth besimit janë të pa numërta.

⁵⁷ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a..

Një nga dyert e gjera të hyrjes së shejtanit është edhe mendimi i keq për myslimanët. Allahu Teala thotë:

“O ju që keni besuar! Mënjanoni shumë dyshime, se, vërtet, disa dyshime janë gjynah.” 49-Huxhurat: 12

Atë i cili mendon keq për tjetrin pa kurrfarë arsye, shejtani e shtynë në thashetheme dhe shpifje e kështu njeriu dëmtohet; i cenon tjetrit të drejtat, ose refuzon t’i shpreh respekt, ose e përul dhe nënçmon duke e konsideruar veten më të mirë se tjetri, dhe krejt kjo e dërgon atë në shkatërrim. Prandaj Islami ndalon akuzimin e njerëzve, pa fakte. Resulallahu s.a.v.s. thotë: **“Ruajuni nga dyshimet!”**⁵⁸, e edhe ai vet është ruajtur nga to.

Transmetohet nga Ali ibn Husejn r.a, se Safija bint Hujejj ibn Ahtab ka treguar: *“Shkova te Resulallahu s.a.v.s. që ishte në itikaf në xhami, dhe i fola. Para iftarit u largova dhe ai u nis pas meje. Pranë tij kaluan dy ensarë të ri, i quan selam dhe vazhduan tutje, e ai i thirri dhe u tha:*

- Kjo është Safijja bint Hujejj!

Ata u përgjigjën:

- O Resulallah! Ne për ty mendojmë vetëm të mirën!

E ai ju tha:

-Vërtetë shejtani qarkullon në pasardhësit e Ademit ashtu siç qarkullon gjaku në trupin e njeriut! U frikësova që edhe në ju të mos fus dyshim’.⁵⁹

Shiko si Resulallahu s.a.v.s. kujdesej për besimin e tyre dhe si i ruante nga dyshimet. Shiko si brengosej për ummetin e vet prandaj i mësonte se si do të ruhen nga akuzat, që të mos ndodh që dijetari i devotshëm, i njohur për lidhjen e tij

⁵⁸ Me përmbajtje të njëjtë e shënon Haraiti në **‘Mekarimul-Ahlak’**.

⁵⁹ Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

me fenë dhe besnikëri ndaj saj, të jetë i pakujdesshëm e të ngazëllehet duke thënë: *“Për një si unë mendohet vetëm e mira.”* Sado që njeriu të jetë i devotshëm, të ketë frikë Allahun dhe të jetë dijetar, nuk e shikojnë të gjithë njerëzit njësoj; disa e shohin me kënaqësi, e të tjerët me përçmim. Për këtë një poet thotë:

“Syri i kënaqur është i verbër karshi turpit, e syri armik i zbulon të gjitha të këqijat.”

Prandaj duhet larguar nga mendimet e shëmtuara dhe nga akuzimet, sepse njerëzit e këqij për të tjerët mendojnë vetëm keq. Kur e sheh që dikush mendon keq për njerëzit duke i hulumtuar të metat e tyre, ta dish se ai njeri në brendinë e vet është i prishur, se në atë mënyrë nga vet ai del poshtërsia e tij dhe që ai të tjerët i sheh përmes vetes. Besimtari i vërtetë këmbëngul të gjejë arsyetim për tjetrin dhe e pranon, kurse hipokriti hulumton mangësitë. Zemra e besimtarit është e shëndoshë dhe e pastër, mendon vetëm të mira për njerëzit.

Këto janë vetëm disa nga hyrjet e shejtanit në zemër. Nëse ke menduar se do t'i numërojmë të gjitha hyrjet, këtë nuk jemi në gjendje ta bëjmë. Edhe këto që kemi përmendur tërheqin vërejtjen për hyrjet tjera. Secila veti e shëmtuar te njeriu paraqet armë të shejtanit dhe është një nga hyrjet e tij në zemrën e njeriut.

Nëse pyet se çka është zgjidhje për largimin e shejtanit dhe a është i mjaftueshëm dhikri dhe këndimi i:

La havle ve la kuvvete ila bilah;

dije se zgjidhje për zemrën është mbyllja e këtyre dyerve për shejtanin, dhe kjo është e mundur me pastrimin e zemrës nga veset të këqija. E për këtë mund të flitet gjerë e gjatë. Ndërsa qëllimi ynë në këtë pjesë të kësaj vepre është të tregojmë për ilaçin e cilësive të rrezikshme, e siç treguam më lartë, për secilën cilësi do të duhej një libër i veçantë.

Kur nga zemra të largohen rrënjët e këtyre cilësive të këqija, atëherë shejtani mund të ketë vetëm sulme të kohëpaskohshme, por nuk mund të vendoset në zemër. Këto sulme të kohëpaskohshme i largon dhikri. Sepse dhikri vendoset vërtet në zemër vetëm kur zemra të jetë mbushur me frikë prej Allahut (devotshmëri) dhe kur të jetë pastruar nga cilësitë e këqija. Në të kundërtën, dhikri do të jetë vetëm zë dhe nuk do të ketë kurrfarë ndikimi në zemër e as që do të largojë ndikimin e shejtanit. Prandaj Allahu Teala thotë:

“Ata që i frikësohen Allahut, sapo t’i prek shejtani, kujtohen, dhe menjëherë vijnë në vete.” 7-A’raf: 201

Pra, kjo ka të bëjë vetëm me të devotshmit, ata që i frikësohen Allahut.

Shembulli i shejtanit është si ai i qenit të uritur, i cili të afrohet, e nëse me vete nuk ke një copë bukë ose mish, edhe zëri yt *‘largohu’* mund ta largojë. Por, nëse me vete ke mish, e qeni është i uritur, ai do t’ia mësyjë mishit dhe ti nuk do të mund ta largosh vetëm me fjalë. Edhe shejtani është kështu. Nëse zemra në vete nuk ka ushqim për shejtanin, atëherë edhe dhikri mjafton që shejtani të largohet. Por, nëse në zemër mbizotërojnë epshet, ato do ta pengojnë dhikrin që të arrijë në thellësitë e zemrës, dhe në këtë mënyrë shejtani vendoset në qendër të zemrës. Në zemrën e të devotshmit nga e cila janë pastruar epshet dhe cilësitë e këqija, hyrja e

shejtanit nuk është për shkak të epsheve, por për shkak të pavëmendshmërisë së tij ndaj dhikrit. E kur kjo zemër i kthehet dhikrit, shejtani tërhiqet. Dëshmi për këtë janë fjalët e Allahut:

“...kërko mbrojtjen e Allahut kundër djallit të mallkuar” 16-Nahl: 98

Ebu Hurejrer.a., tregon:

- *Ishin takuar shejtani i besimtarit dhe shejtani i jobesimtarit. Shejtani i jobesimtarit shkëlqente, ishte i ushqyer, i majmë dhe i veshur mirë, kurse shejtani i besimtarit ishte i dobët, i pistë dhe i veshur keq. Shejtani i jobesimtarit e pyeti këtë tjetrin:*

- *Pse je dobësuar kështu?, e ky iu përgjigj:*

- *Unë jam me një njeri i cili, kur të hajë e përmend Allahun Teala kështu që unë mbetem i uritur, kur pi e përmend Allahun Teala e unë mbetem i etur, kur vishet e përmend Allahun Teala e unë mbetem zhveshur, kur pastrohet e përmend Allahun Teala e unë mbetem i pistë. Shejtani i jobesimtarit i tha:*

- *Unë jam me një njeri i cili nuk bën asgjë nga këto, kështu që me të unë e ha ushqimin e tij, pi atë çka ai pi dhe vishem me rrobat e tij.*

Muhammed ibn Vasi, çdo ditë pas namazit të sabahut e bënte këtë dua:

-*Allahu im! Ti na e ke ngarkuar armikun i cili i njeh mirë dobësitë tona; ai dhe ushtria e tij na shohin neve, e ne ata jo. Allahu im! Largoje atë nga ne siç e ke larguar nga mëshira Jote! Humbja shpresën te ne siç ia ke humbur shpresën në*

faljen Tënde! Na ndaj neve nga ai siç e ke ndarë atë nga mëshira Jote, sepse Ti, vërtet, mund t'i bësh të gjitha!

Transmetohet se, derisa Muhammed ibn Vasi ishte rrugës për në xhami, iu dëftua Iblisi në formën e tij dhe i tha:

- *O i biri i Vasiut, a po më njeh? Ky e pyeti:*

- *Kush je ti? I tha:*

- *Jam Iblisi. E pyeti:*

- *Çfarë do? Iblisi iu përgjigj:*

- *Kisha dashur që askujt të mos i tregosh për atë duanë tënde me të cilën kërkon strehim te Allahu Teala, e si shkëmbim, unë nuk do të të sulmoj. Muhammed ibn Vasi iu përgjigj:*

- *Pasha Allahun, kushdo që ta dëshirojë, nuk do ta privoj nga ajo, e ti bëj çfarë të duash!*

Transmetohet nga Abdurrahman ibn Ebu Lejle:

“Shejtani i kishte ardhur Resulallahut s.a.v.s. duke bartur një pishtar në dorë. Qëndronte pranë tij deri sa Resulallahu s.a.v.s., ishte në namaz. Resulallahu s.a.v.s. po lexonte Kur’an dhe po kërkonte mbrojtjen e Allahut, por shejtani nuk largohej. Atëherë i erdhi Xhebraili a.s. the i tha të lexojë si vijon:

- Mbrohëm me ndihmën e fjalëve të plota të Allahut, të cilave nuk mund t’u ikë as i miri as gjynahqari, nga e keqja e asaj që hyn në tokë dhe asaj që del prej saj, nga ajo që zbret nga qielli dhe ajo që ngjitet kah ai, nga sprovat e natës dhe ditës, përpos asaj që sjell të mira, o i Mëshirshmi!

Kur Resulallahu s.a.v.s., e bëri këtë dua, pishtari i shejtanit u fik dhe shejtani ra me fytyrë për toke.”⁶⁰

⁶⁰ Ibn Ebu ed-Dun’ja në veprën **‘Mekaidu’sh-shejtan’** si mursel-hadith. Imam Maliki shënon hadith të ngjashëm në veprën **‘El-Muvetta.’**

Hasani Basri tregon:

-U informova që Xhebraili a.s. i erdh Resulallahut s.a.v.s. dhe i tha:

- "Ifriti, njëri nga xhinët, po të vendos kurthe. Prandaj, kur të biesh në shtrat, këndoje Ajetul-Kursinë!"⁶¹

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

"Vërtet më erdh shejtani dhe mu vërsul. Më pas, përsëri mu vërsul. E kapa për fyti dhe, pasha Atë i Cili më dërgoi me të Vërtetën, nuk e lëshova deri sa në dorën time ndjeva ftohtësinë e ujit nga gjuha e tij. Dhe po të mos ishte duaja e vëllait tim Sulejmanit a.s., vërtet shejtani do të mbetej i shtrirë për tokë në xhami."⁶²

Resulallahu s.a.v.s. patë thënë:

"Në cilëndo rrugë të ecte Omeri, shejtani gjithsesi do zgjidhte rrugë tjetër, ku nuk është Omeri."⁶³

Kjo është për shkak që zemra e tij ishte e pastruar nga ushqimi dhe fuqitë e shejtanit, pra nga epshet.

Sado që ti të dëshirosh që shejtani të largohet nga ti vetëm me ndihmën e dhikrit, ashtu siç ka ikur nga Omeri r.a., kjo nuk do të jetë e mundur. Do të jesh sikur ai që dëshiron të shërohet dhe merr ilaçin para se të pastroj lukthin, duke dashur që ilaçi t'i ndihmojë, kurse lukthi është i zënë me tretjen e ushqimit të rëndë; e ti do të doje që dhikri të jetë i dobishëm për ty sikur që është ilaçi për atë që e merr pasi ta ketë pastruar dhe përgatitur lukthin. Dhikri është ilaç, e

⁶¹ Ibn Ebu ed-Dun'ja në veprën '*Mekaidu'sh-shejtan*' si mursel-hadith.

⁶² Transmeton Ibn Ebu ed-Dun'ja në veprën '*Mekaidu'sh-shejtan*' si mursel-hadith.

⁶³ Transmeton Ibn Ebu ed-Dun'ja nga Shabiu si mursel-hadith.

devotshmëria paraqet pastrimin e zemrës, e kjo nënkupton largimin e epsheve nga zemra. Kur dhikri të vijë në zemrën e cila është e pastruar nga gjithçka tjetër, atëherë shejtani largohet nga zemra, mu sikur sëmundja që largohet me ndikimin e ilaçit në lukth të zbrazët.

Allahu Teala thotë:

“Në të gjitha këto, për atë që ka mendje të shëndoshë dhe që i ka vënë veshin me vëmendje, ka argumente.”

50-Kaf: 37

dhe thotë:

“Ai (shejtani) është gjykuar ta humbë dhe ta orientojë në vuajtje të zjarrit të madh, atë që i miqësohet atij.”

22-Haxhxh: 4

E ai që me veprat e tij e pason shejtanin, edhe nëse me gjuhë bën dhikër, është mik i tij.

Nëse do të thoshe që hadithi në përgjithësi flet për atë që dhikri largon shejtanin, atëherë ti nuk ke kuptuar që shumica e përgjegjësive në Sheriat kanë kuptim të veçantë me kushtet të cilat i përmendin dijetarët e fesë. Shikoje veten, sepse ajo që dëgjon nuk është e njëjtë me atë që ti vet e sheh. Mendo për namazin tënd, i cili është kulmi i dhikrit tënd dhe ibadeteve tua! Përcill zemrën tënde kur je në namaz dhe shiko se si shejtani e tërheq atë në pazare, se si e rregullon këtë botë, se si i jep përgjigje kundërshtarit dhe se si të shëtit në lugina të kësaj bote dhe në rreziqe. Bile, deri në atë shkallë sa që vetëm në namaz të kujtohen detaje të vogla dhe të parëndësishme të kësaj bote, të cilat moti veç i ke harruar.

Veçanërisht shejtani me tërë fuqinë sulmon zemrën tënde kur je në namaz. Namazi është treguesi i vlerës së zemrës, dhe në namaz duken të gjitha anët e mira dhe të këqija të saj. Namazi nuk pranohet nga zemra e cila është e mbushur me eplotë e kësaj bote. Po e sheh që edhe në namaz shejtani nuk po të largohet, ndoshta t'i shton vesveset, njëjtë siç mund të të bëjë dëm marrja e ilaçit para pastrimit të lukthit.

Nëse dëshiron të çlirohesh nga shejtani, atëherë së pari pajisu me devotshmëri (takvallëk), e më pas merr ilaçin, pra apliko dhikrin, e atëherë shejtani do të ikë nga ti, mu ashtu siç ka ikur nga Omeri r.a.

Prandaj Vehm ibn Munebbih ka thënë:

“Frikësoju Allahut dhe mos e shaj shejtanin publikisht, kur tinëz ti je mik i tij!”

Dikush ka thënë:

“Çudi se si dikush mund të kundërshtojë mirëbërësin pasi të jetë bindur në mirësinë e tij, e t'i përshtatet të mallkuarit, pasi të jetë bindur në padrejtësinë dhe ligësinë e tij.”

Allahu Teala thotë:

“Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem!”40-Gafir: 60,

e ti i lutesh e i bën dua, e Ai nuk të përgjigjet; njëjtë, ti bën dhikër por shejtani nuk ikë nga ti, e kjo është për shkak që nuk janë plotësuar kushtet e dhikrit dhe duasë.

Disa e kishin pyetur Ibrahim ibn Ed'hemin:

- *Çfarë po ndodh me ne, po i drejtojmë dua Allahut, e Ai nuk po na përgjigjet!?, e Ai ka thënë:*

“Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem!”

Ibrahimi u përgjigj:

- *Kjo është për shkak që zemrat tuaja janë të vdekura.*

- *Çfarë i ka bërë të vdekura?, pyetën, e ai u përgjigj:*

- *Tetë gjëra i kanë bërë ato të vdekura:*

1) *keni kuptuar obligimet tuaja ndaj Allahut Teala, por nuk po i përmbushni;*

2) *keni lexuar Kur’anin, por nuk po punoni përshtatshëm rregullave të tij;*

3) *thoni se e doni Resulallahun s.a.v.s., por nuk po punoni përshtatshëm sunnetit të tij;*

4) *thoni se i frikësoheni vdekjes, por nuk po përgatiteni për të.*

5) *Allahu Teala thotë:*

“Me të vërtetë, shejtani është armik për ju, andaj vështrojeni si armik!” (35-Fatir: 6), *e ju me gjuhë deklaroni që është armik por me vepra i përshtateni atij.*

6) *thoni se i frikësoheni xhehenemit, por me tërë fuqinë dhe veprimet e hidhni veten në xhehenem.*

7) *thoni se e doni xhenetin, por nuk përgatiteni për xhenet.*

8) *kur ngriheni nga shtretërit tuaj, mangësitë e juaja i hidhni pas shpine, e para vetes merrni mangësitë e të tjerëve, dhe ashtu zemëroni Rabbin tuaj; e si t’u pranohet duaja juve?”*

Nëse pyetja është se a ka një shejtan, apo ka më shumë të tillë, që ftojnë në të keqe; dije se nuk ke nevojë për pyetje të tilla në jetën praktike, detyra jote është të largosh armikun, e jo të analizosh cilësitë e tij. Ha rrushin e mos pyet për vreshtën!

Megjithatë, ajo çka mund të kuptohet nga dëshmitë e soditjes shpirtërore dhe me syrin e zemrës të cilat i gjejmë në transmetime, është që shejtanët janë një ushtri të cilët e ndihmojnë njëri-tjetrin. Secili lloj i gjynahut ka shejtanin e vet që thërret në atë drejtim. Deri në një përfundim të caktuar mund të arrihet me soditje dhe meditim të kujdesshëm, por këtu fjala zgjatet. Mjafton që e cekëm faktin se shkaktarët e ndryshëm dëshmojnë shkaqe të ndryshme, si rasti që kemi treguar kur drita e zjarrit ndriçon, kurse tymi nxinë.

Kur jemi te transmetimet, Muxhahidi thotë:

“Iblisi ka pesë fëmijë, e secilit prej tyre i ka dhënë nga një detyrë të caktuar: Sebur, A’ver, Mabsut, Dasim dhe Zelenbur. Sebur merret me fatkeqësitë. Në momente fatkeqësie, ai inkurajon britmat si ‘u shkatërrova’ e ‘humba’, në shqyerje të rrobave, goditje në fytyrë, në adete të xhahilijetit..A’ver merret me punët e zinásë. Inkurajon njerëzit në ziná dhe e zbukuron atë. Mabsut inkurajon njerëzit në gënjeshtër. Dasim hyn në shtëpi, ia qet mangësitë në shesh dhe e zemëron kryefamiljarin, e mes anëtarëve tjerë të familjes nxit grindje. Zelenbur është shejtani i pazarit dhe inkurajon njerëzit vazhdimisht të bëjnë gjynahe. Përveç këtyre është edhe shejtani i namazit, që quhet Hanzeb, kurse shejtani i abdesit quhet Velhan, dhe për këtë çështje ka shumë transmetime.”

Ashtu siç ka shumë shejtanë, ka edhe shumë melekë. Në librin **“Shur”** do të tregojmë fshehtësitë e shumta të melekëve dhe detyrën e veçantë për secilin prej tyre veç-e-veç. Ebu Umame el-Behili thotë që Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

“Për secilin besimtar janë angazhuar njëqind e gjashtëdhjetë melekë që ta mbrojnë nga ajo nga e cila ai nuk është në gjendje të mbrohet. Nga ky numër, shtatë melekë janë të ngarkuar të mbrojnë syrin nga sulmet e shejtanit, të cilët e mbrojnë atë mu sikur që mbrohet kosherja me mjalte nga mizat në ditët verore. E nëse kjo do t’ju shfaqej, ju do të shihnit shejtanët në secilën luginë dhe në secilën kodër me duar të shtrira dhe me gojë të hapur në gjendje sulmi, ashtu që, sikur njeriu t’i lihej vetes vetëm edhe për një çast, ata do ta shkatërronin.”⁶⁴

Ejjub ibn Junus ibn Jezid tregon se ka dëgjuar që me fëmijët e njerëzve lindin edhe fëmijët e xhinëve, e më pas, rriten bashkë me ta. Sipas tregimit të Xhabir ibn Abdullah, kur Ademi a.s. është lëshuar në tokë, ka thënë:

- *Allahu im! Me këtë që mes meje e tij ke caktuar armiqësi, nëse nuk më ndihmon, nuk do të jem në gjendje të përballoj.* Allahu Teala i tha:

- **Për secilin fëmijë që të lind, do të caktohet një melek që do ta mbrojë.** Ademi a.s. tha:

- *Më rrit ndihmën!* Allahu Teala i tha:

-**Për një vepër të keqe Unë dënoj një herë, për çdo vepër të mirë Unë shpërblej dhjetë herë, e edhe më shumë se kaq, sa Unë dua.** Ademi a.s. tha:

⁶⁴ Ibn Ebu ed-Dun’ja në veprën **‘Mekaidu’sh-shejtan’**, dhe Taberani në **‘Muxhem-i Kebir’**.

-Më rrit ndihmën! Ai tha:

-Dyert e pendimit dhe të faljes janë të hapura për aq sa shpirti është në trup. Atëherë Iblisi tha:

-Allahu im! Me këtë rob të cilin e ke shpërblyer në krahësim me mua, nëse nuk më ndihmon, nuk do të mund të përballoj. Allahu Teala tha:

- Sa herë që atij t'i lind fëmijë, edhe ty do të të lind fëmijë. Iblisi tha:

- Ma rrit ndihmën, Allahu im! Allahu Teala i tha:

- Do të qarkullosh në ta sikur që qarkullon gjaku i tyre, e gjokset e tyre do t'i merrni për shtëpi tuaja. Iblisi tha:

- Ma rrit ndihmën, Allahu im! Allahu Teala i tha:

“Lësho kundër tyre gjithë kalorësinë e këmbësorinë tënde!” 17-Isra: 64

Ebu Derda r.a. transmeton nga Resulallahu s.a.v.s.:

“Allahu Teala ka krijuar tri lloje xhinësh, një lloj janë në formën e gjarprit, akrepit dhe zvarranikëve; lloji i dytë janë si era, lloji i tretë janë ata që do të jenë të shpërblyer dhe të dënuar.

Allahu Teala gjithashtu ka krijuar tri lloje njerëzish: një lloj janë si kafshët, siç thotë edhe Allahu Teala: “

...Ata kanë zemra, por nuk kuptojnë, kanë sy, por nuk shohin dhe kanë veshë, por nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, madje edhe më zi...” (7-Araf: 179)

Lloji i dytë janë shejtanë në formë njeriu, e lloji i tretë janë ata njerëz të cilët në Ditën e Gjykimit do të jenë nën Hijen e Allahut Teala, në ditën kur nuk do të ketë hije tjetër pos Hijes së Tij.”⁶⁵

⁶⁵ Hadhithin në transmetim të Ebu Derdes e shënojnë Ibn Ebu ed-Dunja në veprën ‘*Mekaidu'sh-Shejtan*’, Ibn Hibban në ‘*Dhu'afa*’.

Vuhejb ibn el-Verd tregon se Iblisi iu dëftua Jahja ibn Zekerijasë a.s. dhe i tha:

- *Kisha dashur të të këshilloj. Jahjaja a.s. iu përgjigj:*

- *Mua nuk më nevojitet këshilla jote, por do të doja të më tregosh diçka për njerëzit. Iblisi i tha:*

- *Ne i ndajmë njerëzit në tri kategori: kategoria e parë janë për ne njerëzit më të këqij, e ata janë të cilëve u afrohemi me qëllimin që t'i mashtrojmë dhe ia arrijmë qëllimit, por ata menjëherë pendohen dhe kërkojnë falje nga Allahu, dhe kështu na prishin të gjitha që deri atëherë i kemi bërë. Më pas, prapë iu afrohemi, por edhe ata përsërisin veprimet. Me ta jemi në telashe të mëdha. Kur është në pyetje kategoria e dytë e njerëzve, ata janë në duart tona mu si topi në duart e fëmijëve tuaj dhe me ta luajmë si të duam. Ata na janë lëshuar plotësisht neve. Kategoria e tretë janë ata si ti, pa gjynahe. Te ata nuk jemi në gjendje të bëjmë asgjë.*

Nëse thua:

Si ndodh që shejtani ju paraqitet disa njerëzve e të tjerëve jo? Nëse njeriu sheh formën e shejtanit, a është ajo forma e tij e vërtetë, apo vetëm siluetë e cila i paraqitet njeriut? Nëse ajo është forma e vërtetë e shejtanit, si ndodh që ai të paraqitet edhe në forma tjera dhe si ndodh që të shihet në një kohë në dy vende të ndryshme dhe në dy forma të ndryshme?; ta dish se shejtani dhe meleku kanë format e tyre të vërteta. Vetëm me dritën (nurin) e pejgamberllëkut është e mundur të shihen format e tyre të vërteta.

Gjithashtu këtë hadith e shënon Hakimi në transmetim nga Ebu Sa'lebe el-Hushenij, dhe thotë që zinxhiri i transmetuesve është i besueshëm.

Resulallahu s.a.v.s. ka parë formën e vërtetë të Xhebrailit a.s. vetëm dy herë. Dhe kjo kështu ka ndodhur: Resulallahu s.a.v.s., kërkoi nga ai (Xhebraili a.s) t'i paraqitet në formën e tij të vërtetë. Xhebraili a.s. ia premtoi këtë në el-Beki, kurse iu paraqit në kodrën Hira, ashtu që e mbylli gjithë horizontin, nga lindja në perëndim. Herën e dytë e pa në formën e tij të vërtetë në natën e Miraxhit, në **Sidret-ul-Munteha**. Megjithatë, më së shpeshti e ka parë në formë të njeriut⁶⁶. E ka parë në formën e as'habit **Dihje-i Kelbi**⁶⁷. Dihje ishte një njeri me fytyrë të bukur. Ai zakonisht në formë të ngjashme u paraqitet evliave të mëdhenj, kurse shejtani evliave u paraqitet kur janë zgjuar, dhe ata e shohin me sytë e tyre, dhe e dëgjojnë të folurit e tij (shejtanit) me veshët e tyre, dhe kjo zë vendin e formës së tij (shejtanit) të vërtetë. Robëve të mirë të Allahut Teala (salihëve), kryesisht u paraqitet në ëndërr, kurse paraqitje në gjendje të zgjuar u ndodh vetëm atyre të cilët kanë arritur gradë të tillë që preokupimi i shqisave të tyre me këtë botë nuk mund t'i ndalojë në zbulimin (*keshf*), siç ndodh në gjumë, prandaj shohin të zgjuar atë që të tjerët shohin në ëndërr.

Transmetohet nga Omer ibn Abdulaziz, Allahu e mëshiroftë, që një njeri iu lut Allahut Teala që t'ia tregojë vendin e shejtanit në relacion me zemrën e njeriut, kështu që në ëndërr pa një trup si kristal dhe të tejdukshëm të njeriut, kurse shejtanin e pa në formë të një bretkoce e cila qëndronte ulur në krahun e tij të majtë, në mes të veshit dhe krahut, me një gyp të hollë që e kishte futur brenda, nga

⁶⁶ Hadith nga Buhariu dhe Muslimi në transmetim të Aishes r.a..

⁶⁷ Hadith nga Buhariu dhe Muslimi në transmetim të Usama ibn Zejd.

krahu i majtë deri te zemra e tij, duke dhënë vesvese. Kur përmendte Allahun Teala, shejtani largohej. Ngjashëm kësaj mund të shihet edhe në gjendje të zgjuar. Kështu, disa evlia e shohin shejtanin në formë të qenit i cili rri ulur pranë ngordhësirës dhe thërret njerëzit në këtë ngordhësirë. Ngordhësira paraqet dynjallëkun. Kjo pamje konsiderohet sikur të shihet forma e vërtetë e shejtanit. Sepse zemrës i paraqitet e vërteta (hakikati) nga ana e botës së padukshme (*botës së melekut*). Ky hakikat në zemër ndriçon kah ana e botës së dukshme (*alem el-mulk ve esh-shehade*). Këto dy botë kanë lidhje njëra me tjetrën, kurse më lartë kemi shpjeguar se zemra ka dy fytyra: një të hapur kah bota e padukshme dhe kjo është hyrja për frymëzim dhe shpallje, dhe ana tjetër e hapur kah bota e dukshme për pesë shqisat.

Ajo që shfaqet në anën e hapur kah bota e dukshme është vetëm një formë e imagjinuar. Sepse e gjithë bota e dukshme është imagjinatë, me atë që imagjinata nganjëherë shfaqet nëpërmjet pesë shqisave të drejtuara kah bota e dukshme. Prandaj është e pranueshme (*xhaiz*) që forma e parë t'i përshtatet kuptimit dhe hakikatit.

Kështu që mund të shihet personi me pamje të bukur të jashtme, por me brendësi të shëmtuar dhe shpirtërisht i prishur. Sepse bota e dukshme është një botë e ndërlikuar. Por kur është fjala për botën e melekut, forma e imagjinatës e cila ndriçohet në brendësinë e zemrës bëhet vetëm përshtatshëm karakterit dhe nga ajo lajmëron, sepse forma në botën e fshehur i përputhet plotësisht me karakterin.

Prandaj, është e sigurt që kuptimi i shëmtuar mund të shihet vetëm në formë të shëmtuar. Kështu, shejtani shihet në formë të qenit, bretkocës, derrit dhe të ngjashme, kurse meleku shihet në formë të bukur. Format e jashtme, përbëjnë esencën e karakterit, dhe nga to lajmërojnë. Për këtë arsye, gjërat që shihen në ëndërr, si majmuni dhe derri, paraqesin njeriun e keq, kurse delja tregon njeriun e drejtë dhe të butë.

Kështu është me të gjitha dyert e interpretimit dhe të ëndrrave. Kjo është një fshehtësi nga fshehtësitë e mahnitshme të zemrës. Nuk është e përshtatshme të tregohen këto në pjesën e praktikës, por qëllimi ynë është të shpjegojmë se shejtanin, e njëjtë edhe melekët, evliatë mund t'i shohin. Nganjëherë mund të shihet si simbol, siç shihet në ëndërr, dhe nganjëherë në të vërtetë. Në përgjithësi shihet në formën që e simbolizon kuptimin. Ndërsa kjo nuk është vërtetë kuptimi, por është shembulli i tij. Por, meleku shihet në të vërtetën e tij, e këtë mund ta shohin vetëm evliatë, e jo edhe ata që flenë.

PËR CILAT VESVESE, SYNIME DHE MENDIME NJERIU DO TË PYETET DHE PREJ CILAVE FALET

Dije se kjo pyetje është mjaft e mbuluar dhe është një çështje që nuk zgjidhet lehtë. Për këtë çështje ekzistojnë ajete dhe hadithe me kuptime të kundërta karshi njëri-tjetrit. Harmonizimi i tyre është i vështirë. Vetëm dijetarët e përkryer dhe të zgjuar, të cilët njohin sheriatin, mund ta zgjidhin këtë çështje.

HADITHET LIDHUR ME KËTË ÇËSHTJE

Në transmetimin e Buhariut dhe Muslimit nga Ebu Hurejre r.a., Resulallahu s.a.v.s thotë:

“Është falë ummeti im për atë që përkujton përderisa nuk flet dhe nuk vepron me të.”

Përsëri në transmetim të Buhariut dhe Muslimit, Resulallahu s.a.v.s., kështu thotë:

“Allahu Teala melekëve që shkruajnë u thotë: ‘Kur robi im synon të bëjë një vepër të keqe, mos e shkruani, e nëse e bën atëherë shkruani një vepër të keqe. Kur synon të bëjë një vepër të mirë por nuk e bën, shkruani si vepër të mirë (të bërë), e nëse e bën atëherë shkruani si dhjetë vepra të mira.’”

Këto transmetime dëshmojnë se synimi i zemrës për të keqen do të falet.

Në një transmetim tjetër:

“Kush synon ta bëjë një vepër të mirë, por nuk e bën, do t’i shkruhet si vepër e mirë. Kush synon ta bëjë në vepër të mirë dhe këtë e bën i jepen deri në shtatëqind shpërblime. Kush synon ta bëjë një vepër të keqe - nëse nuk e bën asgjë nuk i shkruhet, e nëse e bën i shkruhet një vepër e keqe.”

Edhe me një transmetim tjetër:

“(Allahu Teala thotë) kur mendon në vete për të bërë një vepër të keqe, përderisa nuk e bën – Unë ia fali.”

Të gjitha këto janë dëshmi që njeriu do të falet për mendime të këqija në vete, të cilat nuk i realizon.

Ja edhe dëshmitë e përgjegjesisë:

“Për atë që e keni në shpirtin tuaj, e shfaqët haptazi ose e mbajtët fshehtë, Allahu do t’ju marrë në përgjegjësi, e ia falë atij që do dhe e dënon atë që do.” 2-Bekare: 284

“Mos shko pas diçkaje për të cilën nuk ke dijeni. Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjitha këto do të merren në përgjegjësi.” 17-Isra: 36

Ky ajet ka vënë në pah që edhe zemra, si syri dhe veshi, është përgjegjëse.

Përsëri, Allahu Teala thotë:

“Mos e fshihni dëshminë, se, kush e fsheh atë, zemra e tij është gjynahqare.” 2-Bekare: 283

“Allahu nuk ju merr në përgjegjësi për betimet tuaja të paqëllimta por ju merr për ato që jeni zotuar qëllimisht.” 5-Ma’ide: 89

Sipas nesh, në këtë çështje nuk duhet ndalur me kaq, pa i ditur deri në detaje veprimet e zemrës, nga fillimi e deri në shfaqjen në gjymtyrë.

1. E para gjë që vjen në zemër është *kujtesa*. Për shembull, papritmas në kujtesën e njeriut gjallërohet një grua duke i ardhur pas shpine, në atë mënyrë që, po të kthehet mbrapa, do ta shihte atë grua. Një mendimi të tillë që

vije në zemër i thuhet *kujtesë*. Kësaj i thuhet edhe 'hadith-i nefs'. *Hadith-i nefs* përbën diçka që më vonë shfaqet në kujtesë të njeriut.

2. Emocioni, dëshira dhe animi natyror; d.m.th. animi i cili është në natyrën e epshit, lëviz për t'u kthyer që të shikojë atë grua. Natyrisht që kjo lind nga e para, e që është *kujtesa*.

3. Vendimi i zemrës; d.m.th. zemra merr vendim që të shikojë atë grua pas shpine. Kur natyra anon në diçka, qëllimi nuk del në shesh deri sa pengesat nuk ngritën. Njeriu nuk e bën qëllimin nganjëherë nga turpërimi, e nganjëherë nga frika. Kësaj i thuhet vendosmëri. Fillimisht vjen kujtesa, pastaj animi, dhe më pas vendosmëria.

4. Për të shikuar nevojitet vendim i prerë dhe kësaj në fakt i thuhet qëllim. Fillimisht, ky qëllim mund të jetë i dobët, por kur zemra i përulet kujtesës e cila është në shkallën e parë, e tërheqë nefsin kah vetja dhe në këtë mënyrë, duke u forcuar synimi, vjen në një gjendje të qëllimit të prerë. Nganjëherë, edhe pas arritjes së qëllimit të prerë, njeriu mund të pendohet dhe të braktisë qëllimin. Nganjëherë harron për shkak të ndonjë pengese, e nganjëherë pengesa të ngjashme mund të vështirësojnë veprimin.

Pra, para se të veprohet me gjymtyrë, zemra i ka katër gjendje. Kujtesë (*hadith-i nefs*), anim, vendosmëri dhe qëllim. Sipas kësaj, ne themi që:

Kujtesa me zemër nuk mund të gjykohet, sepse kjo nuk është në vullnetin dhe në zgjedhjen e lirë të personit. Njëjtë edhe animi, emocioni dhe epshi, meqë nuk janë zgjedhje, edhe për to njeriu nuk është përgjegjës. Ky është qëllimi i Resulallahut s.a.v.s, kur thotë:

“Ummetit tim i është falur *hadith-i nefis*” - mendimi i cili vjen në zemër dhe bëhet shkak ngurrimi në mes të bërjes dhe mos-bërjes.

Qëllimi dhe vendosmëria janë të ndara nga kjo. Ato nuk janë *hadith-i nefis*. *Hadith-i nefis* është ajo për çka flet transmetimi i Osman b. Madhun, kur i tha Resulallahut s.a.v.s.:

-O Resulallah, nefsi im më thotë të shkurorëzohem nga Havla. Çka më urdhëroni?

Resuli i Allahut i tha:

- Jo, në sunnetin tim është edhe martesë.

Osmani përsëri tha:

- Nefsi im thotë të bëhem eunuk. Resuli i Allahut tha:

- Jo, për ummetin tim eunuku është në vazhdimin e agjërimit. Pastaj, Osmani tha:

- Nefsi më thotë të bëhem murg.

- Jo, për ummetin tim murgu është lufta dhe haxhi.

Përsëri, Osmani tha:

- Nefsi më thotë të mos ha mishin. Resuli i Allahut tha:

- Jo, unë vërtet e dua mishin, po ta gjeja – menjëherë do ta haja. Dhe po ta kërkoja nga Allahu, Allahu më jep.⁶⁸

⁶⁸ Transmeton Tirmidhiu në **“Nevadiru’l-Usul”**

'Hadith-i nefis' quhet kujtesa e cila nuk është bashkuar me vendosmëri. Meqë Osmani nuk kishte vendosmëri dhe qëllim, ai u konsultua me Resulallahun s.a.v.s..

E treta është vendosmëria e zemrës, d.m.th. nëse pajtohemi për të bërë këtë veprim. Kjo pjesë është e pavendosur mes zgjedhjes së lirë dhe detyrimit. Këtu gjendjet ndërrohen. Në rast të zgjedhjes së lirë, personi është përgjegjës, e në rast të detyrimit – jo.

E katërta është synimi dhe qëllimi i vërtetë. Për këtë, njeriu është përgjegjës. Por, kur nuk e bën veprën të cilën e ka synuar, duhet të shikohet nëse mos-bërja e këtij synimi, pra mos-kthimi për të shikuar gruan, vjen nga frika prej Allahut, dhe nëse personi pendohet për këtë synim, i shkruhet një sevap, sepse synimi i tij ishte një gjynah. Lufta me veten (nefsin) dhe tërheqja nga ky veprim është një vepër e mirë. Synimi në përputhje me dëshirat e vetes (nefsit) lind nga të harruarit e Allahut.

Lufta kundër dëshirës së natyrës kërkon fuqi të madhe. Përpjekja për të kundërshtuar nefsin, është një veprim për Allahun. Të vepruarit kundër dëshirave të nefsit për Allahun është shumë më e vështirë se sa përshtatja dëshirave të natyrës me çka njeriu i përshtatet shejtanit. Prandaj për këtë përfitohet një vepër e mirë. Sepse synimi i tij preferon të mirën nga e keqja, dhe përdoret për të mirë. Nëse personi ndërro mendimin nga e keqja të cilën e ka synuar për shkak të ndonjë pengese, ose për shfajësim, ose për shkak të frikës nga dikush, e jo për shkak të Allahut, për një synim të tillë i shkruhet një gjynah. Sepse një synim i tillë për të keqen është zgjedhje e lirë e zemrës.

Dëshmi e këtij shpjegimi që dhamë është ky hadith i hollësishëm, të cilin e transmeton Buhariu nga Ebu Hurejre r.a., ku Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Melekët thonë: ‘O Rabb, ky robi Yt dëshiron të bëjë keq’. Allahu Teala e di më mirë, por melekëve u thotë: ‘Vështroni atë, nëse e bën atë të keqe që dëshiroi, shkruani në fletoren e tij një gjynah për një të keqe, e nëse e braktis dhe nuk e bën, shkruani një vepër të mirë, sepse ai ka braktisur atë të keqe për Mua’.”

Qëllimi këtu është që ai ka braktisur dëshirën e vet, për Allahun. Por, nëse njeriu vendos për një të keqe, pastaj për ndonjë arsye tjetër e jo për shkak të frikës nga Allahu nuk e bën atë vepër, sigurisht që për këtë nuk i shkruhet sevap.

E si t’i shkruhet, kur, sipas transmetimit të Ibn Maxhe nga Xhabiri, Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Njerëzit do të ringjallen sipas qëllimeve.”

Ne e dimë që, dikush që ka pasur vendosmëri për vrasje ose ziná në mëngjes, nëse vdes një natë më herët, vdekja e tij konsiderohet si këmbëngulje në këto gjynahe, dhe ai do të ringjallet sipas qëllimit.

E, kur njeriu synon të bëjë të keqen, e këtë të keqe nuk mund ta bëjë për ndonjë pengesë tjetër, kjo sigurisht që nuk është sevap, dhe në fletoren e tij i shkruhet dënimi i kësaj vendosmërie për të keqen.

Në këtë çështje, dëshmi e prerë është ky hadith, të cilin e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Bekri r.a.:

Resulallahu s.a.v.s., kështu ka thënë:

- **Kur dy myslimanë përballen me shpata** (për të vrarë njëri-tjetrin), **vrasësi dhe i vrari janë në xhehenem.**

E pyetën:

- *Ky vrasësi është katil, por çka është faji i viktimës?*

Resulallahu s.a.v.s., tha:

- ***Sepse ai ka pasur qëllim të mbys tjetrin***

Kjo është një dëshmi e qartë që, edhe pse është vrarë pa faj, vetëm për shkak të qëllimit – është radhitur me banorët e xhehenemit. Si mundet pas kësaj të mendohet se Allahu Teala nuk do të pyes për synimin dhe qëllimin?

E vërteta është që, për çdo lloj synimi që është në vullnetin dhe zgjedhjen e lirë të personit, jepet përgjegjësi, përveç prishjes së këtij synimi të keq me një vepër të mirë. Prandaj edhe prishja me pendim (teube) e vendosmërisë për vepër të keqe, sigurisht që bëhet një vepër e mirë. Për këtë arsye ai që braktis këtë të keqe nga frika e Allahut, i shkruhet një vepër e mirë, por në qoftë se braktiset për shkak të ndonjë pengese tjetër, sigurisht që nuk njihet si vepër e mirë.

Por kujtesa dhe entuziazmi nuk janë në zgjedhjen e lirë të njeriut. Të kërkohet nga njeriu përgjegjësi për to është sikur të ngarkohet ai me diçka që nuk mund të bartë, e kjo nuk është *xhaiz*. Për këtë shkak, siç transmeton Muslimi sipas shpjegimit të Ebu Hurejres r.a., kur zbriti ky ajet:

“Për atë që e keni në shpirtin tuaj, e shfaqët haptazi ose e mbajtët fshehtë, Allahu do t’ju marrë në përgjegjësi, e ia fal atij që do dhe e dënon atë që do.” (2-Bekare: 284), disa as’habë erdhën te Resulallahu s.a.v.s. dhe thanë:

- O Resulallah, u obliguam me atë të cilën ne nuk kemi fuqi ta bartim, ngase na vijnë kujtesa të tilla, me të cilat ne nuk jemi assesi të kënaqur. Po të mbesin ato në zemrat tona, ne do të përgjigjemi për to?!

Resulallahu s.a.v.s., ju tha:

- Mos vallë edhe ju dëshironi të thoni si çifutët: ‘dëgjuam por kundërshtojmë’? Mos bëni ashtu, thoni: ‘dëgjuam dhe u përulëm’.”

Dhe pas një viti, zbriti ajeti i lehtësimit:

“Allahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij.” 2-Bekare:286

Nga kjo kuptohet që njeriu nuk do të përgjigjet për veprat e zemrës të cilat janë jashtë zgjedhjes së lirë të njeriut.

Kush mendon se çdo gjë që ndodhet në zemër është ‘kujtesë’ (hadith-i nefsi), duke mos bërë dallimin mes këtyre tri pjesëve, me siguri që do të gabojë. Si është e mundur të mos përgjigjet njeriu për veprat e zemrës siç janë madhështia, arroganca, dyfytërsia, përçarja, xhelozia dhe vepra tjera të këqija? Veshi, syri, dhe zemra - të gjitha janë përgjegjëse. Por vetëm për veprat me qëllim dhe me zgjedhje të lirë. Për shembull, nëse njeriu pa dëshirën e vet papritur shikon një grua që nuk e ka të lejuar, për këtë nuk është përgjegjës, por pas kësaj ndalet dhe përsëri shikon dhe me dëshirë vazhdon të shikojë, sigurisht se është përgjegjës. Sepse shikimi i dytë është zgjedhje e lirë. Pra ndodhitë në

zemër janë kështu. Zemra meriton më shumë përgjegjësi se veshi dhe syri, sepse zemra është esencë.

Sipas Muslimit, në transmetim nga Ebu Hurejre r.a., Resulallahu s.a.v.s., duke vendosur dorën në zemër, ka thënë:

“Devotshmëria është këtu.”

“Tek Allahu nuk arrin as mishi e as gjaku i tyre, por te Ai arrin devotshmëria e juaj.” 22-Haxh: 37

Përsëri, Resulallahu s.a.v.s thotë:

“Rrahja e zemrës është gjynah.”

Në transmetim të Taberanit nga Ebu Sa’lebi, Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Mirësi është ajo me të cilën zemra pajtohet duke gjetur qetësi, pa marr parasysh çfarë gjykimi (fetva) i japin.”

Bile, ne themi që kur zemra e myftiut gjykon që të bëhet diçka, edhe nëse kjo është gabim – ai do të shpërblehet. Për shembull, nëse personi mendon që ka abdes, ai duhet të falë namazin. Nëse pas faljes së namazit, atij i kujtohet që ka qenë pa abdes, ai prapë merr shpërblim nga namazi që ka falur. Por pasi të përkujtohet që është falur pa abdes ai nuk merr abdes për t’u falur përsëri, bëhet gjynahqar. Nëse dikush gjen në shtratin e tij një grua të huaj, dhe duke menduar se është gruaja e tij fle me të, nuk është përgjegjës. Nëse mendon se është grua e panjohur dhe fle me te, është përgjegjës, edhe nëse më pas vërtetohet se ka qenë gruaja e tij!

Të gjitha këto janë vepra të zemrës, jo të gjymtyrëve.

A NDËRPRITEN VESVESET PLOTËSISHT GJATË DHIKRIT

Ta dish që dijetarët që vëzhgojnë zemrën dhe cilësitë e mahnitshme të saj, në këtë çështje ndahen në pesë grupe kryesore:

1. Një grup beson që me dhikrin e Allahut vesvesja ndërpritet plotësisht, dhe për këtë paraqesin si dëshmi hadithin: **“Kur përkujtohet Allahu, shejtani hesht.”**

2. Grupi tjetër thotë që vesvesja nuk ndahet plotësisht nga zemra, por ndikimi i saj në zemër pakësohet; sepse kur zemra mbështillet me dhikër, kjo pengon ndikimin e vesveses.

Kjo është si në rastin kur njeriu preokupohet me brengat e veta dhe atij i flet dikush – edhe pse zëri i shkon në vesh, ai nuk është në dijeni se çka po i flitet.

3. Grupi i tretë beson që nuk humb as vesvesja e as veprimi i saj, por ajo nuk mund ta pushtojë plotësisht zemrën, sikur vesvesja të vijë nga larg dhe sikur intensiteti i saj të jetë më i dobët.

4. Grupi i katërt beson që kur bëhet dhikri, vesvesja humbet për një çast, pastaj dhikri humbet për një çast; dhe kështu ata ndjekin njëri-tjetrin. Dhikri dhe vesvesja janë aq afër njëri-tjetrit sa që duket sikur janë bashkuar. Kjo është e ngjashme sikur pikat mbi një sferë, e kur sfera rrotullohet me shpejtësi, këto pika marrin gjendjen e vijës. Dëshmia e këtyre është që edhe gjatë dhikrit, nënkuptohet ekzistimi i vesveses. Këta nuk kanë dëshmi tjetër pos kësaj.

5. Edhe grupi i pestë beson që dhikri dhe vesvesja vazhdimisht e ndjekin njëri-tjetrin dhe kjo vazhdon pandërprerë. Sikur që njeriu me sy i sheh dy gjëra përnjëherë, edhe në zemër mund të bëhet rrjedhje e dy gjërave në një çast. Ebu Mansur Dejlemiu në *'Musned-i Firdevs'*, transmeton hadithin nga Muadhi, sipas të cilit Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Çdo njeri ka katër sy. Prej tyre, dy janë në kokë dhe me to shikohen punët e dynjasë. Dy të tjerë janë në zemër - me to shihen punët e ahiretit.”

Këtë pikëpamje e ka preferuar edhe Muhasibi.

Sipas nesh, më e drejta është që të gjitha këto mendime të konsiderohen me vend. Megjithëkëtë, asnjëri nuk ka mundur që vesvesen ta përshkruaj plotësisht. Çdonjëri ka kuptuar një pjesë të vesveses, dhe atë pjesë e ka përshkruar. Kurse vesvesja ndahet në disa klasë:

1) Përzierja e vesveses me të drejtën. Për shembull, shejtani i thotë njeriut: *“Pse e ndalon veten vazhdimisht nga dëfrimi me mirësitë? Bërja ballë epsheve për gjithë jetën është goxha e vështirë, zhytu pak në epshe.”* Por njeriu në atë rast përkuqton drejtësinë e Allahut, shpërblimin dhe dënimin e Tij, dhe - edhe pse është e vërtetë që është goxha e vështirë të frenohet nga kënaqësitë e epsheve, megjithatë kupton që edhe më e vështirë është të durohet zjarri i xhehenemit. Pasi që është e domosdoshme të preferohet njëra nga to, padyshim që ai preferon frenimin nga epsheet. Njeriu mendon premtimin dhe dënimin e Allahut Teala, e përtërit imanin, e

përforcon bindjen, e shejtani hesht dhe ikë. Sepse shejtani nuk realizoi pohimin që është më e vështirë të frenohet epshi se sa zjarri i xhehenemit, dhe nuk mund të thotë që kryengritja nuk çon në xhehenem. Besimi i njeriut në librin e Allahut Teala refuzon pohime të tilla dhe kështu ndërpritet vesvesja. Ngjashëm kësaj, shejtani i jep vesvese njeriut për pëlqimin e vetes, duke i thënë: *“Kush bën ibadet si ti? Kush e njuh Allahun si ti? Sa gradë e lartë është grada jote tek Allahu!”* Në këtë çast njeriu duhet të mendojë se si zemrën me të cilën ai e njuh Allahun dhe gjymtyrët me të cilat i bën ibadet – ato i ka krijuar Allahu, e si mundet atëherë njeriut t’i pëlqejë vetja? Kur njeriu mendon kështu, shejtani menjëherë largohet, sepse nuk ka mundësi të thotë: *“Jo, këto nuk janë krijime të Allahut”*. Në këtë mënyrë, njeriu largon shejtanin me besim dhe njohje. Vesvese të këtilla ndërpritën plotësisht prej atyre që munden të shikojnë me nurin e imanit dhe njohjes.

2) Klasa e dytë e vesveses bëhet me iniciimin dhe nxitjen e epshit. Kjo ndahet në dy:

a) Nëse njeriu e di sigurt që vesvesja është gjynah, shejtani ndërpret nxitjen e epshit, por nuk heq dorë nga inkurajimi në të.

b) Nëse njeriu nuk e di sigurt që një vesvese është gjynah, por vetëm supozon se është e tillë, me këtë vlerësim vesvesja e shejtanit nganjëherë bëhet e suksesshme në zemër. Në këtë gjendje, vesvesja është prezent, por nuk është fituese. Megjithatë, duhet bërë përpjekje për të përzënë vesvesen.

3) Klasa e tretë e vesveses lind nga disa mendime që preokupojnë njeriun, jashtë namazit dhe vetë kujtesës. Kur njeriu përmend Allahun, këto vesvese largohen, e kur ndalet dhikri - ato kthehen, dhe kështu gjendjet ndjekin njëra-tjetrën. Mbledhja e të dyjave, pra dhikrit dhe vesveses në një vend, është e mundur. Bile, njeriu mund të kuptojë në të njëjtën kohë edhe kuptimin e Kur'anit që është duke lexuar, edhe vesvesen. Thuajse këto të dyja qëndrojnë ndaras në dy vende në zemër. Ky lloj i vesveses është larg nga mundësia për t'u zhdukur plotësisht, ashtu që kurrë më të mos kthehet. Megjithatë, kjo nuk është e pamundur, sepse Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Kush falë dy reqate pa përkujtuar asgjë nga dynjaja, i falen gjynahet e kaluara.”

Nëse një namaz i tillë nuk do të ishte i mundur, Resulallahu s.a.v.s. nuk do ta përmendte. Por, një gjendje e tillë nuk është e mundur në secilën zemër – kjo është e mundur në atë zemër që është e mbushur me dashuri hyjnore. Ne shohim zemrën e personit të mbushur me armiqësi nga vuajtja prej armikut, gjatë faljes së dy reqateve nuk përkujton asgjë tjetër përveç si t'i hakmerret armikut. Njëjtë, zemra e mbushur me dashurinë e Allahut, e zhytur në oqeanin e dashurisë, nuk përkujton asgjë tjetër, me dashurinë brenda vetes dalldiset në mendime për të Dashurin, bile edhe po të flas dikush diçka - nuk dëgjon. Edhe po të kalojë dikush pranë tij - nuk e sheh. Nëse mendohet në çështje të tilla si frika nga armiku d dëshira për pasuri dhe pozitë, atëherë si bëhet të mos mendohet frika nga zjarri i xhehenemit d shpresa për xhenet? Fatkeqësisht, për shkak të dobësisë së besimit në Allahun dhe në ahiret, të tillë janë të rrallë.

Kur mendon këto pjesë të vesveses, do të kuptosh që çdo grup posedon një gradë, por edhe vendi i çdo grupit është i qartë.

Shkurtimisht: largimi i shejtanit është i mundur për një kohë të shkurtër. Por të shpëtohet prej tij për gjithë jetën është shumë e vështirë, gati e pamundur. Sikur dikush të shpëtonte nga vesveset e shejtanit me rrugë të emocionit, dëshirës dhe kujtesës, do të shpëtonte Resulallahu s.a.v.s.. Resulallahus.a.v.s., duke falur namazin e pa një shenjë në xhybe. Pas selamit, e nxori xhyben dhe tha:

“Kjo më preokupoi deri sa po falja namaz. Dërgojani këtë Ebu Xhehmit dhe sillmani xhyben e tij pa shenjë.”

Në një rast tjetër, Resulallahu s.a.v.s., kishte në gisht një unazë të dukatit. Deri sa ishte në minber duke lexuar hutben, i shkoi syri në unazë, e hoqi dhe e hodhi, duke thënë:

“Herë po shikoj unazën, e herë ju.”

Forca që e nxiti të shikojë shenjën në xhybe dhe unazën është vesvesja e shejtanit. Kjo ishte para se të bëhej dukati haram, prandaj edhe e kishte dukatit në dorë, dhe më pas e hodhi. Vesveset e pasurisë, dukatit dhe argjendit të kësaj bote ndërpriten vetëm me hedhjen e dukatit dhe argjendit nga zemra; ndarja nga to i ndal edhe vesveset për to. Ai që posedon qoftë edhe një dukat më shumë se sa që ka nevojë, shejtani mund t’i japë vesvese në namaz për këtë dukat. Ai i jep vesvese të llojllojshme: si do ta ruaj këtë dukat, ku do ta japë, si do ta fshehë nga të tjerët ose si do ta tregoj për t’u

lavdëruar me të. Ai që me tërë fuqinë e tij i jepet dynjallëkut, e më pas mendon të shpëtojë prej shejtanit, është sikur ai që fut dorën në mjaltë e më pas mendon që mizat nuk do t'i vijnë – kjo nuk është e mundur. Dynjaja është dera më e madhe për vesvesen e shejtanit. Meqenëse shejtani ka shumë dyer, mbrojtja e tyre është e vështirë.

Një dijetar thotë: *“Shejtani i afrohet njeriut përmes gjynaheve; nëse njeriu largohet nga gjynahet, shejtani i vjen me këshilla duke ia paraqitur bidadet (risitë) si të mira dhe e zvarrit në to. Nëse në këtë nuk është i suksesshëm, atëherë i propozon vështirësi, bile edhe disa gjëra hallall e mubah ia prezanton si haram. Nëse edhe me këtë nuk ka sukses, atëherë fillon t’i japë vesvese në abdes dhe në namaz ashtu që e vë në dyshim se a është me abdes dhe sa reqate i fali. Nëse edhe me këtë dështon, atëherë ia paraqet mirësitë si punë të lehta, ashtu që personi çdo vepër të mirë e zbaton me durim dhe qëndrueshmëri. Shejtani këtë e bën me qëllim që të tjerët ta shohin personin dhe që ai të tërheqë dashurinë e tyre, e kështu ta fusë personin në vetëpëlqim, dhe me këtë e shkatërron. Nëse personi e kapërcen edhe këtë pengesë të shejtanit, hyn në xhenet.”*

LLOJET E NDRYSHIMEVE TË ZEMRËS

Dije se ciësitë që treguam e rrethojnë zemrën. Ndërsa veprat dhe gjendjet derdhen brenda nga dyert që i treguam. Sikur zemra të ishte një cak i shigjetave të cilat vinë nga çdo anë. Kur një shigjetë e prek zemrën, nga ajo ndikohet dhe mbetet nën ndikimin e saj. Nga ana tjetër, e kundërt e kësaj, nëse qëllon një gjë, kësaj here gjendja ndërron. Për shembull, kur vjen shejtani duke ftuar zemrën në të këqija, meleku vjen dhe e tërheq zemrën në mirësi.

Një shejtan vjen e fton në të këqija, një tjetër shejtan vjen e fton në një tjetër të keqe. Një melek vjen e fton në mirësi, një melek tjetër vjen dhe fton në një tjetër mirësi. Nganjëherë, mes dy melekëve dhe dy shejtanëve bëhet kacafytje. Zemra asnjëherë nuk mbetet bosh. Si shenjë kësaj, Allahu Teala thotë:

“Ne do t’ua rrotullojmë zemrat dhe shikimet e tyre...”

6-En’am: 110

Resulallahu s.a.v.s., meqë i ka ditur këto ndryshime të zemrës dhe artin e habitshëm të Allahut Teala mbi zemrën, i betohej Allahut me këtë gjendje të zemrës:

“Jo, i betohem Allahut që rrotullon zemrat, ajo ashtu s’është.”⁶⁹

Resulallahu s.a.v.s., shpesh thoshte:

“O Ti që i rrotullon zemrat si dëshiron, bëje zemrën time të qëndrueshme në fenë Tënde!”

⁶⁹ Shënon Buhariu nga Ibn Omeri.

E kishin pyetur:

-“A e dhe ti frikësohesh, o Resulallah?” , e ai tha:

“E çka më jep siguri, kur zemra e besimtarit është mes dy gishtave të Mëshiruesit, dhe Ai e rrotullon ashtu si Ai do.”

E në transmetim tjetër thuhet:

“Nëse Ai dëshiron ta drejtojë në qëndrueshmëri – e drejton, e nëse dëshiron ta rrëshqasë - e rrëshqet. E si të jem i sigurt?”⁷⁰

Resulallahu s.a.v.s. ka dhënë tre shembuj për zemrën dhe kështu kishte thënë:

“Zemra është si trumcaku, çdo moment në një anë drejtohet.”⁷¹

Përsëri, sipas transmetimit të Ahmedit dhe Hakimit nga Mikdad b. Esvedi, Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Në dridhje, zemra është si tenxherja kur në të vlon uji.”⁷²

Përsëri Resulallahu s.a.v.s., thotë;

“Zemra është si një krah zogu që është hedhur në fushë. Siç rrotullon fryma këtë krah, edhe zemra kështu është.”⁷³

⁷⁰ Tirmidhiu nga Enesi, Hakimi nga Xhabiri, Muslimi nga Abdullah ibn Amr, dhe të tjerë.

⁷¹ Hakimi në ‘*el-Mustedrek*’, dhe Bejheki në ‘*esh-Shuab*’ nga Ebu Ubejde ibn el-Xherrah.

⁷² Ahmedi dhe Hakimi nga Mikdad ibn el-Esvedi.

⁷³ Në ‘*Kebir-in e Taberanit* dhe në ‘*Shuabu’l-Iman*’ të Bejhakit.

Këto ndryshime të zezës dhe mrekullinë e Allahut në këto ndryshime të zezës mund t'i kuptojnë vetëm ata të cilët i kontrollojnë gjendjet e veta dhe respektojnë gjendjet të cilat janë të pranueshme tek Allahu Teala.

Qëndrueshmëria e zezës në të mirë dhe në të keqe, si dhe lëkundja mes tyre, ndahet në tri grupe:

E para është zemra e pastruar nga pislëku, e zbardhur me ahlak të bukur dhe devotshmëri. Nga bota e melekutit dhe nga thesaret e fshehura, kësaj zemre i rrjedhin përkujtimet e mira. Edhe mendja, mendon këto përkujtime të arritura duke u orientuar për të kuptuar hollësitë e mirësive dhe për të qenë e informuar mbi vlerat e sofistikuara.

Me nurin e mendjemprehtësisë (basiretit) i çelet pamja e jashtme e këtyre përkujtimeve, stimulohet në përhapjen e tyre dhe vendos t'i përhapë ato. Meleku e shikon zezrën dhe e gjen atë të pastër në esencën e vet, të pastruar me devotshmëri, të ndriçuar me dritën e mendjes, të ndërtuar me nurin e marifetit. Meleku e sheh këtë zemër si vendqëndrim të duhur. Në këtë kohë, zezrën e ndihmojnë ushtarët e padukshëm, e udhëzojnë në vepra të tjera të mira, dhe kështu kjo vazhdon, pa ndërprerë. Në pjesën e inkurajimit në mirësi ndihma nuk përfundon, dhe në çështje të mirësisë, veprimet lehtësohen.

Duke vënë këtë në shenjë, Allahu Teala kështu thotë:

“Sa për atë që jep (për hir të Allahut), ka frikë (nga Ai) dhe dëshmon për vërtetësinë e më të bukurës (besimit),

Ne do t'ia lehtësojmë atij rrugën drejt shpëtimit.”

92-El-Lejl: 5, 6, 7

Në zemër të tillë ndriçon drita nga dritarja e *rububijetit*. Bile, në këtë zemër nuk mund të qëndrojë shirku i fshehtë, i cili përndryshe është më i fshehur dhe më i heshtur se lëvizja e buburrecit të zi në natën e errët. Tani karshi këtij nuri hyjnor asgjë nuk mbetet e fshehur. Asgjë nga mashtrimet e shejtanit këtu nuk gjen vlerë. Ndoshta shejtani qëndron në largësi dhe mundohet të mashtrojë me fjalë të zbukuruara, por kjo zemër nuk e respekton atë (shejtanin). Kjo zemër, pas pastrimit nga gjërat shkatërrimtare, shpejt mbushet me gjëra shpëtimtare si falënderimi, durimi, frika, shpresa, varfëria, dashuria, kënaqësia, malli, mbështetja në Allahun Teala, të menduarit, vetë-llogaria dhe gjëra tjera shpëtimtare.

Kjo është ajo zemër kah e cila kthehet Allahu Teala me rahmetin e Tij; kjo është zemra e qetësuar për të cilën Allahu Teala thotë:

“Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!”

13-Raad: 28

“O ti shpirt i qetësuar!” 89-Fexhr: 27

E dyta. Zemra e poshtëruar, e mbushur me epshe dhe kërkesa, e ndotur me moral të shëmtuar dhe me ndyrësira tjera, zemër në të cilën janë të hapura portat e shejtanit, kurse portat e melekut të mbyllura. Në këtë zemër e keqja lind një ide të bazuar në epshe e cila ngadalë flakëron. Atëherë zemra i kthehet mendjes për të kërkuar rrugëdalje dhe që ta arsyetojë veten. Ndërsa mendja tashmë është mësuar dhe është përshtatur që të shërbejë epsheet, rregullisht duke kërkuar arsyeime për to dhe duke i ndihmuar, e atëherë nefsi pushton zemrën dhe e mbanë nën

kontroll, prandaj gjoksi hapet për epshe të cilat përhapin errësitat e veta, sepse ushtria e mendjes nuk është në gjendje të ofrojë ndihmë për mbrojtje. Kështu forcohet pushteti i shejtanit meqë hapësira e tij është zgjeruar me zgjerimin e ndikimit të epsheve. Një zemre të tillë shejtani i qaset, duke ia treguar gjërat rrejshëm dhe duke ngjallur në të shpresë të rrejshme me pëshpëritje të fjalëve të stolitura me qëllim të mashtrimit. Në një gjendje të tillë dobësohet fuqia e besimit në premtimin dhe dënimin e Allahut dhe shuhet drita e bindjes së fortë në frikë nga dënimi i ahiretit për shkak se nga zjarri i epshit del tym i zi i cili ngritët dhe mbush gjithë zemrën, me ç'rast shuhen dritat e saj, e mendja bëhet si syri i mbushur me tym që nuk mund të shoh. Ja çfarë bën me zemrën mbizotërimi i epsheve, ashtu që ajo (zemra) nuk është në gjendje të ndalet dhe të mendojë, e nëse dikush do ta këshillonte ose do ta udhëzonte në veprim të drejtë, ajo nuk do të ishte në gjendje të kuptojë e as të dëgjojë. Kështu, shejtani sulmon përshtatshëm dëshirave të epshit, kurse organet trupore lëvizin, dhe kadaja dhe kaderi i Allahut dalin në shesh si kryengritje në këtë botë (shehadet) nga bota e fshehtë (gajb). Kjo është ajo zemër të cilës Allahu Teala i flet në ajetet:

“A e ke parë ti atë që epshin e vet e ka marrë për zot? A do t’i bëhesh mbrojtës atij? A mendon ti se shumica e tyre dëgjojnë dhe kuptojnë? Ata nuk janë tjetër, veçse si bagëti. Madje, ata janë edhe më të shmangur nga rruga e drejtë.”

25-Furkan: 43, 44

“Shumica e tyre meritojnë dënimin Tonë, sepse ata nuk besojnë.” 36-Jasin: 7

“Sa për ata që mohojnë, njësoj është, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove - ata nuk besojnë.” 2-Bekare: 6

Kjo është gjendja e disa zemrave në lidhje me epshin. Disa zemra janë që hezitojnë prej disa të këqijave, e mbrojnë veten prej tyre dhe nuk i marrin ato të këqija në konsideratë. Por, nëse sheh një fytyrë të bukur, nuk mund të përmbahet, nuk mund të përmbajë as syrin dhe as zemrën. I shkon mendja, bie moralisht, dhe dashuron atë fytyrë të bukur. Dikush nuk mund të përmbahet nga pozita, pushteti dhe mendjemadhësia. Kur e gjen një mundësi të tillë kërkon çdo zgjidhje. Disa nuk mund të kontrollojnë veten.

Disa nuk mund të mposhtin zemërimin. Në çastet e zemërimit bëhen lodër e shejtanit. Për disa, kur janë në pyetje paratë - hutohen, e hedhin njerëzoren, pa u kujdesur për të drejtën dhe ligjin, nxitojnë në para.

Të gjitha këto paraqiten nga tymi i epshit i cili e rrethon zemrën. Tymi e errëson zemrën, shuhet turpi, gëzimi dhe nuri i imanit në zemër, dhe zemra i ndjekë dëshirat e shejtanit.

E treta: Në zemër ringjallen kujtimet epshore dhe tërheqin zemrën në të këqija. Nga ana tjetër vinë përkujtimet e besimit dhe zemrën e tërheqin në mirësi. Nefsi me fuqinë e epshit i ndihmon kujtimet e këqija. Epshi i përforcon ato, dhe si të tilla i forcon shfrytëzimet tjera të ndaluara. Nga ana tjetër, mendja shkon drejt përkujtimeve të mira dhe e përzënë epshin, e qorton dhe e qet në shesh mos-kuptimin e veprave të këqija, i krahason agresivitetet e këqija të epshit me kafshët grabitqare. Në këtë mënyrë, nefsi anon kah këshilla e mendjes. Kësaj radhe shejtani e sulmon mendjen, i përforcon kërkesat dhe dëshirat e nefsit duke i thënë:

“Prej nga një përmbajtje kaq e ftohtë? Pse i përmban dëshirat e epshet tua dhe e mundon veten? A i neglizhon kush nga bashkëkohësit e tu dëshirat e epshit? Vallë, t’u lëmë atyre kënaqësitë e kësaj bote që me to të ëmbëlsohen? A do t’i

cenosh vetes diçka të tillë, dhe të mbetesh i palumtur, i mohuar dhe i vuajtur të cilit të gjithë do t'i qeshen? Apo dëshiron të jesh më lartë se filani e filani? Edhe ata i kanë bërë këto vepra dhe nuk janë përmbajtur. A nuk e sheh se filan dijetari aspak nuk përmbahet nga gjëra të ngjashme, e po të kishte të keqe në këtë, me siguri edhe ai do të përmbahej para teje?”

Karshi këtyre vesveseve të shejtanit, nefsi anon kah shejtani dhe fillon të kthehet drejt shejtanit. Këtë herë meleku e sulmon shejtanin, duke i thënë:

“Sigurisht është shkatërruar secili që ka ndjekur dëshirat dhe epshet e veta dhe i ka neglizhuar pasojat e kësaj! A të mjafton kjo kënaqësi e vogël në krahasim me kënaqësinë e përjetshme në Xhenet dhe në bukuritë e tij? E konsideron dhimbje të madhe frenimin e epsheve, por nuk mendon ashtu kur është në pyetje zjarri. Vallë, do të të mashtrojë neglizhenca e njerëzve ndaj vetes, vrapimi i tyre pas kërkesave të veta dhe ndihma e tyre për shejtanin, kurse dënimi i Xhehenemit nuk do të të zvogëlohet për shkak të gjynaheve të të tjerëve. Paramendo se gjendesh nën diellin përvëlues në ditë me diell, ku të gjithë njerëzit i janë ekspozuar nxehtësisë së tij, kurse ti ke hapësirë të freskët dhe të këndshme – a do të qëndroje me ta nën diellin përvëlues apo do të kërkoje shpëtim për vete nën hije? Si mundet atëherë që nuk do të pajtohesh me të tjerët vetëm nga frika e nxehtësisë së diellit, kurse nuk do t’ju kundërvihesh nga frika e zjarrit?”

Atëherë nefsi anon kah fjalët e melekut, por edhe më tutje mbetet i pavendosur në mes të dy ushtrive, dhe është i ekspozuar ndikimeve të tyre deri sa në zemër nuk mbizotëron ajo që ai meriton.

Nëse në atë zemër mbizotërojnë cilësitë e shejtanit, për të cilat kemi folur, në të mbizotëron shejtani, dhe zemra anon kah ai, duke u larguar nga Allahu dhe robët e Tij të sinqertë, dhe vepron në përputhje me kaderin e tij e kjo bëhet shkak për t'u larguar nga Allahu. Por nëse në zemër mbizotërojnë veçoritë e melekut, zemra nuk do të dëgjojë nxitjet e shejtanit dhe të zhvlerësojë ahiretin, por anon kah ushtria e Allahut Teala.

Në përputhje me kaderin, në gjymtyrë shihet përshtatje dhe zbatim i urdhrave të Allahut Teala. Shkurtimisht zemra e besimtarit rrotullohet në mes të dy gishtave të Mëshiruesit. Dy gishtat janë këto dy fuqi. Në tërheqjen mes këtyre dy fuqive (ushtrive) rrotullimi vazhdon. Pra, kjo mbizotëron në zemër. Kthehet në të djathtë dhe të majtë, kalon nga një fuqi në tjetrën. Është shumë e rrallë që të qëndrojë vazhdimisht në vullnetin e melekut, ose shejtanit. Kjo përshtatje dhe mos-përshtatje nëpërmjet thesarit të zemrës del nga bota e fshehtë (*alem-i gajb*) në botën e dukshme (*alem-i shuhud*), ngase këto janë fshehtësi nga *alem-i gajb*. Kur këto paraqiten, bëhen shenjë që poseduesi i basiretit (evlia) të dijë paracaktimin në ezel. Atij që është krijuar për Xhenet, i lehtësohen shkaqet (sebepe) për zbatimin e urdhrave të Allahut Teala. Edhe atij që është krijuar për Xhehenem i lehtësohen shkaqet e kundërshtimit, dhe shokët e këqij e sundojnë atë, shejtani ia vendos urdhrat e veta në zemër dhe me llojllojshmërinë e kurtheve të tij e mashtron dhe i jep shpresë budallenjve duke u thënë:

“Vërtet Allahu është i gjithëmëshirshëm, prandaj mos u brengos! Shiko këta njerëz - ku është frika nga Allahu? Çka t'u ndodhë atyre edhe ty të ndodh! Jeta është e gjatë, kështu që në të ardhmen bën teube!”

“Ai u premtom atyre dhe i josh me shpresa, por ato që premtom shejtani, janë vetëm mashtrime.” 4-En-Nisa: 120

Premtimi i shejtanit është tërësisht shpikje dhe gënjeshtër. Ai premtom teuben (pendimin) dhe faljen, dhe me këto mashtrime bëhet shkak për shkatërrimin e njerëzve. Me mashtrime të tilla iu mbush zemrat, fjalën e vet e dikton, i largon nga pranimit i të vërtetës (hakut). Megjithatë, të gjitha këto janë me kadanë dhe kaderin e Allahut Teala. Allahu Teala thotë: **“Allahu ia hap zemrën për (të pranuar) Islamin atij që dëshiron ta udhëzojë, ndërsa atij që dëshiron ta lërë në humbje (ia mbyll zemrën e) ia shtrëngon gjoksin si të jetë duke u ngjitur në qiell. Kështu, Allahu i ndëshkon ata që nuk besojnë.”** 6-En’am: 125

“Nëse ju ndihmon Allahu, s’ka kush t’ju mposhtë e, nëse Ai ju lë pa ndihmën e Tij, kush është që do t’ju ndihmojë, përveç Tij?” 3-Ali Imran: 160

Pra, Ai është i Cili udhëzon në rrugë të drejtë dhe i Cili lë në humbje; Ai bën çfarë të dojë dhe vendos si të dojë; Vendimin e Tij asgjë nuk mund ta ndal, e as nuk mund ta ndërrojë; Ai ka krijuar Xhenetin dhe ka krijuar banorët e tij dhe i ka angazhuar me ibadete, por ka krijuar edhe Xhehenemin dhe i ka krijuar edhe banorët e tij dhe i ka angazhuar me gjynahe. Allahu Teala i ka njoftuar krijesat me shenjat e banorëve të Xhenetit dhe me shenjat e banorëve të Xhehenemit, duke thënë:

“Vërtet, punë-drejtët do të jenë në Xhenet, kurse fajtorët, me siguri, do të jenë në Zjarrin flakërues”

82-El-Infitar: 13, 14

Pastaj Resulallahu s.a.v.s., kështu tha:

“Këta janë në Xhenet nuk ka fjalë më shumë. Edhe këta janë në Xhehenem, përsëri nuk ka fjalë më shumë.”⁷⁴

Vetëm Allahu nuk përgjigjet për atë që bën, të tjerët janë përgjegjës për atë që bëjnë.

Ne, me gjendjet e mahnitshme të zemrës, mjaftohemi me kaq. Të hyjmë në hollësi në pjesën praktike, nuk është mirë. Urtësia (hikmet) që treguam është për të ditur fshehtësitë dhe thellësitë e diturisë praktike; që të përfitojë prej kësaj ai i cili nuk mjaftohet me zahir - që të mos e lë thelbin e të mjaftohet me lëvozhgë. Dhe të ketë zell për të kuptuar hollësitë e hakikateve dhe sebepeve. Ne mendojmë që për këtë çështje shpjegimet tona janë të mjaftueshme. Ndihma dhe udhëzimi (hidajet), është nga Allahu Teala.

⁷⁴ Hadith-kudsij, e shënon Ahmedi dhe Ibn Hibban nga Abdurrahman ibn Katade es-Sulemi.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	3
KUPTIMI I FJALËS KALB (ZEMËR).....	7
KUPTIMI I FJALËS RUH (SHPIRT)	9
KUPTIMI I FJALËS NEFS	10
KUPTIMI I FJALËS AKL (MENDJA)	11
USHTARËT E ZEMRËS.....	14
SHEMBULL I USHTARËVE TË BRENDSHËM TË ZEMRËS.....	18
VEÇORITË E ZEMRËS SË NJERIUT	22
VENDI I MBLEDHJES SË CILËSIVE TË ZEMRËS.....	31
GJENDJA E ZEMRËS NË LIDHJE ME DITURINË	39
GJENDJA E ZEMRËS NË LIDHJE ME DITURITË RACIONALE DHE ATO TË SHERIATIT, SI DHE DITURITË E KËSAJ BOTE DHE BOTËS TJETËR.....	49
DALLIMI NË MES TË FRYMËZIMIT DHE PËRFITIMIT TË DITURISË ME MËSIM	57
NDRYSHIMI MES DY GRADAVE	63

DËSHMITË E SHERIATIT PËR RRUGËN E DREJTË TË SUFIVE NË	
PËRFITIMIN E NJOHURIVE.....	73
NGACMIMI I SHEJTANIT ME VESVESE NË ZEMËR.....	85
NDËRHYRJET E SHEJTANIT NË ZEMËR	Error! Bookmark not defined.
PËR CILAT VESVESE, SYNIME DHE MENDIME NJERIU DO TË	
PYETET DHE PREJ CILAVE FALET	133
A NDËRPRITEN VESVESET PLOTËSISHT GJATË DHIKRIT	143
LLOJET E NDRYSHIMEVE TË ZEMRËS.....	149

